



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 493 Akti

Nr. 661 Vendimi
Tiranë, më 18.5.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 18.5.2023, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Besnik Hoxha**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket

rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Besnik Hoxha, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 16.5.2022, nëpërmjet përfaqësuesit, kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Besnik Hoxha, gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Subjekti i rivlerësimit Besnik Hoxha i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur në datën 15.6.2020 nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
3. Trupi gjykues, me vendimin nr. 1, datë 22.6.2020, vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Pasi të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit, me mirëkuptim u caktua kryesuese e trupit gjykues komisionere Valbona Sanxhaktari. Nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
4. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga subjekti i rivlerësimit janë nisur procedurat e rivlerësimit, si vijojnë:
 - a) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, pranë ILDKPKI-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
 - b) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pranë DSIK-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
 - c) plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.
5. Gjatë hetimit administrativ, konkretisht, në datën 21.7.2020, është njoftuar subjekti i rivlerësimit për përbërjen e trupit gjykues, duke i kërkuar gjithashtu të shprehej lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit me anëtarët e tij. Subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike të datës 22.7.2020, ka shprehur mospasjen e ndonjë konflikti interesi me të tre anëtarët e trupit gjykues.
6. Pas përfundimit të fazës hetimore mbi rivlerësimin e subjektit Besnik Hoxha, me vendimin nr. 2, datë 12.4.2023, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimet dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.

7. Në datën 13.4.2023, Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe e ftoi atë për t'u njohur me dosjen dhe me provat e administruara prej tij, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, për të paraqitur shpjegimet dhe për të provuar të kundërtën e rezultateve të kristalizuara në fund të hetimit administrativ, duke i dhënë kohë deri më 3.5.2023.
8. Subjekti i rivlerësimit, i përfaqësuar nga avokati i tij J.M., me prokurën nr. "****" rep., nr. "****" kol., datë 9.7.2020, paraqiti pranë Komisionit deklaratën e datës 18.4.2023, për t'u njohur me dokumentacionin e dosjes së hetimit administrativ dhe për tërheqjen e dokumentacionit fizik edhe në formë elektronike, të cilat iu vunë në dispozicion së bashku me rezultatet e hetimit kryesisht.
9. Me anë të postës elektronike të datës 2.5.2023, subjekti ka kërkuar kohë shtesë për përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes së tij deri në datën 10.5.2023.
10. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike në datën 2.5.2023, nëpërmjet vendimit nr. 3, datë 3.5.2023, vendosi të pranojë kërkesën e subjektit, duke i caktuar një afat të ri për paraqitjen e prapësimeve, deri në datën 10.5.2023. Subjekti paraqiti prapësimet nëpërmjet postës elektronike në datën e caktuar nga Komisioni, si dhe nëpërmjet shërbimit të postës kanë mbërritur pranë protokollit të institucionit në datën 11.5.2023.
11. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet vendimit nr. 4, datë 11.5.2023, vendosi të caktojë seancën dëgjimore në datën 16.5.2023, duke njoftuar subjektin përmes postës elektronike për këtë vendimarrje.

II. SEANCA DËGJIMORE

12. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 16.5.2023, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.
13. Në vijim, pasi dëgjoi relacionin, subjekti Besnik Hoxha, i përfaqësuar në seancë nga av. A.S., me prokurën e posaçme nr. "****" rep., nr. "****" kol., parashitroi shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni, duke iu referuar edhe shpjegimeve të paraqitura më herët me shkrim. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet përfaqësuesit të vet, kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore e datës 16.5.2023 u mbyll për të rifilluar më 18.5.2023, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

14. Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, ndonëse në disa raste, nga përfaqësuesi dhe/ose subjekti është kërkuar më shumë kohë – sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 – përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

15. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga KLGJ-ja; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative dhe të rezultateve të hetimit; (viii) argumentet e paraqitura në seancën dëgjimore; si dhe (ix) faktet e njohura botërisht.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. VLERËSIMI I PASURISË NGA ILDKPKI-ja

16. Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

17. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

18. Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konfliktit të interesave, të parashikuara nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

A/2. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

1. Lidhur me pasurinë godinë banimi 3-katëshe, në Shkodër

1. Subjekti i rivlerësimit Besnik Hoxha ka deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2003, shtëpi banimi 2-katëshe me sipërfaqe 60 m² dhe shtesë të katit të parë dhe të dytë në proces ndërtimi, me nr. pasurie “***”, e ndodhur në z. k. “***”, në lagjen “*****”, rruga “*****” nr. “***”, Shkodër, në vlerën 1.100.000 lekë.
2. Si burim financiar për krijimin e kësaj pasurie, ai ka deklaruar të ardhurat në shumën 1.400.000 lekë nga shitja e një apartamenti sipas kontratës nr. “***” rep., nr. “***” kol.,

datë 17.10.1997. Apartamenti në fjalë ishte përfitur më herët nga subjekti dhe nëna e tij me privatizim, nëpërmjet kontratës nr. “****” rep., nr. “****” kol., datë 11.8.1997, në vlerën 17.345 lekë.

3. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se nga momenti i shitjes së apartamentit që kishte në bashkëpronësi me nënën e vet, në vitin 1997, e deri në momentin e blerjes së godinës së banimit në vitin 2003, ai, bashkëshortja, fëmijët dhe nëna e tij kanë banuar për disa kohë te banesa e vëllait të subjektit, z. E.H., dhe më pas te banesa e motrës së tij, znj. F.H., (B.). Subjekti është shprehur se për shkak të marrëdhënies familjare nuk ka pasur detyrime qiraje për banesat e mësipërme të përdorura¹ prej tij.
4. Në DIPP-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar një shtesë në shtëpinë ekzistuese të banimit konkretisht: shtesë kati i parë gjithsej 80 m²; shtesë kati i dytë gjithsej 80 m². Si vlerë të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar shumën 500.000 lekë. Gjithashtu, po në këtë deklaratë, subjekti ka cituar se shtesa e kryer është në procedurë regjistrimi.
5. Në deklaratën e personit të lidhur në DIPP-në e vitit 2015, bashkëshortja e subjektit ka cituar se banesa e deklaruar në vitin 2003, si banesë në ndërtim e sipër dhe me procedurë regjistrimi në vazhdim, është legalizuar me lejen nr. “****”, datë 30.4.2015, dhe në vijim është lëshuar vërtetimi hipotekor nr. “****”, datë 11.5.2015.
6. Nga analizimi i dokumentacionit të mësipërm ka rezultuar se subjekti ka përfitur një parcelë ndërtimore me sipërfaqe 53.4 m² nga ALUIZNI, nëpërmjet kontratës së kalimit të pronësisë me nr. “****” rep., nr. “****” kol., datë 29.4.2015, të lidhur me këtë institucion, kundrejt shumës së paguar prej 38.448 lekësh dhe bono privatizimi² me vlerë nominale 55.000 lekë. Mbi këtë sipërfaqe ka rezultuar e ndërtuar shtesa e deklaruar prej subjektit.
7. Në vijim, pasuria në fjalë është legalizuar sipas lejes së legalizimit nr. “****”, datë 30.4.2015, për godinë banimi 3 kate, me sipërfaqe totale ndërtimi 299 m², nga të cilat sipërfaqe e parcelës ndërtimore 105.4 m², kati përdhe me sipërfaqe 88.2 m², kati i parë dhe kati i dytë me sipërfaqe 105.4 m²/secili.
8. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë në fjalë, të legalizuar me anë të lejes së legalizimit të sipërcituar, si dhe ka sqaruar se kjo pasuri është përfitur fillimisht nëpërmjet kontratës së shitblerjes me nr. “****” rep., nr. “****”, datë 7.8.2003, me objekt “Blerje trualli me sipërfaqe 52 m², nga e cila 52 m² ndërtesë”, në vlerën 900.000 lekë.
9. Gjithashtu, në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se për periudhën 2003 – 2013 janë bërë investime mbi objektin ekzistues, të cilat arrijnë vlerën 5.007.548 lekë, me burim nga të ardhurat familjare. Bashkëlidhur kësaj deklaratë, subjekti ka paraqitur një akt vlerësimi të pasurisë, të kryer nga një vlerësues privat në datën 16.1.2017, i cili ka përllogaritur koston e ndërtimit të katit të dytë dhe të tretë, në një vlerë totale prej 5.007.548 lekësh.
10. I pyetur nga Komisioni në pyetësorin nr. 2, në lidhje me dokumentacionin ligjor që do të provonte vlerën e deklaruar si të investuar në këtë pasuri, si dhe në lidhje me kohën e

¹ Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provave kartelat e pasurive të përdorura prej tij.

² Për sa i përket bonove të privatizimit, në pyetësorin nr. 2, subjekti ka deklaruar se bonot janë blerë sipas kursit të Bankës së Shqipërisë dhe ka përcjellë formularin e pagesës datë 24.4.2015. Gjithashtu, ai ka vënë në dispozicion formularin e legalizimit të banesës me nr. “****” prot., datë 1.7.2013.

kryerjes së investimit – subjekti ka shpjeguar se kati i parë i banesës ka qenë i përfunduar dhe i banueshëm në momentin e blerjes së pasurisë. Ndërsa, punimet e katit të dytë kanë filluar në vitin 2003 dhe kanë vijuar deri në vitin 2007. Lidhur me shpenzimet e kryera, subjekti ka sqaruar se ato kanë qenë minimale, pasi materialet ishin blerë nga disa shitës ambulantë.

11. Po në këtë pyetësor, pasi është pyetur në lidhje me mosdeklarimin ndër vite të shpenzimeve të kryera për ndërtimet/investimet në këtë banesë, subjekti ka sqaruar për Komisionin se shuma e shpenzuar ka qenë e shpërndarë përgjatë 5 viteve të ndërtimit të pasurisë – dhe se në ndërtimin e banesës e kishin ndihmuar familjarët, për shkak të pamundësisë së tij financiare për të kontraktuar një kompani ndërtimi. Për rrjedhojë, ai e kishte të pamundur ndarjen e punimeve në kohë dhe në vlerë shpenzimesh për secilin kat veçmas.
12. Komisioni ka kryer një analizë krahasimore mes çmimit të blerjes së pasurisë në analizë dhe të dhënave të tregut të lirë në atë kohë. Në referencë të udhëzimit nr. 1, datë 8.5.2003, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe të koeficientit “k”, për sipërfaqen e regjistruar të banesës prej 52 m² ka rezultuar një çmim shitjeje prej 2.340.104 lekësh, ndërsa për sipërfaqen faktike të blerë prej 88.2 m², një çmim prej 3.969.176 lekësh.
13. Në lidhje me konstatimin e mësipërm, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka shpjeguar se çmimi i blerjes është dakordësuar mes palëve duke marrë në konsideratë zonën në të cilën ndodhë banesa, si dhe faktin se ajo ishte e amortizuar.
14. Gjatë hetimit administrativ, nga BKT-ja, nëpërmjet shkresës nr. “****” prot., datë 3.8.2020, është bërë me dije se pasuria në analizë është hipotekuar në favor të bankës. I pyetur nga Komisioni lidhur me këtë konstatim, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se kredia është marrë nga miqtë e familjes së tij, R., dhe K.K., sipas kontratës së kredisë nr. “****”, datë 25.1.2013 dhe prona është hipotekuar me anë të kontratës së hipotekimit nr. “****”, datë 25.1.2013. Nga përmbajtja e kontratës së kredisë ka rezultuar se qëllimi i përdorimit të shumës do të ishte për likuidimin e vlerës së mbetur të çmimit të blerjes së apartamentit objekt kreditimi, të ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k., në favor të së cilës do të transferohej edhe shuma e kredisë. Subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. “****”, datë 19.5.2020, nga BKT-ja, në të cilën është cituar se kjo kredi në vijim do të sigurohej me kontratën e hipotekimit nr. “****” rep., “****” kol., datë 20.2.2020, me një pasuri tjetër, duke e liruar pasurinë e subjektit nga barra hipotekore. Subjekti ka shpjeguar se pagesat e kësteve të kredisë kanë qenë të rregullta e, për rrjedhojë, atij nuk i ka lindur detyrimi për të paguar. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe ajo Shkodër është bërë me dije se nuk kanë rezultuar çështje të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit me palë shtetasit R., dhe K.K.
15. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër³ është përcjellë vendimi nr. “****”, datë 23.6.2003, i dhënë nga gjyqtari Besnik Hoxha, për çështjen me objekt “Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë së trashëgimlënësit F.D., trashëgimtarët do të përfitojnë ¼ pjesë/secili të pasurisë së ndodhur në lagjen “****”, rruga “****” nr. “****”, Shkodër”. Ky vendim ka

³ Me shkresën nr. ****” prot., datë 6.12.2021.

marrë formë të prerë në datën 8.7.2003, ndërkohë që më pas, në datën 7.8.2003, subjekti i rivlerësimit ka blerë pasurinë në analizë.

16. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se nuk ka pasur asnjë lloj marrëdhënieje me palën shitëse (familjen D.), ndërsa, për sa i përket çështjes gjyqësore të gjykuar prej tij, ai ka shpjeguar se nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, pasi çështja në fjalë ka pasur natyrë deklarative, në të cilën nuk është trajtuar apo zgjidhur ndonjë konflikt gjyqësor ndërmjet palëve apo mes tyre dhe palëve të treta⁴. Gjithashtu, ai ka shpjeguar se shitblerja është kryer në distancë kohore dhe pasi ishte përfunduar shqyrtimi dhe vendimmarrja e çështjes në fjalë.
17. Lidhur me këtë konstatim, Komisioni ka konkluduar se: *Duket se krijimi i kësaj marrëdhënieje interesi me përfituesit e trashëgimisë (për blerjen e banesës, objekt i trashëgimisë të shqyrtuar nga subjekti), rreth një muaj pas vendimit të marrë nga subjekti, në procesin gjyqësor, pikërisht për çeljen e trashëgimisë në fjalë, ngre dyshime për cenimin e etikës së gjyqtarit – dhe i ka kaluar subjektit barrën e provës për sa më sipër.*
18. Subjekti e ka prapësuar këtë konstatim të Komisionit, duke paraqitur argumentet e tij lidhur me rastin, të cilat së bashku me vlerësimin e trupit gjykues do të trajtohen në një kre të veçantë në këtë vendim, të grupuara me çështje të tjera, të cilat mund të lidhen me etikën e gjyqtarit, nën titullin “Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni”.

1.1 Përgjatë hetimit administrativ, lidhur me pasurinë në analizë, Komisioni ka administruar dokumentacionin si në vijim:

19. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës⁵ (në vijim ASHK), si dhe nga verifikimi i kryer nga Komisioni në sistemin multifunksional të ASHK-së për institucionet, nuk kanë rezultuar pasuri të paluajtshme, të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur, veç asaj të deklaruar nga vetë subjekti.
20. Nga ALUIZNI⁶ është bërë me dije se me vetëdeklarimin nr. “****” prot., datë 1.7.2013, subjekti ka aplikuar për legalizimin e pasurisë godinë banimi 3-katëshe në Shkodër. Në datën 30.4.2015, ai është pajisur me lejen e legalizimit nr. “****”, si dhe ka fituar pronësinë mbi parcelën ndërtimore me sipërfaqe 53.4 m², nëpërmjet kontratës së kalimit të pronësisë me nr. “****” rep., nr. “****” kol., datë 29.4.2015, të nënshkruar me këtë institucion.
21. Nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor⁷ është përcjellë dokumentacioni lidhur me kuotat mbi lartësinë e objektit, me sqarimin se fotografimi ajror i zonës disponohej vetëm për periudhën 2007 – 2008. Nga këqyrja e këtij dokumenti është konstatuar se referuar parametrave të objektit dukej se godina kishte përfunduar (së paku si lartësi/kate) në vitin 2007.
22. Nga Furnizuesi i Shërbimit Universal⁸ (në vijim FSHU) është bërë me dije se me të dhënat Besnik N., Hoxha nuk ka rezultuar kontratë furnizimi me energji elektrike, por kanë rezultuar 141 kontrata të lidhura me këtë institucion me emër mbiemër Besnik Hoxha, duke

⁴ Analiza mbi konfliktin e mundshëm të interesit do të bëhet në kreun “Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni”.

⁵ Me shkresat nr. “****” prot., datë 6.9.2017 dhe datë 4.10.2017 ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Shkodër me nr. “****” prot., datë 6.9.2017.

⁶ Me shkresën nr. “****” prot., datë 28.8.2017.

⁷ Pas kërkesës së Komisionit me nr. “****” prot., datë 12.11.2021, është dërguar përgjigja nr. “****” prot., datë 1.12.2021.

⁸ Shkresa nr. “****” prot., datë 9.9.2020.

sqaruar se nuk disponon të dhëna personale të abonentëve, veç emrave dhe mbiemrave dhe, për këtë arsye, është në pamundësi për të identifikuar nëse kontratat e identifikuar u përkasin shtetasve për të cilën Komisioni ka kërkuar informacion, ndërsa është konfirmuar ekzistenca e dy kontratave në Korçë dhe Tiranë, në emër të R.H. Në emër të E.H., është konfirmuar ekzistenca e dy kontratave, nr. “****”, në instancën e Elbasanit dhe nr. “****”, në instancën Tiranë. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit⁹, ky institucion nëpërmjet FSHU-së¹⁰ ka bërë me dije se në emër të Besnik N., Hoxhaj nuk ka rezultuar kontratë furnizimi. Informacioni është kërkuar me mbiemrin “****”, me energji elektrike, por janë identifikuar 7 abonentë me emër mbiemër Besnik Hoxhaj. Në lidhje me shtetasen R. H., FSHU-ja ka bërë me dije se ajo nuk ka rezultuar abonent, ndërsa me të dhënat E. H., ka rezultuar një kontratë në Shijak.

23. Nga UKT-ja¹¹ është bërë me dije se në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të nuk rezultojnë kontrata për shërbime të lidhura me këtë institucion. Komisioni i është drejtuar subjektit nëpërmjet pyetësorit nr. 2, duke i kërkuar të paraqesë kontratat e mundshme të lidhura nga ai apo personat e lidhur, për shërbime/furnizime të energjisë elektrike dhe të ujit të pijshëm. Së bashku me përgjigjet e tij, subjekti ka paraqitur librezën e furnizimit me ujë të pijshëm me kod kontrate “****”, si dhe një vërtetim të datës 1.3.2022, ku citohet se Besnik N., Hoxha është klient i UKSH-së. Gjithashtu, ai ka paraqitur librezën e furnizimit me energji elektrike nga CEZ Shpërndarje sh. a., me nr. kontrate “****”.

1.2 Analiza e burimeve të blerjes së pasurisë

24. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për blerjen e pasurisë në fjalë në vitin 2003 janë përdorur të ardhurat nga shitja e një apartamenti të privatizuar më herët prej tij dhe nëna e tij dhe se për periudhën 2003 – 2013 janë bërë investime në objektin ekzistues të blerë me burim nga të ardhurat familjare.
25. Nga ASHK Shkodër¹² është përcjellë dosja e pasurisë së përfutur nga subjekti dhe nëna e tij¹³, nëpërmjet kontratës për privatizimin e banesës së datës 31.8.1993, të lidhur me Ndërmarrjen Komunale të Banesave, në vlerën 17.345 lekë. Aplikimi për privatizimin e pasurisë ka rezultuar i kryer vetëm nga subjekti dhe nëna e tij.
26. Referuar certifikatës së gjendjes civile të datës 1.12.1992, në përbërjen familjare ka qenë edhe vëllai i subjektit, z. H.H. Bazuar në ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, për efekt të zbatimit të këtij ligji merrej për bazë përbërja familjare dhe gjendja e strehimit në datën 1.12.1992.
27. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se në kohën e privatizimit të banesës, në përbërjen e tij familjare, ka qenë ai dhe nëna e tij. Ai ka shpjeguar se vëllai i tij, nga viti 1994 e në vijim, ka jetuar në Turqi. Ndërsa, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka paraqitur një kontratë të vëllait të tij me nr. “****”, datë 5.7.2001, me Entin Kombëtar të Banesave të privatizuar nga vëllai i tij në Tiranë.

⁹ Shkresa nr. “****” prot., datë 16.11.2021.

¹⁰ Me shkresën nr. “****” prot., datë 2.12.2021.

¹¹ Me shkresën nr. “****” prot., datë 10.9.2020.

¹² Nëpërmjet shkresës nr. “****” prot., datë 28.12.2021.

¹³ Me kërkesën e datës 30.3.1993 nëna e subjektit ka kërkuar nga Ndërmarrja Komunale e Banesave privatizimin e banesës shtetërore, në të cilën ajo dhe djali i saj/subjekti banonin me qira.

28. Apartamenti i privatizuar nga subjekti dhe nëna e tij i është shitur shtetasve A., dhe T. D, kundrejt çmimit 1.400.000 lekë, me anë të kontratës së shitjes nr. “****” rep., nr. “****” kol., datë 17.10.1997. Komisioni ka përllogaritur në analizën financiare të ardhurat e subjektit nga shitja e pasurisë në fjalë, të barabartë me pjesën takuese të tij, prej 1/2 në këtë pasuri, 700.000 lekë¹⁴.
29. Pas kryerjes së analizës financiare, duke përfshirë të ardhurat nga shitja e apartamentit të sipërcituar, si dhe të ardhurat nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortes së tij, përgjatë periudhës 1997 – 2002, pas përllogaritjes edhe të shpenzimeve të familjes, ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi financiare për blerjen e pasurisë godinë banimi e ndodhur në lagjen “****”, në Shkodër, sipas detajimit në tabelën e mëposhtme.

Analiza financiare për blerjen e banesës

Te ardhura nga shitja e pasurise se paluajtshme	700,000
Te ardhura nga pagat e subjektit 1997 - 31.7.2003	2,666,613
Te ardhura nga pagat e b/shortes 1997 - 31.7.2003	477,568
Shpenzime jetese 1997 - 31.7.2003 (3/4 persona)	(2,056,644)
Shpenzime per arsimimin e djalit 2002	(100,000)
Ndryshimi ne likuiditetet bankare	(6,985)
Investuar ne blerjen e baneses ne gusht 2003	(900,000)
Rezultati ne gusht 2003	780,552

1.3 Analiza e burimeve të ndërtimit të pasurisë

30. Nisur nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve, si dhe nga fotografimet ajrore të paraqitura nga Autoriteti Gjeohapsinor, duket se së paku punimet e jashtme të ndërtimit kanë përfunduar në vitin 2007. Për rrjedhojë, Komisioni i ka përllogaritur kostot e ndërtimit të shtrira përgjatë periudhës 2003 – 2007.
31. Në mungesë të dokumentacionit të kohës për të provuar koston e ndërtimit, Komisioni ka kryer një përllogaritje duke u bazuar në vlerat referuese të EKB-së për vitet 2004 – 2007. Në referencë të jurisprudencës së Kolegjit¹⁵, Komisioni ka zbritur nga këto kosto edhe vlerat për fondin rezervë dhe fitimin e planifikuar¹⁶, në përfundim të së cilës ka rezultuar një vlerë totale për ndërtimin e katit të dytë dhe të tretë të banesës, prej 4.773.993 lekësh (ose 5.279.997 lekë nëse punimet do të shtriheshin deri në vitin 2013). Nisur nga përafërsia e këtyre vlerave të rezultuara nga një vlerësim reference, me vlerën totale të shpenzimit për ndërtimin në fjalë, të deklaruar prej subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting* në vlerën 5.007.548 lekë, Komisioni e ka konsideruar këtë vlerë si kosto totale të këtij ndërtimi, duke

¹⁴ Ndonëse në dokumentacionin e paraqitur nga ASHK Shkodër, lidhur me këtë pasuri, nuk ndodhet mandatpagesa e tatimit për të ardhurat nga shitja e saj, referuar ligjit nr. 7786, datë 27.1.1994, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar, neni 6 “Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe të hipotekës nuk regjistrojnë kalimin e pronësisë pa u paraqitur dokumenti që vërteton pagimin e tatimit të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni”. Për sa kohë ka rezultuar që pasuria në fjalë të jetë regjistruar në emër të palës blerëse, prezumohet që për këto të ardhura është paguar detyrimi tatimor përkatës.

¹⁵ Vendimi nr. “****”, datë 17.3.2022 (JR) dhe atij nr. “****”, datë 29.3.2022.

¹⁶ E barabartë me 9.39% për vitin 2006, 8.55% për vitin 2007, ndërsa për vitet 2004 dhe 2005 Komisioni ka përllogaritur një mesatare të viteve 2001 dhe 2006, prej 9.33%.

e vijuar analizën e mëtejshme mbi mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme, bazuar pikërisht në vlerën e përshkruar në këtë deklaram.

32. Duke u nisur nga sa ka rezultuar nga të dhënat, fotografimet ajrore të paraqitura nga Autoriteti Gjeohapsinor të kombinuara me deklaramet e subjektit të rivlerësimit në DIPP-të e tij ndër vite dhe në përgjigje të pyetësorëve, mund të konsiderohet se ndërtimi i katit të dytë është kryer në vitet 2003 dhe 2004, ndërsa ndërtimi i katit të tretë është kryer në vitet 2005 – 2007, nga ku Komisioni ka vlerësuar ndarjen e këtyre kostove, përkatësisht¹⁷ sipas detajimit në tabelën e mëposhtme. Në analizën e mëposhtme janë përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e familjes së subjektit përgjatë kësaj periudhe, nga ku ka rezultuar se për kryerjen e ndërtimit në fjalë subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, përgjatë viteve 2004 – 2007, në masën -3.455.325 lekë.

Analiza financiare për ndërtimin e banesës

Viti	Gusht-Dhjetor 2003	2004	2005	2006	2007
Siperfaqja	88.20	193.60	228.73	263.87	299.00
Siperfaqja e ndërtuar brenda vitit	-	105.40	35.13	35.13	35.13
Kosto/m ²	-	22,387.33	22,272.18	23,519.64	22,928.34
Kosto e ndërtimit	200,000	2,275,063	820,777	866,749	844,959
Te ardhura te vitit	346,786	1,037,688	1,101,049	1,146,151	1,259,630
Shpenzime te vitit	(256,440)	(614,870)	(780,374)	(758,564)	(994,700)
Te mbartura nga periudhat e mëparshme	780,552				
Ndryshimi ne likuiditete	(347)	335	(106,621)	27,644	34,857
Rezultati i vitit	670,551	(1,851,910)	(606,724)	(451,519)	(545,172)

33. Gjithashtu, vërehet se edhe nëse do të konsiderohej dhe kryhej përlllogaritja sipas variantit alternativ – duke e shtrirë periudhën e ndërtimit, në analizë, deri në vitin 2013 (sikurse është shprehur subjekti në deklaratën *Vetting*) – gjithsesi do të rezultonte një mungesë e përafërt e burimeve të ligjshme financiare prej -3.298.417 lekësh.

34. Në përfundim të sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të dhënë shpjegime bindëse dhe për të paraqitur dokumente ligjore për të provuar të kundërtën e rezultateve të Komisionit si vijon:

- *Duket se ka mospërputhje mes deklarameve të subjektit, sa i përket periudhës së ndërtimit të banesës, mes deklaratës *Vetting*, ku përshkruhet periudha 2003 – 2013 dhe në përgjigje të pyetësorëve ku përmendet periudha 2003 – 2007.*
- *Duket se subjekti nuk ka deklaruar shpenzimet/investimet e kryera në lidhje me pasurinë godinë banimi 3-katëshe, përgjatë viteve 2003 – 2007.*
- *Duket se për ndërtimin e banesës në fjalë përgjatë periudhës 2003 – 2007 (sikurse është konfirmuar nga ortofotot), subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën -3.455.325 lekë. Megjithatë, edhe nëse do të*

¹⁷ 200.000 lekë në vitin 2003, e përlllogaritur si diferencë mes vlerës së deklaruar prej subjektit në DIPP-në e vitit 2003 dhe çmimit të blerjes së banesës; 2.275.063 lekë në vitin 2004, e përlllogaritur si diferencë mes kostos së ndërtimit të katit të dytë dhe asaj të vitit 2003 (200.000 lekë), bazuar në deklaramin e subjektit në DIPP-në e vitit 2004; 820.777 lekë në vitin 2005; 866.749 lekë në vitin 2006; dhe 844.959 lekë në vitin 2007.

konsiderohej sipas deklarimit në deklaratën Vetting, gjithsesi do të rezultonte një mungesë e burimeve të ligjshme financiare në masën -3.298.417 lekë.

- *Duket jobindës pretendimi se mobilimi i një banese 3-katëshe të ketë kushtuar vetëm 300.000 lekë.*

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

35. Subjekti është shprehur se të ardhurat nga shitja e pasurisë që ka pasur në bashkëpronësi me nënën, së bashku me të ardhurat nga pagat e tij dhe të bashkëshortes, përgjatë periudhës 1997 – 2002, kanë qenë të mjaftueshme për blerjen e banesës në vitin 2003. Ai ka pretenduar përfshirjen e të ardhurave nga paga si oficer i policisë gjyqësore në analizën financiare, si dhe të të ardhurave të plota nga shitja e apartamentit në vlerën 1.400.000 lekë, pasi ai dhe nëna e tij kanë qenë në një ekonomi të përbashkët familjare deri në momentin që kjo e fundit ka ndërruar jetë në vitin 1998.
36. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se shpenzimet e jetesës për periudhën 1997 – 1999 duhet të përlllogariteshin në masën 30% të të ardhurave, ashtu siç është përcaktuar në vendimin nr. “***” të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, duke pretenduar një vlerë totale të kursyer në shumën 2.200.000 lekë, e cila duhet të përlllogaritet për blerjen e shtëpisë në vitin 1998 dhe kryerjen e shtesës në këtë banesë në vitin 2003.
37. Për sa i përket shpenzimeve të kryera për mobilimin e banesës, për të cilat Komisioni i kishte kaluar subjektit barrën e provës, në prapësimet e tij, ashtu sikurse edhe gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti është shprehur se është në pamundësi për të provuar vlerën e tyre.
38. Përpos sa më sipër, subjekti ka pretenduar se vlera e ndërtimit të godinës së banimit duhet të përlllogaritet në vitet 2003 dhe 2004 (ndërtimi i katit të dytë duhet të përlllogaritet kryesisht në vitin 2003, përveç vlerës 500.000 lekë të shpenzuar në vitin 2004), të përfunduar kati i parë dhe i dytë i ndërtimit, ndërsa kati i tretë duhet të përlllogaritet në fazën karabina, në masën 44% të ndërtimit gjatë viteve 2004 – 2007, dhe vijimin e punimeve të katit të tretë, dhe shpenzimet për investimin e brendshëm (rifinitura etj.), të përfunduara deri në vitin 2013, sipas deklarimit në deklaratën *Vetting*. Sipas subjektit, në këto vite, vlera e shpenzuar ka qenë në raport me mundësinë e kursimit. Në mbështetje të pretendimit të tij se kati i dytë i banesës ka qenë i përfunduar në vitin 2003, subjekti ka paraqitur edhe një ortofoto të këtij viti.
39. Lidhur me mosdeklarimin e vlerës së ndërtimit informal, subjekti është shprehur se ky shpenzim nuk ka qenë objekt deklarimi, sipas ligjit të kohës kur është kryer ndërtimi.

Vlerësimi i trupit gjykues

40. Trupi gjykues, mbështetur në provat e administruara gjatë hetimit administrativ, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe prapësimet e subjektit të rivlerësimit, dokumentacionin e paraqitur prej tij, si dhe shpjegimet e përfaqësueses së tij gjatë seancës dëgjimore, çmon se përgjithësisht këto shpjegime shkojnë në harmoni me deklarimin e tij në deklaratat periodike ndër vite. Ndonëse në përgjigje të pyetësorëve subjekti nuk ka qenë i saktë në përcaktimin e shpërndarjes në kohë dhe masë të shpenzimeve të kryera për ndërtimet shtesë në godinën e banimit në analizë, ky konfuzion apo kjo pasaktësi/mospërputhje – në mungesë të një prove të kundërt – nuk mund të zerojë vlerën

provuese të deklarimeve të tij në DIPP-të e viteve 2003, 2004 etj.

41. Gjithashtu, trupi gjykues çmon të mbajë në konsideratë edhe faktin se distanca e gjatë kohore (20-vjeçare prej vitit 2003) e bën të vështirë që të ngarkohet subjekti me përgjegjësi sot, në lidhje me mosdisponimin apo mosruajtjen (prej atëherë) e dokumentacionit provues lidhur me kostot efektive të ndërtimit në fjalë, në mënyrë që ato të mund të ishin përdorur në këtë proces rivlerësimi si prova mbështetëse të sa ka deklaruar subjekti – për më tepër në mungesë të një dispozite urdhëruese të kohës, në këtë drejtim.
42. Në këtë situatë fakiko-ligjore, çështjet që shtohen për zgjidhje, janë ato që lidhen me: (i) përcaktimin e vlerave monetare të përdorura për çdo vit përkatës lidhur me ndërtimin e kateve shtesë të godinës së banimit me tre kate; (ii) verifikimin e mundësisë financiare në kuptim të të ardhurave të ligjshme, sipas parashikimeve të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016 të familjes së subjektit për ndërtimin e godinës së banimit me 3 kate, të ndodhur në lagjen “****”, në Shkodër; (iii) përcaktimin e shpenzimeve për jetesë të familjes së subjektit përgjatë periudhës së ndërtimit *de quo*; (iv) vlerësimin tërësor dhe konkluziv të mjeteve monetare me burime të ligjshme të përdorura për ndërtimet e kryera në këtë pasuri, duke i shtrirë dhe segmentuar në kohë dhe vlerë shpenzimet në fjalë.
43. Nisur nga sa më sipër, në shqyrtim të zërave përkatës – duke mbajtur në vëmendje jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, praktikat e mëparshme lidhur me problematika analoge, harmoninë dhe logjikën mes provave, fakteve dhe rrethanave – Komisioni vlerëson se në lidhje me pretendimin e subjektit për përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave nga punësimi i tij si OPGJ, për periudhën 1991 – 1996, ka munguar provueshmëria e masës monetare të fituar apo kursyer përgjatë kësaj periudhe. Megjithatë, lidhur me këtë pretendim vlerësohet se, ndonëse nuk është saktësuar/provuar vlera, as nuk mund të mohohet ekzistenca e këtij burimi dhe, për rrjedhojë, duke konsideruar periudhën e largët të gjenerimit të këtyre të ardhurave, Komisioni çmon që duke mos e konsideruar në analizë si një e ardhur shtesë, ky burim duhet të mbahet në vëmendje në vlerësimin përfundimtar në raport me kursimet e mundshme të subjektit deri në vitin 2003, të përdorura kryesisht për pjesën e ndërtimit të kryer në vitet 2003 dhe 2004.
44. Lidhur me pretendimin e subjektit për përfshirjen në analizë të të ardhurave nga shitja në vitin 1997 e banesës që subjekti ka pasur në bashkëpronësi me nënën e vet, trupi gjykues – duke mbajtur në konsideratë se: (i) subjekti ka qenë në të njëjtën përbërje familjare dhe ka jetuar me nënën e tij deri në vitin 1998; (ii) vëllai i subjektit ka qenë përfitues i një apartamenti tjetër në Tiranë, të blerë po nga prindërit e subjektit po me privatizim; (iii) për më tepër që vëllai i subjektit nuk ka jetuar me subjektin dhe nënën e tyre¹⁸; si dhe (iv) faktin që subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2003, si burim për krijimin e pasurisë në analizë, pikërisht të ardhurat në vlerën 1.400.000 lekë, të gjeneruara nga shitja e apartamentit në bashkëpronësi me nënën e vet – i çmon të pranueshme pretendimet e subjektit, për sa kohë janë të ligjshme të ardhurat e krijuara nga ky transaksion, i vitit 1997, në kuptim të kërkesave të ligjit nr. 84/2016 dhe, si të tilla, të llogaritshme në analizë financiare, në kontekst të një ekonomie të përbashkët familjare, si burim i përdorur për krijimin e pasurisë godinë banimi 3-katëshe.

¹⁸ Subjekti ka paraqitur një deklaratë notoriale të vëllait të tij, me nr. “****”, nga e cila ka rezultuar se vëllai i subjektit që prej vitit 1993 e në vijim jeton e punon në shtetin turk.

45. Për sa i përket shpenzimeve të kryera për mobilimin e banesës, në kushtet kur subjekti është shprehur se është në pamundësi për të provuar vlerën e tyre, Komisioni vlerëson t'i referohet qëndrimin të mbajtur dhe logjikës së ndjekur në jurisprudencën e Kolegjit¹⁹ dhe çmon se është objektivisht i pamundur përcaktimi i ndonjë vlere të ndryshme nga ajo e deklaruar nga vetë subjekti dhe që do t'i korrespondonte shpenzimeve për mobilimin e banesës në fjalë. Për më tepër që në rastin konkret ato shpenzime i përkasin një kohe të largët dhe jashtë fokusit për deklarime apo vëmendjes për të ruajtur dokumentacion provues, për sa kohë që ligji nuk parashikonte asnjë detyrim deklarues apo provues për këtë kategori shpenzimesh në kohën e kryerjes së tyre. Në këto kushte, trupi gjykues gjendet në kushtet e përlllogaritjes së shpenzimeve në fjalë sipas deklarimeve të subjektit, për sa kohë që nuk mund të provohej apo konkludohej ndryshe.
46. Lidhur me pretendimin e subjektit për rillogaritje të shpenzimeve të jetesës për periudhën 1997 – 1999, në masën 30%, trupi gjykues, në referencë edhe të qëndrimin të mbajtur nga Kolegji²⁰, si dhe në kushtet kur nga publikimet zyrtare të INSTAT-it nuk disponohen të dhëna që të përdoren për përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës përpara vitit 2000, vlerëson të konsiderojë në mënyrë alternative shpenzimet e subjektit, duke marrë si referencë një raport të Bankës së Shqipërisë të vitit 1995, në të cilin specifikohet se [...] *të ardhurat vjetore për frymë të popullsisë në fund të vitit 1995 kanë arritur nivelin në afërsisht 800 USD nga 330 USD që ishin në vitin 1993. Sipas disa përlllogaritjeve të përfaqësuara, supozohet se përqindja e kursimeve të popullatës në fund të vitit 1995 mund të jetë rreth 34% nga 29% që ishte në fund të vitit 1992*, duke konsideruar se pjesa tjetër e të ardhurave ka shkuar për konsum dhe kjo për këtë vit përbën rreth 66% të të ardhurave, ndërkohë që niveli i të ardhurave të magjistratit përgjatë të njëjtës periudhë ka qenë më i lartë se ai i referuar nga Banka e Shqipërisë.
47. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se për të përcaktuar shpenzimet e jetesës, në rastin konkret, për periudhën 1997 – 1999, bazuar në qëndrimin e mbajtur nga Kolegji (si më lart referuar) duhen përlllogaritur shpenzimet në masën 30% të tyre, kështu duke e pranuar pretendimin e subjektit lidhur me këtë pikë.
48. Pas rillogaritjes së shpenzimeve të jetesës, si dhe pranimin të pretendimit për përfshirjen e vlerës totale të të ardhurave nga shitja e apartamentit në bashkëpronësi me nënën (si më sipër), disponibiliteti faktik i mjeteve monetare të ligjshme për t'u përdorur nga subjekti për ndërtimin e banesës gjatë vitit 2003, ka rezultuar në vlerë më të lartë, prej rreth 2.4 milionë lekësh.
49. Lidhur me pretendimin e subjektit për shtirjen në kohë të shpenzimeve të kryera për ndërtimin e godinës së banimit 3-katëshe përtej vitit 2007, pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar gjatë procesit të rivlerësimit, prapësimeve dhe shpjegimeve të subjektit pas njoftimit të rezultateve të hetimit, si dhe duke mbajtur në vëmendje edhe shpjegimet e përfaqësueses së subjektit në seancën dëgjimore, trupi gjykues çmon të fokusojë vlerësimin lidhur me këtë pikë mbi këto fakte: (i) deklarimin e subjektit në DIPP-në e vitit 2003 – sipas të cilit kati i parë i banesës ka qenë i përfunduar dhe kati i dytë ka qenë në proces ndërtimi. Për rrjedhojë, kati i dytë dhe i tretë është ndërtuar mbi atë

¹⁹ Vendimi nr. "****" (JR), datë 18.6.2021.

²⁰ Vendimi nr. "****" (JR).

ekzistues, pra nuk ka pasur kosto themelesh apo kosto të tjera fikse që janë të nevojshme në fillimet e ndërtimit; (ii) deklarin e subjektit në DIPP-në e vitit 2004 lidhur me shtesën e katit të dytë (në proces regjistrimi), si dhe shpenzime të kryera në këtë vit në vlerën 500.000 lekë – çka nënkupton se diferenca (pjesa më e madhe e shpenzimit për dy katet e para) është kryer në vitin 2003; (iii) në këto rrethana faktike vlerësohet se ka logjikë që për një investim të ri, me kate shtesë, të mund të përqendrohet një masë investimi më e madhe në fazën fillestare të ndërtimit (pasi pikërisht në këtë fazë zakonisht kryhen punimet kryesore, të cilat kanë edhe një kosto më të lartë si p.sh.: armatura, beton, hekur etj.); si dhe faktin që (iv) bazuar në rezultatet e analizës financiare, pasi janë kryer ndryshimet përkatëse pas pranimit të disa prej pretendimeve të subjektit (siç do të përshkruhen më tej) ka rezultuar se në rast të një shpërndarjeje homogjene dhe të barabartë për të gjithë periudhën e investimit, për familjen e subjektit do të rezultonte një tepricë e disponibilitetit financiar gjatë vitit 2003, i papërdorur, në vlerën rreth 1.2 milionë, çka nuk do të rezultonte logjike që kjo shumë të mos përdorej për investimin në fjalë përgjatë vitit 2003. Kësisoj, në vlerësim të Komisionit, parë nën dritën e parimit të objektivitet dhe nisur nga rrethanat e lartpërmendura, shuma në fjalë, prej rreth 1.2 milionë lekë, mund të konsiderohet në analizë financiare si një burim i përdorshëm për ndërtimin në fjalë përgjatë vitit 2003.

50. Gjithashtu, në vijim të analizës së kostove të këtij ndërtimi, duke mbajtur në vëmendje rrethanat e kësaj situate faktike, për sa kohë bëhet fjalë për një ndërtim informal të shtrirë në kohë, trupi gjykues çmon t'i referohet dhe të aplikojë qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e mëparshme të Kolegjit²¹, sipas së cilës “... në kushtet kur subjektet e rivlerësimit kanë kryer ndërtime për të cilat nuk mund të provojnë me dokumentacion justifikues (situacione punimesh, fatura tatimore etj.) vlerën e shpenzuar për kryerjen e këtij investimi, vlera e objektit në kuptim të koston së tij do të përcaktohet mbi bazën e çmimeve për metër katror sipas vlerave të miratuara nga EKB-ja, sipas viteve në të cilat është deklaruar dhe/ose është kryer ndërtimi objekt kontrolli”, si dhe qëndrimin e mbajtur në një rast tjetër të ngjashëm nga Kolegji²², ku arsyetohet se: “Referimi që Komisioni ka bërë të kostoja mesatare e ndërtimit, e përcaktuar ndër vite prej EKB-së, çmohet si një standard i arsyeshëm, në mungesë të çdo akti tjetër që provon një vlerë të ndryshme ndërtimi, të sjellë prej subjektit të rivlerësimit...”.
51. Nisur nga sa më sipër, Komisioni ka rilllogaritur koston e ndërtimit të dy kateve të para, në harkun kohor 2003 – 2004, që sipas parametrave të EKB-së shkon në vlerën 2.475.063 lekë, duke e konsideruar për vitin 2004 shumën prej 500.000 lekësh (sipas deklarinimit vjetor në DIPP-në e këtij viti) dhe duke përlllogaritur pjesën e mbetur gjatë vitit 2003 – bazuar në argumentimet e mësipërme në raport me këtë pikë.
52. Në këto kushte, duke i përlllogaritur në mënyrë homogjene shpenzimet e ndërtimit për vitet e mëpasshme (deri në vitin 2007) – për sa kohë nuk ka pasur ndonjë deklarinim të këtij lloji në DIPP-të përkatëse të viteve 2005 dhe 2006 dhe as indicie mbi ndonjë shkak përqendrimi apo shpërndarje të ndryshme të tyre ndër vite – Komisioni, pasi ka kryer përlllogaritjet dhe analizën financiare në raport me shpenzimet e tjera të familjes, për periudhën 2003 – 2007, në raport me të ardhurat e tyre ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit për kryerjen e këtij

²¹ Vendim nr. “***” (JR), datë 22.9.2022.

²² Vendimin (JR) nr. “***”.

ndërtimi ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën -1.440.037 lekë²³, pamundësi të shpërndara ndër vite sipas tabelës më poshtë.

Viti	Gusht-Dhjetor 2003	2004	2005	2006	2007
Kosto e ndërtimit	1,975,063	500,000	820,777	866,749	844,959
Kosto e blerjes	900,000				
Te ardhura te vitit	819,718	1,037,688	1,101,049	1,146,151	1,259,630
Shpenzime te vitit	(475,456)	(592,057)	(692,146)	(702,898)	(873,790)
Te mbartura nga periudhat e meparshme	2,373,533				
Ndryshimi ne likuiditete	109,875	335	(106,621)	27,644	34,857
Rezultati i vitit	(47,393)	(54,034)	(518,495)	(395,852)	(424,262)
TOTALI	(1,440,037)				

53. Gjithashtu, Komisioni ka kryer edhe një përlllogaritje alternative lidhur me kohën e kryerjes së shpenzimeve për këtë banesë – në këtë rast duke mbajtur në konsideratë deklarin e bërë nga subjekti në deklaratën *Vetting* lidhur me shpërndarjen e shpenzimeve për ndërtimin e katit të tretë deri në vitin 2013 (përfshirë këtu edhe pretendimet e tjera të sipërcituara, si dhe për shpenzimet e udhëtimit që do të trajtohen në vijim në rubrikën e analizës financiare). Në këtë rast do të rezultonte një balancë negative për ndërtimin e banesës në analizë në masën -1.141.823 lekë – pamundësi kjo që do të shtrihej për një hark kohor 10-vjeçar, konkretisht për periudhën 2003 – 2013. Ky pretendim i subjektit, ndonëse nuk rezultoi i provuar në raport me shpenzimet për ndërtimet strukturore të godinës në analizë, as nuk mund të përjashtohet për sa kohë mund të konsiderohet e mundshme narrativa se kjo pjesë e shpenzimeve në vitet 2008 – 2013 ka pasur për objekt rifiniturat e instalimet e brendshme – parë kjo edhe në raport me masën e vlerave të investuara përgjatë këtyre viteve, që përputhen me këtë tipologji aktiviteti ndërtues. Ky fakt mund të shpjegojë kuptimin e përmbajtjes së deklarimeve të subjektit për përfundimin e punimeve në vitin 2007 – duke konsideruar kështu konkludimin e ndërtimeve strukturore dhe jo edhe ato që lidheshin me rifiniturat e brendshme, instalimet etj. Në këtë pikë vlen të theksohet se këto lloj punimesh, nga njëra anë, nuk mund të evidentohen nëpërmjet fotografive të jashtme apo nga imazhet satelitore të viteve në fjalë dhe nga ana tjetër nuk do të mund të konsideroheshin anormale, për sa kohë nuk bien ndesh me logjikën kohore (pasi normalisht këto lloj punimesh kryhen pasi janë përfunduar ato strukturore – karabina e mure). Për më tepër që masa e shpenzimeve të përlllogaritshme në periudhën 2008 – 2013 nuk e kapërcen pragun vjetor të parashikuar nga dispozitat përkatëse, mbi të cilin mund të lindte detyrimi i deklarinimit të shpenzimeve në fjalë – vetëm referuar viteve 2012 – 2013. Në këto rrethana, për sa kohë, ndonëse mbetet e paqartë, as nuk mund të provohet e kundërta e sa është deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting* lidhur me kohëzgjatjen e ndërtimeve të godinës trekatëshe, Komisioni çmon se edhe ky konkluzion financiar duhet të mbahet në vëmendje në vlerësimin përfundimtar mbi kriterin e pasurisë, për sa kohë nga njëra anë bëhet fjalë për një periudhë shumë të hershme dhe informale e të padokumentuar dhe nga ana tjetër nuk mund të hidhet poshtë, duke e penalizuar subjektin për moskonsiderimin e një fakti të deklaruar prej tij para nisjes së këtij procesi rivlerësimi.

²³ Ky rezultat ka të përfshirë gjithashtu pretendimet e subjektit për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit të tij dhe të personave të lidhur jashtë Shqipërisë, të cilat do të trajtohen të detajuara në rubrikën e analizës financiare.

54. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues, nisur nga niveli i balancës negative, që ka rezultuar për krijimin e kësaj pasurie, sipas analizës së kryer nga Njësia Ligjore e Komisionit, në të dyja variantet e sipërpërshkruara, në vlerën rreth 1.1 ose 1.4 milionë lekë – duke mbajtur në vëmendje që kjo pamundësi do të zvogëlohej nëse do të përllogariteshin të ardhurat e përfituara nga puna e subjektit si OPGJ, përgjatë periudhës 1991 – 1997, si dhe kryesisht duke u bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit – çmon se kjo pamjaftueshmëri financiare nuk përbën shkak për marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit me aplikimin e pikës 3 të nenit 63 të ligjit nr. 84/2016.
55. Ndërkohë, edhe lidhur me mosdeklarimin e shpenzimeve të kryera për ndërtimin informal *de quo*, trupi gjykues vlerëson se nuk janë evidentuar mosdeklarime të subjektit të rivlerësimit. Kjo për shkak se në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, subjekti ka pasur detyrim lidhur me: (i) deklarimin e pasurisë së paluajtshme, në momentin e legalizimit të ndërtimit informal, ndërkohë që ka rezultuar se subjekti e ka deklaruar në vijimësi si ndërtim në proces e deri sa është përfunduar dhe legalizuar e objekti në fjalë në vitin 2015; (ii) formën e shpenzimit të deklarueshëm, si tërësi e vlerës monetare vjetore të shpenzuar për investimin e kryer për ndërtimin e objektit. Ky detyrim është parashikuar me ligjin nr. 85/2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003”, i ndryshuar – vetëm për shpenzimet me vlerë mbi 500.000 lekë gjatë vitit të deklarimit dhe ka hyrë në fuqi në vitin 2012, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit, referuar kohës kur është kryer ky shpenzim prej tij, nuk ndodhej në kushtet e detyrimit ligjor për një deklarim të tillë. Edhe në rastin e konsiderimit të shpenzimeve në fjalë, të shtrira deri në vitin 2013, vërehet se pjesa takuese për vitet 2012 dhe 2013 nuk e kapërcen pragun prej 500.000 lekësh (në vit). Kësisoj, subjekti nuk ka pasur detyrim deklarimi për këtë nivel shpenzimi; (iii) ndërsa, detyrimi për deklarimin e një interesi privat që ka buruar nga ndërtimi i objektit në tokën në pronësi të personave të ndryshëm nga subjekti i rivlerësimit (shtetit në këtë rast) ka lindur sipas ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. Ndërkohë që në rastin konkret, në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit kishte fituar pronësinë e tokës mbi të cilën ishte ndërtuar shtesa, e cila është deklaruar rregullisht prej tij dhe më pas ka aplikuar për legalizimin e saj.

56. Në përfundim të sa më sipër është analizuar, trupi gjykues – referuar kuadrit ligjor të kohës, në të cilin u mor në analizë detyrimi për deklarim, konkretisht ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, si dhe qëndrimin të mbajtur nga Kolegji²⁴ – vlerëson se shpenzimet e kryera nga subjekti për ndërtimin e godinës së banimit në pronësi të tij nuk ka qenë objekt deklarimi, për sa kohë që ky detyrim ka hyrë në fuqi në vitin 2012. Për më tepër, vërehet se, edhe lidhur me periudhën e ekzistencës së këtij detyrimi, konkretisht në vitet 2012 dhe 2013 (nëse ndërtimet e brendshme do të konsiderohen se kanë vijuar deri në vitin 2013) – trupi gjykues, nisur nga rrethanat faktike, çmon se gjithsesi në rastin konkret nuk është përmbushur kriteri sasior i vlerës së shpenzuar për të krijuar/plotësuar kushtet e lindjes së detyrimit për deklarim të investimit vjetor. Gjithsesi, në një gamë më të gjerë konsiderimi, vlen të përmendet se në çdo rast, mosdeklarimi vjetor i një shpenzimi, në kuadër të procesit të rivlerësimit, nuk mjafton për t’u konsideruar në vetvete si një veprim apo mosveprim penalizues dhe, për rrjedhojë, nuk mund të klasifikohet si një deklarim i pamjaftueshëm në kuptim të nenit 33, shkronja “c” dhe/ose “ç” dhe të passjellë aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 – për sa kohë, përpos sa më sipër, në konkluzion bëhet fjalë për një pasuri që është deklaruar rregullisht si pasuri e paluajtshme në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

2. Lidhur me apartamentin e ndodhur në rrugën “**”, Tiranë, në përdorim nga subjekti i rivlerësimit**

57. Në rubrikën e të dhënave konfidenciale të deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dhe ka bashkëlidhur në cilësinë e provave dy marrëveshje bashkëpunimi të lidhura prej tij me shtetasen P.M., – përkatësisht datë 10.8.2010²⁵ dhe datë 15.2.2016. Objekt i këtyre marrëveshjeve ka qenë përdorimi kundrejt shkëmbimit të banesave përkatëse, pa kundërshpërblim, me afat 5-vjeçar secila prej tyre.
58. Nga ASHK Tirana Jug²⁶, pas kërkesave të përsëritura të Komisionit, është bërë me dije se: “Nga verifikimi i kryer në arkivin e këtij institucioni, si dhe sipas sistemit hipotekor ju përcjellim kontratën e shitblerjes nr. “****”, të datës 11.10.2006”. Referuar kësaj kontrate ka rezultuar se znj. P.M., në datën 11.10.2006, ka blerë nga z. B.Th., apartamentin në fjalë, në vlerën 500.000 lekë. Gjithashtu, bashkëlidhur kontratës është përcjellë: (i) një kërkesë për lëshimin e certifikatës së pronësisë së datës 12.10.2006, në emër të znj. P.M; (ii) mandatarkëtimi për aplikimin; si dhe (iii) një hartë treguese e regjistrimit të pasurisë.
59. Në përgjigje të pyetësorit të Komisionit subjekti ka bërë me dije se ndonëse në vitin 2010 është transferuar për të kryer detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ai ka vijuar të jetojë në Shkodër dhe është transferuar së bashku me familjen në Tiranë në vitin 2016, në banesën e znj. M., sipas marrëveshjes së bashkëpunimit të vitit 2016.
60. Nga DPGJC-ja, me shkresën nr. “****” prot., datë 17.5.2022, është bërë me dije se familja Hoxha ka ndryshuar vendbanim në datën 30.7.2015 nga Bashkia Shkodër në Njësinë

²⁴ Vendimi nr. “****” (JR), datë 15.1.2020.

²⁵ Bashkëlidhur marrëveshjes së datës 10.8.2010 ka rezultuar një vërtetim hipotekor me nr. “****”, datë 30.10.2006, për një apartament me sipërfaqe 135 m², në emër të znj. P.M.

²⁶ Me anë të shkresës nr. “****” prot., datë 9.11.2022, ka bërë me dije se nuk disponon dokumentacion fizik të pasurisë, më pas janë përsëritur kërkesat dhe janë administruar përgjigjet me shkresën nr. “****” prot., datë 12.1.2023 dhe shkresën nr. “****” prot., datë 27.12.2022.

Administrative Nr. 2, Tiranë. Ndërsa në Komisarlatin e Policisë, në raportimin e ngjarjes së datës 15.7.2010, si dhe në kallëzimin e bërë në Prokurorinë e Rrethit Tiranë – për një vjedhje që i ishte bërë, subjekti i rivlerësimit, sipas informacionit të përcjellë nga Prokuroria²⁷ – në të dyja rastet ai ka deklaruar adresën bulevardi “****”, Tiranë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 5, subjekti ka deklaruar se dhënia e kësaj adrese është bërë formalisht dhe mund të ketë qenë lapsus, pasi nuk ka asnjë marrëdhënie me këtë adresë.

61. Duke filluar nga viti 2018 e në vijim, subjekti ka deklaruar se ka banuar me qira në një banesë në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k., sipas kontratës së qirasë nr. “****”, datë 16.1.2018, kundrejt vlerës 25.000 lekë/muaj. Në përgjigje të pyetësorëve të Komisionit subjekti është shprehur se çmimi i qirasë është i dakordësuar nga palët me vullnetin e tyre dhe se pagesa e qirasë është bërë *cash* – duke specifikuar se me administratorin/ortakët e shoqërisë qiradhënëse (“****” sh.p.k.) nuk ka pasur ndonjë konflikt interesi. Fakt ky që është konfirmuar edhe nga hetimet e Komisionit, referuar përgjigjeve të gjykatave ku ka ushtruar detyrën subjekti²⁸.
62. Gjithashtu, Komisioni i është drejtuar shoqërisë “****” sh.p.k. (si me shkresë edhe me *email*²⁹) me qëllim administrimin e informacionit dhe/ose dokumentacionit lidhur me mënyrën e kryerjes së pagesave për qiranë nga subjekti – referuar kontratës së qirasë me nr. “****”, datë 16.1.2018, por në të dyja rastet/tentativat, si shkresa ashtu edhe *emaili* janë kthyer mbrapsht, pa u mundësuar ndonjë përgjigje, për shkak të adresave jofunksionale.
63. Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se z. Besnik Hoxha ka qenë porositës i një apartamenti (të ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k.) në vlerën 225.342 euro, nëpërmjet aktit noterial³⁰ nr. “****”, datë 19.1.2011, të nënshkruar pranë noteres M. D.
64. Lidhur me këtë marrëdhënie, Komisioni i është drejtuar disa herë shoqërisë “****” sh.p.k. (fillimisht nëpërmjet kërkesës nr. “****” prot., datë 24.11.2021 dhe më pas me shkresën nr. “****” prot., datë 16.2.2022), duke i kërkuar përcjelljen e dokumenteve që mund të dispononte për pagesat e kryera nga subjekti, por kjo e fundit nuk ka kthyer asnjë përgjigje.
65. Me qëllim kryerjen e një hetimi sa më gjithëpërfshirës, Komisioni administroi nga noterja M. D., kontratën e porosisë³¹. Nga shqyrtimi i saj rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte porositur një apartament me sipërfaqe 147.05 m², me përbërje 3+1, kundrejt çmimit 225.342 euro, çmim i cili do të likuidohej me këste, përkatësisht: (i) shuma 112.671 euro do të likuidohej brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës. Nga kjo shumë, 75.000 euro ishin likuiduar *cash* në momentin e nënshkrimit dhe diferenca prej 37.671 euro do të paguhej sipas këtyre afateve: (i) shuma prej 90.136 euro do të likuidohej brenda muajit qershor 2011; dhe (ii) shuma prej 22.534 euro do të likuidohej me përfundimin e objektit dhe me marrjen në dorëzim të apartamentit.
66. Në vijim, me përgjigjen e datës 3.12.2021, noterja në fjalë ka bërë me dije për Komisionin se nga viti 2015 e në vijim (kur është vënë në funksion RNSH dhe sistemi elektronik NISA), pranë zyrës së saj nuk ka rezultuar ndonjë akt noterial në emër të z. Hoxha. Për periudhat

²⁷ Nëpërmjet shkresës nr. “****” prot., datë 1.3.2022.

²⁸ Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. “****” prot., datë 17.8.2022 dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me shkresën nr. “****” prot., datë 10.6.2022.

²⁹ Me shkresën nr. “****” prot., datë 30.6.2022, si dhe me *emailin* e datës 12.10.2022.

³⁰ Në këtë kontratë subjekti ka rezultuar me mbiemrin “Hoxhaj”.

³¹ Me shkresën nr. “****” prot., datë 12.11.2021.

përpara vitit 2015, ku nuk disponon sistem elektronik, ka kërkuar të dhëna të sakta për datat e kryerjes së veprimeve noteriale. Më tej, në përgjigje të kërkesës së Komisionit³², znj./notere D., ka bërë me dije se pranë zyrës së saj noteriale nuk disponohej asnjë akt revokimi për kontratën e porosisë në fjalë.

67. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti është shprehur se ndonëse ka pasur një kontratë porosie për këtë apartament, kjo pasuri nuk ka kaluar asnjëherë në pronësinë e tij. I pyetur mbi arsyet e mosdeklarimit në DIPP-në e vitit 2011, si dhe në deklaratën *Vetting* të lidhjes së kësaj kontrate porosie, pagesat e kryera, si dhe burimet financiare përkatëse, subjekti është shprehur se në datën 10.1.2011 kishte marrë hua nga shtetasi Ç.T., shumën 107.000 euro, të cilën e ka përdorur për kryerjen e pagesës ndaj shoqërisë shitëse “*****” sh.p.k., ku vlera 75.000 euro është paguar në datën e nënshkrimit të kontratës së porosisë dhe pjesa tjetër brenda 15 ditëve nga kjo datë. Subjekti ka shpjeguar se i ndodhur në kushtet që shuma për t’u kthyer ishte shumë e lartë dhe afati i parashikuar në kontratën e huas ishte i shkurtër, ai e kishte të pamundur kthimin. Për këtë arsye, palët kishin dakordësuar nëpërmjet një deklarate të nënshkruar në dhjetor të vitit 2011, që subjekti të hiqte dorë nga blerja e apartamentit duke u zëvendësuar me huadhënësin, i cili do të vijonte marrëdhënien në cilësinë e porositësit³³. Kësisoj, për sa kohë marrëdhënia ishte prishur brenda vitit, pa prodhuar ndonjë efekt juridik, ai nuk kishte çfarë të deklaronte.
68. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni është konstatuar gjithashtu se subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e dorëzanësit në një kredi të marrë nga z. T., pranë BKT-së. Nga shqyrtimi i kontratës³⁴ së kredisë nr. “****”, datë 3.5.2012, të paraqitur nga subjekti së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 3, ka rezultuar se z. T., i është akorduar një kredi në shumën 19.000.000 lekë me qëllim për blerje shtëpie, në bazë të kontratës së shitjes paraprake nr. “****”, datë 22.12.2011, dhe se kjo shumë do të transferohej në favor të shitësit, shoqërisë “****” sh.p.k. Me anë të deklaratës noteriale nr. “****”, datë 17.5.2012, shoqëria “*****” sh.p.k. ka deklaruar se z. Ç.T., ka kaluar në llogarinë bankare të shoqërisë në BKT, shumën 18.000.000 lekë për blerjen e apartamentit. Nga kjo shumë shoqëria ka mbajtur ekuivalentin e shumës prej 50.000 euro, si këst për blerjen e apartamentit dhe i ka kthyer z. T., diferencën prej 11.047.500 lekësh, jashtë zyrës noteriale.
69. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe ajo Tiranë është bërë me dije se nuk kanë rezultuar çështje të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit me palë shoqërinë “*****” sh.p.k. apo administratorin dhe ortakun e saj, z. G. R., dhe as me shoqërinë “****” sh.p.k., apo administratorët e ortakët e saj B. K., A. P., dhe A. Ç.

³² Kërkesa nr. “****” prot., datë 7.12.2021.

³³ Së bashku me përgjigjet e tij, subjekti ka paraqitur: *Kontratë huaje (e panoterizuar) e datës 10.1.2011, e nënshkruar mes subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit Ç. T., për dhënie hua të shumës prej 110.000 euro, përkatësisht 75.000 euro në datën 15.1.2011 dhe 35.000 euro në datën 31.1.2011, me afat kthimi 5-vjeçar; deklaratë (e panoterizuar) e datës 19.12.2011, nënshkruar mes subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit Ç.T., ku palët kanë rënë dakord që shuma e marrë hua prej 107.500 euro të mos kthehet dhe njëkohësisht që z. T., të bëhet titullar i të drejtave mbi apartamentin e porositur më herët prej subjektit; kontratë paraprake shitjeje me nr. “****”, datë 22.12.2011, e nënshkruar mes shoqërisë “*****” sh.p.k. dhe blerësit z. Ç. T., për blerjen e apartamentit në fjalë nga ana e këtij të fundit dhe njihjen e vlerës së paguar prej 107.500 euro prej subjektit, në favor të z. T.; deklaratë noteriale nr. “****”, datë 22.12.2011, nënshkruar mes shoqërisë “*****” sh.p.k. dhe subjektit të rivlerësimit (me shënimin se kjo deklaratë do të jetë pjesë e kontratës së sipërcituar), në të cilën palët kanë rënë dakord që vlera prej 107.500 euro, e paguar nga subjekti i rivlerësimit, do të kalojë në favor të z. T.; deklaratë noteriale nr. “****”1, datë 22.1.2016, nënshkruar mes shoqërisë “*****” sh.p.k. dhe shtetasit Ç.T., në të cilën kanë deklaruar se në maj të vitit 2013 kanë zgjidhur kontratën e porosisë nr. “****”, datë 22.12.2011 dhe se z. T., i janë kthyer pagesat e kryera.*

³⁴ Paraqitur gjithashtu nga BKT-ja, me shkresën nr. “****” prot., datë 26.5.2022.

70. Ndërsa, në lidhje me znj. P.M., nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër³⁵ është përcjellë një vendim i dhënë nga subjekti për çështjen gjyqësore me objekt “Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë”, në të cilën znj. M., në cilësinë e kërkueses, ka kërkuar lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë të bashkëshortit të saj, të ndjerit A.M., të datës 30.3.2010. Ndërkohë që më pas, në datën 10.8.2010, subjekti ka nënshkruar marrëveshjen për përdorimin e banesës me këtë shtetase.
71. Në lidhje me shtetasin Ç.T., është përcjellë vendimi nr. “****”, datë 3.3.2008, për çështjen me objekt “Deklarimi pjesërisht i pavlefshëm i aktit të lindjes, për sa i përket vendlindjes së fëmijës E. T.”³⁶.
72. Nga SPAK-u³⁷ është bërë me dije se në emër të shtetasve të sipërpërmendur nuk ka rezultuar i regjistruar ndonjë procedim penal.

2.1 Përgjatë hetimit administrativ Komisioni ka administruar dokumentacionin si në vijim:

73. Nga ASHK-ja³⁸ është përcjellë dokumentacioni që i përket pasurisë me nr. “****”, të ndodhur në z. k. “****”. Nga shqyrtimi i tij ka rezultuar se shtetasja Sh.R., nëpërmjet kontratës së porosisë nr. “****”, datë 16.12.2010, kishte porositur tek investitori G.R., apartamentin nr. “****”, të ndodhur në rrugën “****”, hyrja “****”, Tiranë, me sipërfaqe 145 m², kundrejt çmimit 19.720.000 lekë.
74. Në vijim, në kontratën e porosisë me nr. “****”, datë 12.8.2013, znj. R., në cilësinë e palës shitëse, ka deklaruar se në momentin që do të bëhej pronare e ligjshme e apartamentit dhe të pajisej me certifikatë pronësie³⁹ do të lidhte kontratën e shitjes me shtetasen P.M. Çmimi i rënë dakord për shitjen e apartamentit me të dhënat e mësipërme ishte 19.720.000 lekë, dhe i likuiduar jashtë zyrës noteriale.
75. Në datën 25.9.2013 ka rezultuar se me kontratën e shitjes nr. “****”, shoqëria “****” sh.p.k. i ka shitur pasurinë nr. “****”, z. k. “****”, shtetasit G.R., në vlerën 14.500.000 lekë.
76. Më tej, me anë të kontratës nr. “****”, datë 18.11.2015, shtetasi G. R., ia ka shitur këtë pasuri shtetasës Sh.R., kundrejt vlerës 19.720.000 lekë dhe, në vijim, kjo pasuri i është shitur znj. M., nëpërmjet kontratës nr. “****”, datë 23.1.2016, nga znj. R., në vlerën 19.720.000 lekë.
77. Me anë të kontratës nr. “****”, datë 2.12.2017, shtetasja P.M., i ka shitur pasurinë në fjalë shoqërisë “****” sh.p.k. kundrejt vlerës 19.720.000 lekë.
78. Nga FSHU-ja⁴⁰ është bërë me dije se kontrata e furnizimit me energji elektrike nr. “****” është çelur fillimisht në datën 20.11.2012, nga abonenti Ç.T. Më pas, në datën 19.7.2018 është ndryshuar emri i abonentit⁴¹, duke kaluar në emër të shoqërisë “****” sh.p.k. Nga

³⁵ Me shkresën nr. “****” prot., datë 6.12.2021.

³⁶ Analiza mbi konfliktin e mundshëm të interesit për znj. M., dhe z. T., do të bëhet në kreun “Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni”.

³⁷ Me shkresat nr. “****” prot., datë 6.6.2022 dhe nr. “****” prot., datë 26.11.2022.

³⁸ Me shkresën nr. “****” prot., datë 15.8.2022.

³⁹ Certifikata e pronësisë në emër të shtetasës Sh.R., ka dalë në datën 3.12.2015.

⁴⁰ Me shkresën nr. “****” prot., datë 10.5.2022.

⁴¹ Së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka paraqitur librezat për furnizimin me ujë të pijshëm dhe energji elektrike.

UKT-ja⁴² është bërë me dije se kontrata e furnizimit nr. “****” është çelur në muajin mars 2013 në emër të shoqërisë “****” sh.p.k.

79. Nga analiza e të dhënave të mësipërme dhe nga krahasimi i të dhënave kadastrale⁴³ duket se apartamenti, që subjekti ka marrë me qira nga shoqëria “****” sh.p.k., në vitin 2018, dhe ai i përdorur nga subjekti edhe më herët, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit me znj. P.M., në vitin 2016, janë e njëjta pasuri. Po ashtu, nisur nga fakti se kontrata e furnizimit me energji elektrike për këtë apartament, nga viti 2012 deri në vitin 2018, ka qenë në emër të z. T., e më pas është ndryshuar abonenti, duke kaluar në emër të pronarit të ri, shoqëria “****” sh.p.k. – duket se bëhet fjalë gjithashtu, për të njëjtin apartament të porositur nga vetë subjekti i rivlerësimit, në janar të vitit 2011, për të cilin, më pas, në dhjetor të vitit 2011, janë transferuar të drejtat reale në favor të z. Ç.T.
80. Nga dokumentacioni i analizuar, Komisioni ka konstatuar se lidhur me pasurinë në analizë kanë rezultuar një sërë veprimesh noteriale, në disa raste edhe të mbivendosura në kohë. Konkretisht ka rezultuar se përgjatë periudhës 19.1.2011 – maj 2013, ky apartament ka qenë i porositur nga subjekti të shoqëria “****” sh.p.k. dhe më pas transferuar porosia të z. T., ndërkohë që brenda të njëjtës periudhë edhe znj. Sh.R., kishte porositur po këtë apartament nga z. G.R., në cilësinë e investitorit. Për më tepër, znj. Sh.R., ka kryer pagesën për këtë apartament në datën 10.1.2010, referuar mandatarkëtimit nr. “****”, të ndodhur në dokumentacionin e përcjellë nga ASHK-ja.
81. Gjithashtu, nga ALUIZNI ka rezultuar i raportuar një shtetas me gjeneralitetet Besnik Hoxha, i cili ka pasur në proces legalizimi një ndërtesë 3-katëshe me sipërfaqe parcele 312 m², në Njësinë Bashkiake Nr. “****”, Tiranë, por nuk kishte informacion nëse bëhej fjalë për subjektin e rivlerësimit dhe nëse veprimet juridike janë kryer prej tij. Në vijim të këtij raportimi, Komisioni i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së, e cila me shkresën nr. “****” prot., datë 31.12.2021, ka bërë me dije se subjekti i rivlerësimit nuk ka rezultuar aplikues për legalizim të ndërtimeve pa leje me vendndodhje në Njësinë Administrative Nr. “****”. Gjithashtu, ASHK Tirana Jug, me shkresën nr. “****” prot., datë 16.6.2022 dhe ASHK Tirana Veri, me shkresën nr. “****” prot., datë 23.6.2022, kanë bërë me dije se nga verifikimet e kryera nuk ka rezultuar praktikë legalizimi në emër të subjektit të rivlerësimit.

2.2 Lidhur me pasuritë e përdorura nga subjekti – sipas dy marrëveshjeve

82. Komisioni, përgjatë hetimit administrativ, ka konstatuar një sërë faktesh që vlejné të analizohen të parë në tërësinë tyre, dhe konkretisht:
- Ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit është transferuar për të ushtruar detyrën në qytetin e Tiranës në muajin prill 2010, ndërkohë që marrëveshja e parë e bashkëpunimit me znj. M., është lidhur në muajin gusht 2010.
 - Ndonëse nga subjekti është pohuar se ai dhe familja e tij kanë vijuar të jetojnë në qytetin e Shkodrës edhe përgjatë periudhës 2010 – 2015, nga Ministria e Arsimit⁴⁴ dhe nga

⁴² Me shkresën nr. “****” prot., datë 1.6.2022.

⁴³ Apartament nr. “****” me nr. pasurie “****”, vol. “****”, f. “****”, në z. k. “****”, me adresë rruga “****”, shk. 1, k. 3, Tiranë.

⁴⁴ Me shkresën nr. “****” prot., datë 6.12.2022.

Zyra Vendore Arsimore Tiranë⁴⁵ është bërë me dije se djali i subjektit E.H., dhe vajza e subjektit Xh.H., gjatë viteve 2010 – 2017, kanë studiuar në Tiranë.

- c. Gjithashtu, ka rezultuar se edhe bashkëshortja e subjektit ka qenë e punësuar në Tiranë së paku nga data 1.6.2011 e në vijim.
 - d. Subjekti ka porositur një apartament te shoqëria “****” sh.p.k., në vlerën 225.342 euro, nëpërmjet aktit noterial⁴⁶ nr. “****”, datë 19.1.2011.
 - e. Sipas deklaratës noteriale nr. “****”, datë 22.12.2011, nënshkruar mes shoqërisë “****” sh.p.k. dhe subjektit të rivlerësimit, me të cilën palët kanë rënë dakord që vlera prej 107.500 euro, e paguar nga subjekti i rivlerësimit – në momentin e porosisë do të kalojë në favor të z. T., të cilit po të njëjtën ditë i kanë kaluar edhe të drejtat reale të pritshme mbi këtë pasuri – duke e zëvendësuar kështu subjektin, në cilësinë e porositësit.
 - f. Në deklaratën noteriale nr. “****”, datë 22.1.2016, nënshkruar mes shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasit Ç.T., kanë deklaruar se në maj të vitit 2013 kanë zgjidhur kontratën e porosisë nr. “****”, datë 22.12.2011 dhe se z. T., i janë kthyer të gjitha pagesat e kryera.
 - g. Por, i njëjti apartament, ndërkohë, ishte porositur më herët edhe nga shtetasja Sh. R., nëpërmjet kontratës së porosisë me nr. “****”, datë 16.12.2010, e cila, nëpërmjet një tjetër kontrate premtim shitjeje nr. “****”, datë 12.8.2013 – këtë herë në cilësinë e palës shitëse – ka deklaruar se në momentin që do të bëhej pronare e ligjshme e apartamentit në fjalë dhe të pajisej me certifikatë pronësie⁴⁷ do të lidhte kontratën e shitjes me znj. P. M.
 - h. Në vijim, kjo pasuri i është shitur znj. M., nëpërmjet kontratës nr. “****”, datë 23.1.2016, nga znj. R., në vlerën 19.720.000 lekë.
 - i. Me anë të kontratës nr. “****”, datë 2.12.2017, shtetasja P.M., i ka shitur pasurinë në fjalë shoqërisë “****” sh.p.k., kundrejt vlerës 19.720.000 lekë, për shitjen e së cilës znj. M., është përfaqësuar nga z. D. M.T., me prokurën e datës 22.6.2017, i cili duket se është vëllai i z. Ç. T.
 - j. Ndërkohë, FSHU-ja ka bërë me dije se kontrata e furnizimit me energji elektrike me nr. “****” është çelur fillimisht në datën 20.11.2012 nga abonenti Ç.T. Më pas, në datën 19.7.2018 është ndryshuar emri i abonentit⁴⁸, duke kaluar në emër të shoqërisë “****” sh.p.k.
83. Nisur nga sa është përshkruar më lart, nga Komisioni, nëpërmjet një vlerësimi të përgjithshëm të fakteve të rezultuara nga hetimi administrativ – të para këto në ndërthurje midis dinamikave ndërvepruese e zëvendësuese në kohë dhe deklarimeve apo veprimeve juridiko-faktike, të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose nga persona të tjerë të lidhur me të, në raport me rrethanat kontekstuale dhe efektet faktike të prodhuara – lidhur me këtë pasuri është konstatuar ekzistenca e një marrëdhënieje interesi të pandërprerë të subjektit

⁴⁵ Me shkresën nr. “****” prot., datë 30.11.2022.

⁴⁶ Në këtë kontratë subjekti ka rezultuar me mbiemrin “Hoxhaj”.

⁴⁷ Certifikata e pronësisë në emër të shtetasës Sh.R., ka dalë në datën 3.12.2015.

⁴⁸ Së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka paraqitur librezat për furnizimin me ujë të pijshëm dhe energji elektrike.

të rivlerësimit, duke filluar nga kontrata e porosisë, e nënshkruar prej tij, në janar të vitit 2011. Për më tepër, edhe ndryshimet, revokimet e transferimet e mëtejshme të të drejtave reale të kontraktuara e qarkulluara *de jure* për këtë apartament – të cilat duket se janë kryer me dijeninë dhe për llogari të subjektit të rivlerësimit nga persona të njohur dhe pranë tij, duket se kanë pasur për qëllim, së paku, vijimësinë e posedimit *de facto* të kësaj pasurie, për sa kohë ka rezultuar se përdoruesi i vetëm dhe i vazhdueshëm i saj ka qenë subjekti dhe familja e tij.

84. Gjithashtu, lidhur me këtë pasuri, nga ana e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit është paraqitur një opinion me shkrim, i njoftuar me shkresën nr. “****” prot., datë 16.2.2023, përmbajtja e të cilit – ndonëse është mbajtur në konsideratë përgjatë hartimit të këtij relacioni – do të jetë objekt diskutimi dhe vlerësimi nga trupi gjykues në fazat e mëtejshme të procesit të rivlerësimit.
85. Nisur nga sa më sipër, Komisioni, duke u bazuar në faktet e konstatuara dhe nën dritën e detyrimeve që rrjedhin për institucionet e rivlerësimit për të hetuar e vlerësuar edhe pasuritë në përdorim, sipas pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, në rastet e përdorimit të dyshimtë – (si në këtë rast, pa kundërshtpërblim faktik dhe ekskluziv) – dhe në funksion të verifikimit të rrethanave që mund të ngrenë dyshime për fshehjen, mosdeklarimin apo paraqitjen/deklarimin në mënyrë të pasaktë të pasurive, ka vlerësuar të nevojshëm hetimin mbi burimet e ligjshme të krijimit të kësaj pasurie.

2.2.1 Analiza e burimeve të ligjshme të huadhënësit

86. Subjekti ka deklaruar se si burim për kryerjen e pagesës së kështit të parë, sipas kontratës së porosisë, ka shërbyer një hua në vlerën 107.500 euro, e marrë nga shtetasi Ç.T. Nëpërmjet pyetësorit nr. 3, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të paraqesë dokumentacionin që provon burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit, z. T., për këtë shumë prej 107.500 euro. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka paraqitur dokumentacionin si në vijim:
- kontratë shitblerjeje nr. “****”, datë 12.12.2003, për shitjen e një pasurie kundrejt çmimit 1.900.000 lekë;
 - kontratë shitblerjeje nr. “****”, datë 28.9.2006, për shitjen e një pasurie kundrejt çmimit 500.000 lekë;
 - vërtetim nr. “****” prot., datë 9.6.2022, lëshuar nga “Credins Bank” për marrjen e një kredie nga z. T., në datën 28.10.2010, në shumën 50.000 euro;
 - vërtetim për të ardhurat nga emigracioni në shtetin italian, në total 25.886 euro, përgjatë periudhës 1.1.1996 – 7.8.1998.
87. Përveç sa më sipër, subjekti ka cituar në përgjigjet e tij edhe një kontratë shitblerjeje me nr. “****”, datë 12.5.2004, të shitur kundrejt çmimit 1.000.000 lekë, por që nuk është paraqitur prej tij së bashku me përgjigjet e pyetësorit. Lidhur me të ardhurat e dokumentuara nga emigracioni në shtetin italian të z. T., Komisioni ka përlllogaritur shpenzimet e jetesës në shtetin italian për një person, të cilat për periudhën 1996 – 1998, referuar të dhënave zyrtare të Eurostatit, që kanë qenë rreth 14.704 euro. Në të gjitha rastet, duket se pjesa e mbetur nga këto të ardhura, prej 11.182 euro, do të ishte e mjaftueshme vetëm për të mbuluar

shpenzimet e jetesës në Shqipëri për periudhën e mëpasshme 11-vjeçare, duke mos ndikuar në analizën financiare.

88. Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni ka kërkuar nga DRT-ja Shkodër⁴⁹ informacion lidhur me të ardhurat e realizuara nga aktiviteti tregtar i shtetasit Ç.T. Në përgjigje të kërkesës së sipërcituar, ky institucion⁵⁰ ka bërë me dije se tatimpaguesi në fjalë figuron i çregjistruar dhe se nuk disponon të dhëna për aktivitetin e tij tregtar.
89. Komisioni i është drejtuar gjithashtu “Credins Bank”, duke kërkuar informacion mbi destinacionin e shumës së kredisë të marrë nga z. T. Banka, me anë të shkresës nr. “****” prot., datë 18.7.2022, ka paraqitur kontratën e kredisë nr. “****”, datë 26.10.2010, me anë të së cilës z. T., i është akorduar një kredi në shumën 50.000 euro, me qëllim për investime (ndërtim godine).
90. Përpos faktit që duket se nuk ka logjikë ekonomike në dhënien e një huaje pa interes, ndërkohë që kredia nga vetë z. T., është marrë me interes – nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarisë së kredisë duket se vetëm shuma prej 21.200 euro është tërhequr *cash* nga z. T., dhe që mund t’i jepej subjektit – ndërkohë që pjesa tjetër është transferuar në favor të palëve të treta për likuidim punimesh.
91. Megjithëse shuma në fjalë, prej 107.500 euro, i është rikthyer huadhënësit brenda vitit në formën e kalimit të të drejtave reale të pritshme nga subjekti, në cilësinë e porositësit të apartamentit, ndonëse kjo shumë nuk ka shërbyer si burim i mirëfilltë financiar për një pasuri të krijuar/finalizuar nga subjekti, Komisioni, nisur nga dyshimet e lartpërmendura, ka kryer analizën financiare edhe për këtë rast, nga ku ka rezultuar një mungesë e burimeve të ligjshme financiare, rreth 9.5 milionë lekë, të z. T., për t’i dhënë huan në fjalë subjektit të rivlerësimit, sikurse përshkruhet në tabelën në vijim.

Analiza financiare për huadhënësin

Te ardhura nga shitja e pasurive te paluajtshme	2,400,000
Te ardhura nga kredia bankare	2,942,772
Dhene hua subjektit	(14,867,250)
Rezultati	(9,524,478)

2.2.2 Analiza e burimeve të ligjshme të blerjes nga znj. M.

92. Gjithashtu, nisur nga fakti që në vitin 2016, përgjatë periudhës që apartamenti në analizë është përdorur nga subjekti, pa kundërshtim, pronare e tij ka qenë shtetasja P. M., si dhe mbështetur edhe në dyshimet e ngritura nga faktet, rrethanat dhe dokumentet e rezultuara përgjatë hetimit administrativ dhe të përmendura më sipër, Komisioni ka vlerësuar të analizojë edhe mundësitë financiare të krijimit të kësaj pasurie nga znj. M.
93. Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se me kontratën e porosisë nr. “****”, datë 12.8.2013, znj. M., dhe znj. Sh.R., kanë dakordësuar që në momentin që znj. R., do të bëhej pronare e ligjshme e apartamentit dhe të pajisej me certifikatë pronësie do të lidhte

⁴⁹ Me kërkesën nr. “****” prot., datë 16.9.2022.

⁵⁰ Me shkresën nr. “****” prot., datë 26.9.2022.

kontratën e shitjes me znj. P.M., kundrejt çmimit 19.720.000 lekë, të paguar jashtë zyrës noteriale.

94. Bazuar në sa më sipër, gjatë hetimit, Komisioni ka kërkuar informacion nga ASHK-ja me qëllim verifikimin e pasurive të mundshme të tjetërsuara nga znj. M., deri në datën e nënshkrimit të kontratës së porosisë, 12.8.2013. Konkretisht, ka rezultuar se:

- a. Nga ASHK për Zonat e Stimuluara⁵¹ është bërë me dije se znj. M., në vitin 2014 ka aplikuar për legalizimin e një ndërtese të ndodhur në Velipojë, për të cilën, nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëngjitur ka rezultuar se ajo është paditur për përmbushje të detyrimit kontraktor për të regjistruar në emër të palës paditëse pasuritë sipas kontratave noteriale. Nga përmbajtja e vendimit nr. “****”, datë 10.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka rezultuar se bashkëshorti i znj. M., z. A., në cilësinë e pronarit të pallatit, me anë të kontratave të kaparit nr. “****”, datë 23.11.2007 dhe nr. “****”, datë 21.1.2007, ka shitur disa pasuri të paluajtshme palëve paditëse, kundrejt çmimit, përkatësisht, 85.190 euro dhe 31.360 euro, të likuiduara plotësisht nga pala blerëse.
- b. Nga ASHK Durrës⁵² është bërë me dije se znj. M., rezulton bashkëpronare në një pasuri të llojit truall, me pjesë takuese 20/160, të përfutuar me kontratën e dhurimit nr. “****”, datë 12.3.2009.
- c. Nga përgjigjet e ASHK-ve në rrethe nuk kanë rezultuar pasuri të tjera të regjistruara/përfutura në emër të znj. M., përgjatë periudhës së analizuar.

95. Nga Ministria e Drejtësisë⁵³ është përcjellë informacioni sipas RNSH-ja për aktet e nënshkruara nga znj. M., për periudhën 23.9.2013 e në vijim (që datojnë pas nënshkrimit të kontratës së porosisë me znj. R., dhe likuidimit të çmimit të blerjes).

96. Nga DPSHTRR-ja⁵⁴ është bërë me dije se deri më 31.3.2013, znj. M., ka pasur në pronësi 3 automjete, si dhe ka vënë në dispozicion një kontratë shitjeje të datës 23.3.2012, në vlerën 6.000 euro dhe dy kontrata blerjeje automjetesh, përkatësisht të datës 11.3.2010 në vlerën 7.000 euro dhe të datës 13.12.2011 në vlerën 300.000 lekë.

97. Nga DRT Shkodër⁵⁵ është bërë me dije se znj. M., ka përfutuar të ardhura nga aktivitetet tregtare, si në vijim:

- a. Nga aktiviteti tregtar i shoqërisë “****” sh.p.k., znj. M., ka tërhequr dividend gjatë viteve 2007 – 2008, në shumën 10.020.005 lekë.
- b. Nga aktiviteti tregtar i shoqërisë “****” sh.p.k., znj. M., ka tërhequr dividend në vitin 2011, prej 246.964 lekësh.
- c. P.M., person fizik, gjatë viteve 2008 – 2012 ka realizuar një fitim total prej 1.581.938 lekësh.
- d. A. M., person fizik, ka realizuar në vitin 2009 një fitim prej 429.563 lekësh.

⁵¹ Me shkresën nr. “****” prot., datë 18.1.2023.

⁵² Me shkresën nr. “****” prot., datë 23.1.2023.

⁵³ Me shkresën nr. “****” prot., datë 10.1.2023.

⁵⁴ Me shkresën nr. “****” prot., datë 10.1.2023.

⁵⁵ Me shkresën nr. “****” prot., datë 7.12.2022.

98. Komisioni ka administruar gjithashtu llogaritë bankare⁵⁶ të shtetases P.M., dhe aktivitetet tregtare të ushtruara prej saj, deri në momentin e blerjes së pasurisë në fjalë. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarive bankare, ndër të tjera, kanë rezultuar disa transfertat bankare ndër vite, në favor të znj. M., apo në llogaritë e përbashkëta me bashkëshortin e saj⁵⁷ dhe të tërhequra prej tyre, në shumat totale 321.304 euro dhe 10.342.590 lekë, me përshkrimin përkatësisht për blerje apartamenti apo dyqani, të detajuara konkretisht si vijon:
- gjatë vitit 2007 kanë rezultuar transfertat e shumave, përkatësisht, 7.914.660 lekë në BKT dhe 29.000 euro në “Union Bank”;
 - gjatë vitit 2008 kanë rezultuar transfertat e shumës 159.814 euro në BKT;
 - gjatë vitit 2009 kanë rezultuar transfertat e shumës 34.000 euro në BKT;
 - gjatë vitit 2010 kanë rezultuar transfertat e shumave 25.000 euro dhe 2.427.930 lekë në BKT, si dhe 4.990 euro në “OTP Bank” (ish “Alpha Bank”);
 - gjatë vitit 2011 kanë rezultuar transfertat e shumave 30.000 euro në “Intesa Sanpaolo Bank”, si dhe 15.000 euro në “OTP Bank” (ish “Alpha Bank”);
 - gjatë vitit 2012 kanë rezultuar transfertat e shumave 8.500 euro në “Raiffeisen Bank”, si dhe 15.000 euro në “OTP Bank” (ish “Alpha Bank”).
99. Komisioni, në vijim të sa më sipër, ka përlllogaritur mundësinë financiare të znj. P. M., për të mbuluar shpenzimet⁵⁸ e jetesës së familjes së saj dhe investimet e kryera prej tyre në pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, si dhe për të blerë dy apartamentet në fjalë, të dhënë në përdorim subjektiv të rivlerësimit. Me të dhënat e disponuara nga Komisioni, duke përfshirë të ardhurat e mësipërme, të rezultuara nga tërësia e dokumentacionit të administruar nga Komisioni për këtë qëllim, ka rezultuar se znj. P.M., si në datën 11.10.2006⁵⁹ edhe në datën 12.8.2013⁶⁰, duket se ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e apartamentit në analizë, në shumën 19.720.000 lekë, të dhënë në përdorim subjektiv të rivlerësimit, sipas detajimit në tabelën e mëposhtme.

Analiza financiare për znj. M.,

Te ardhura nga shitja e pasurive sipas V. GJ.	14,092,061
Te ardhura nga shitja e pasurive sipas bankave	51,868,880
Te ardhura nga shitja e automjetit	838,320
Te ardhura nga terheqja e dividendeve	12,278,470
Te ardhura nga pagat	2,713,721
Te ardhura nga qiradhenia	2,227,500
Shpenzime jetese 2007 - 2013	(4,405,523)
Blere automjetet	(1,271,670)
Ndryshimi ne likuiditetet bankare	(88,248)
Blere apartamenti ne 12.8.2013	(19,720,000)
Rezultati	58,533,511

⁵⁶ Me shkresën nr. “****” prot., datë 21.12.2022.

⁵⁷ Referuar vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i ndjeri A.M., ka ndërruar jetë në datën 12.3.2010.

⁵⁸ Të përlllogaritura në bazë të të dhënave të INSTAT/për frymë, për 4 persona, referuar të dhënave nga gjendja civile.

⁵⁹ Kur ka blerë apartamentin nga z. B. Th., në vlerën 500.000 lekë – që më pas ia ka dhënë në përdorim subjektiv, me aktmarrëveshjen e datës 10.8.2010.

⁶⁰ Kur ka blerë apartamentin në analizë, në rrugën “*****”, që më pas ia ka dhënë në përdorim subjektiv, me aktmarrëveshjen e datës 15.2.2016.

100. Komisioni e ka ftuar⁶¹ znj. M., për t'u paraqitur për të dëshmuar në cilësinë e dëshmitares por, pavarësisht disa tentativave nga punonjësi i postës, nuk është mundësuar dorëzimi i ftesës dhe zarfi me shkresën në fjalë është kthyer pas, me shënimin “Objekt i pakërkuar”.

2.2.3 Analiza e burimeve financiare të ligjshme të blerjes së apartamentit në analizë, nga shoqëria “***” sh.p.k.**

101. Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni ka kryer gjithashtu verifikime dhe vlerësime edhe për sa i takon burimeve të ligjshme financiare të shoqërisë “*****” sh.p.k., për të blerë, në vitin 2017, apartamentin në rrugën “*****” – më pas të dhënë me qira subjektit të rivlerësimit. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se shoqëria në fjalë ka kryer pagesën për shlyerjen e çmimit të blerjes për këtë pasuri, nëpërmjet llogarisë bankare pranë BKT-së, në favor të noterës, në datën 12.12.2017. Nga shqyrtimi i pasqyrave financiare të dorëzuara në QKB, të kësaj shoqërie, ka rezultuar se është deklaruar edhe shtimi i zërit të aktiveve afatgjata në bilancin e vitit 2017, pikërisht me vlerën 19.720.000 lekë, shumë e cila përputhet me çmimin e blerjes së kësaj pasurie. Nga shqyrtimi i pasqyrave financiare ka rezultuar gjithashtu se shoqëria “*****” sh.p.k., gjatë vitit 2017, ka realizuar të ardhura nga aktiviteti i vet në masën 125.609.551 lekë, si dhe ka shtuar detyrimet ndaj institucioneve të kredisë, së paku me 36.835.741 lekë. Ky disponibilitet financiar i shoqërisë “*****” sh.p.k. është vlerësuar i mjaftueshëm për blerjen e pasurisë në analizë.
102. Në përmbledhje të sa është përshkruar dhe analizuar më lart në lidhje me këtë pasuri, si dhe duke mbajtur në vëmendje se subjekti i rivlerësimit është transferuar me punë në qytetin e Tiranës në vitin 2010, duke nisur të banojë aty bashkë me familjen e tij – edhe pse në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni është bërë me dije se ata kanë vijuar të jetojnë në qytetin e Shkodrës deri në vitin 2016⁶².
103. Në këto kushte, Komisioni ka konkluduar se subjekti dhe familja e tij kanë filluar të banojnë prej vitit 2010 në rrugën “*****”, Tiranë, dhe kanë vijuar të banojnë në mënyrë të pandërprerë në të njëjtin apartament – të porositur më herët prej tij në vitin 2011, edhe pse më pas ka hequr dorë nga kjo porosi (në fund të vitit 2011).
104. Komisioni ka vlerësuar se për këtë apartament duket se nga viti 2010 deri në vitin 2016, lidhur me të drejtat reale ka pasur veprime juridiko-financiare, të paarsyeshme, paralele dhe madje edhe të mbivendosura (konkretisht: porosi, premtime shitje, revokime, pagesa, hua, kredi e kalim të drejtash të vazhdueshme), ndërsa nga ana tjetër ka vijuar i pandërprerë përdorimi i kësaj pasurie, prej fillimit e deri aktualisht, vetëm nga subjekti dhe familja e tij.
105. Kontrata e furnizimit me energji elektrike, për këtë apartament, ka qenë e lidhur në emër të z. Ç.T., prej vitit 2012 e deri në vitin 2018, kur kjo kontratë kalon më tej në emër të shoqërisë “*****” sh.p.k., ndonëse z. T., e kishte revokuar shumë më herët porosinë e kësaj pasurie – sikurse kishte bërë edhe vetë subjekti, duke ia kaluar këtij të fundit të

⁶¹ Me shkresën nr. “*****” prot., datë 21.10.2022.

⁶² Lidhur me këtë përgjigje, pas njohjes me rezultatet e hetimit subjekti është shprehur se ky qëndrim ka qenë një keqpasqyrim i fakteve nga avokati i tij – (me prokurë të depozituar pranë Komisionit përpara se sa të nisej pyetësori në fjalë) – që ka formuluar përgjigjet përkatëse dhe ia ka nisur Komisionit. Kjo ka ndodhur për shkak të mbingarkesës në punë të subjektit dhe mungesës së kohës së nevojshme për t'u marrë pikërisht me studimin, gjetjen e dokumenteve e përgatitjen e përgjigjeve të pyetësorëve.

drejtat e pritshme mbi të njëjtën pasuri. Shtetasi Ç.T., nuk ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për dhënien e huas, të marrë dhe përdorur nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me pagesat fillestare për këtë pasuri. Për shitjen e pasurisë në fjalë, në dhjetor të vitit 2017, znj. M., ka autorizuar me prokurë për kryerjen e këtij transaksioni z. D. T., – që është vëllai i z. Ç. T.

106. Nisur nga sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të dhënë shpjegime bindëse dhe për të paraqitur dokumente ligjore për të provuar të kundërtën e rezultateve të mësipërme lidhur me këtë pasuri dhe, konkretisht, lidhur me konstatimet në vijim:

- *Duket se subjekti i rivlerësimit ka qenë dhe vijon të jetë i vetmi përdorues/posedues, në mënyrë të pandërprerë, i pasurisë në analizë, ndonëse ndër vite janë ndryshuar porosities dhe pronarët e apartamentit në fjalë. Në këto kushte, Komisioni ngre dyshime se kjo mund të jetë një pasuri e krijuar me mjete financiare të subjektit të rivlerësimit për llogari të tij dhe e padeklaruar, me qëllim shmangien e verifikimit të burimeve të përdorura për krijimin e saj.*
- *Duket se huadhënësi, z. T., ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, prej -9.524.478 lekësh, për dhënien e huas prej 107.500 euro, subjektit. Për rrjedhojë, duket se subjekti i rivlerësimit, në momentin e kryerjes së pagesës së kështit të parë të apartamentit në analizë, ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej -9.524.478 lekësh.*
- *Duket se ka pasur një deklaram të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit, përgjatë procesit të rivlerësimit, sa i përket vendbanimit të familjes së tij, përgjatë periudhës 2010 – 2015.*

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

107. Subjekti ka shpjeguar se znj. M., ka përdorur banesën e subjektit, për sa kohë ajo ka pasur nevojë për të banuar në një banesë të ndryshme nga banesa e ish-bashkëshortit të saj, për shkak të veprimtarisë dhe rrethanave familjare të saj – pasi bashkëshorti i saj kishte ndërruar jetë. Kjo situatë e kishte shtyrë atë që të ndërronte ambientin/zonën e banimit, për të rikuperuar sadopak një lloj qetësie psikologjike dhe faktike – të munguar në atë periudhë, për shkak të lëndimit nga humbja e bashkëshortit dhe nga dinamikat rrethore e ndërfamiljare jopozitive.

108. Nga ana tjetër, subjekti ka kundërshtuar konstatimin e Komisionit se apartamenti në rrugën “*****”, në Tiranë, është përdorur prej tij nga viti 2010 e në vijim, duke pohuar e specifikuar se kjo pasuri është përdorur prej tij dhe familja e tij nga viti 2016 edhe në vazhdim. Subjekti ka theksuar se marrëveshja e vitit 2010 me znj. P. M., ka qenë për një banesë tjetër të saj, me vendndodhje në rrugën “*****”, dhe jo për pasurinë e lartpërmendur në rrugën “*****”. Gjithashtu, subjekti saktëson se në vitin 2010, apartamenti dhe pallati përkatës në rrugën “*****”, Tiranë, nuk ekzistonte ende (fizikisht si pallat). Subjekti, në mbështetje të këtij pretendimi, ka paraqitur, veç të tjerash provat/imazhet satelitore të viteve 2009 dhe 2012, që i referohen vendndodhjes së

apartamentit në analizë, nga ku konstatohet inekzistenca e pallatit në fjalë, në periudhën e transferimit të tij nga Shkodra në Tiranë.

109. Ndërkohë, subjekti i rivlerësimit ka pranuar se nga përgjigjet e dhëna gjatë hetimit administrativ, duket sikur është deklaruar se gjatë periudhës 2010 – 2015 ka jetuar vetëm në Shkodër, por në atë periudhë në qytetin e Shkodrës ka qenë vetëm vendbanimi formal i familjes së tij pranë gjendjes civile përkatëse. Subjekti ka saktësuar se ky konfuzion ka ardhur për shkak se përgjigjet e pyetësorëve i ka plotësuar dhe nisur në Komision përfaqësuesi i tij ligjor (av. J. M.) – i cili kishte tagër bazuar në aktin e përfaqësimit të dhënë prej tij dhe të depozituar pranë Komisionit më herët nga koha kur janë nisur pyetësorët dhe kthyer përgjigjet përkatëse. Sipas subjektit, për shkak të mbingarkesës së jashtëzakonshme në atë periudhë, të këtij të fundit në punë, përgatitja dhe nisja e përgjigjeve të pyetësorit në fjalë ishte deleguar tek avokati i tij, me prokurë të posaçme pikërisht për asistencë përgjatë procesit të rivlerësimit. Pikërisht, avokati në fjalë, duke iu referuar të dhënave zyrtare të gjendjes civile, lidhur me vendbanimin e subjektit, ka formuluar një përgjigje që nuk pasqyronte realitetin faktik, por atë formalo-zyrtar, duke mos i kushtuar rëndësi këtij detaji, nëse vendbanimi faktik ishte i ndryshëm nga ai zyrtar. Gjithashtu, edhe deklarimi i adresës në rrugën “*****”, sipas subjektit, ka qenë një lapsus në hartimin e përgjigjeve nga ana e përfaqësuesit ligjor, duke bërë konfuzion midis dy aktmarrëveshjeve të lartpërmendura. Ndërsa, lidhur me deklarimin e tij në polici në vitin 2010, në të cilin ai ka deklaruar si adresë bulevardi “*****”, subjekti ka shpjeguar se kjo adresë nuk ka asnjë lidhje me apartamentin e ndodhur në rrugën “*****”, pasi ngjarja e raportuar prej tij në polici kishte ndodhur në korrik të vitit 2010 dhe në këtë periudhë nga njëra anë ai nuk kishte nënshkruar marrëveshjen me znj. M., dhe nga ana tjetër – siç është provuar – asokohe pallati në rrugën “*****” ende nuk ishte ndërtuar.
110. Lidhur me këtë pikë, subjekti ka ritheksuar se ai është transferuar për të ushtruar detyrën në qytetin e Tiranës në muajin prill 2010 dhe marrëveshja e bashkëpunimit me znj. M., është lidhur në muajin gusht 2010. Gjatë kësaj periudhe familja e tij ishte në Shkodër dhe atij i ka shërbyer kjo periudhë për të dorëzuar dosjet dhe vendimet e marra deri në ditën e transferimit, si dhe për të kërkuar e gjetur një banesë stabël në qytetin e Tiranës. Pas marrëveshjes, subjekti dhe familja e tij janë transferuar në Tiranë në rrugën “*****”, ku kanë banuar deri pas marrëveshjes së vitit 2016, kur kanë nisur të banojnë pikërisht në apartamentin e ndodhur në rrugën “*****”, Tiranë.
111. Sikurse u citua edhe më sipër, përgjatë seancës dëgjimore përfaqësuesja e subjektit ka paraqitur në cilësinë e provës një ortofoto të vitit 2009, nga ku rezulton qartësisht se pallati ku ndodhet apartamenti në analizë nuk ishte ndërtuar ende, pasi nga fotoja dukej se në atë zonë ishte vetëm një shtëpi e vjetër dhe e mbushur me gjelbërim. Për rrjedhojë, dyshimi se subjekti mund të kishte banuar aty, nuk mund të ekzistojë për sa kohë nuk ka ekzistuar as pallati përkatës.
112. Në lidhje me mosdeklarimin e pasurisë në përdorim përgjatë viteve 2010 – 2015, në DPV-të vjetore, subjekti ka sqaruar se ka menduar se nuk ishin objekt deklarimi pasuritë në përdorim, ndonëse ai nuk e ka fshehur këtë fakt, për sa kohë ka lidhur edhe aktmarrëveshje noteriale, të paraqitura më pas në organin kompetent (ILDKPKI).

113. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se *apartamenti i porositur nga subjekti në vitin 2011 ka rezultuar i porositur më herët edhe nga shtetasja Sh. R., nëpërmjet kontratës së porosisë me nr. “****”, datë 16.12.2010, e cila, nëpërmjet një tjetër kontrate premtim shitjeje nr. “****”, datë 12.8.2013, këtë herë në cilësinë e palës shitëse, ka deklaruar se në momentin që do të bëhej pronare e ligjshme e apartamentit në fjalë dhe të pajisej me certifikatë pronësie⁶³ do të lidhte kontratën e shitjes me znj. P. M., subjekti është shprehur se kontrata noteriale e porosisë midis shoqërisë dhe znj. R., është lidhur përpara se ai të porosishte një apartament te kjo shoqëri. Gjithashtu, theksohet se nga krahasimi i kontratave të porosisë (dhjetor 2010 dhe janar 2011) duket se nuk bëhet fjalë për të njëjtin apartament. Megjithatë, duke qenë se në vitin 2011, sigurisht apartamenti nuk ishte i ndërtuar, por ishte vetëm diçka nëpër skica, subjekti ka sqaruar se nuk mund të shprehet me siguri për këtë fakt të konstatuar nga Komisioni, por që nuk lidhet me veprimet e tij, por të personave të tretë.*
114. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se *kanë rezultuar veprime juridiko-financiare, paralele dhe të mbivendosura*, subjekti ka shpjeguar se ato nuk kanë të bëjnë me të, por me shoqërinë ndërtuese dhe me persona të tjerë, për të cilat ai as nuk mund të njohë faktet dhe as nuk mund të bëhet përgjegjës për këtë.
115. Për sa i përket marrëdhënies së znj. M., me vëllezërit T.⁶⁴, subjekti është shprehur se ajo ka njohje dhe marrëdhënie shoqërore të hershme dhe autonome (nga subjekti) me këta të fundit dhe mund të ketë ardhur në dijeni për revokimin e kontratës në fjalë, pikërisht nga z. T., (gjithmonë nëse apartamentet janë të njëjta), në vitin 2013, e më pas mund të ketë shfaqur interes për blerjen e këtij apartamenti – duke autorizuar z. D.T., me prokurën nr. “****”, datë 2.12.2017, për kryerjen e këtij transaksioni, si një person që e njihte prej kohësh dhe që kishte besim. Sipas subjektit, shitja dhe blerja e kësaj pasurie disa herë nga disa shtetas, tregon të kundërtën e konkluzionit të Komisionit dhe, për rrjedhojë, gjetja e njoftuar nga Komisioni se *kjo banesë mund të jetë një pasuri e krijuar me mjete financiare të subjektit të rivlerësimit, për llogari të tij dhe e padeklaruar*, sipas tij është një hipotezë krejt e pabazuar në fakte dhe në ligj.
116. Lidhur me analizën e burimeve të ligjshme të huadhënësit, z. Ç. T., – veç faktit kryesor që kjo hua është kthyer brenda pak muajsh dhe nuk ka krijuar asnjë përfitim për subjektin – ky i fundit është shprehur se ndryshe nga vlerësimi i Komisionit (të cilit i ka rezultuar një mungesë e burimeve të ligjshme financiare, në vlerën rreth 9.5 milionë lekë), z. T., ka pasur mundësi që të krijojë me të ardhura të ligjshme shumë e dhënë hua, si dhe ka paraqitur në cilësinë e provës dokumentacionin në vijim:
- *kontratë shitblerjeje nr. “****”, datë 12.5.2004, për shitjen e një apartamenti;*
 - *kontratë qiraje nr. “****”, datë 29.3.2006;*
 - *kontratë qiraje nr. “****”, datë 24.10.2009;*
 - *kontratë qiraje nr. “****”, datë 9.4.2010;*
 - *deklaratë noteriale të z. Ç. T.;*
 - *deklaratë noteriale të shtetasit B. M.,*

⁶³ Certifikata e pronësisë në emër të shtetasës Sh. R., ka dalë në datën 3.12.2015.

⁶⁴ Bashkëshorti i saj i ndjerë është i afërm i vëllezërve T.

– i cili deklaron se i ka kthyer pas shtetasit Ç.T., shumën 25.000 euro, të transferuar prej tij për kryerjen e punimeve, për shkak se nuk u kryen punime në banesën e tij.

117. Koha e marrjes së kredisë në bankë përkon me kohën kur z. T., ka regjistruar një aktivitet tregtar, aktivitetin e të cilit nuk e ka vazhduar, sipas edhe informacionit të dërguar nga DRT-ja Shkodër⁶⁵. Pra, kredia prej tij është marrë në funksion të zhvillimit të një aktiviteti tregtar, aktivitet i cili nuk është zhvilluar. Z. T., ka shpjeguar se kalimi i një pjese të kredisë në favor të shoqërisë së ndërtimit është kryer vetëm për të përmbushur detyrimet ndaj bankës.

Vlerësimi i trupit gjykues

a) Lidhur me përdorimin e apartamentit në rrugën “****”

118. Lidhur me apartamentin e përdorur nga subjekti sipas marrëveshjes së datës 10.8.2010 dhe në pronësi të znj. P.M., (sipas vërtetimit hipotekor nr. “****”, datë 30.10.2006), pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar përgjatë hetimit administrativ dhe të prapësimeve të paraqitura nga subjekti, pas njoftimit të rezultateve, si dhe pas vlerësimit të shpjegimeve e pretendimeve të përfaqësueses së subjektit në seancën dëgjimore, së bashku me dokumentet e depozituara, ka rezultuar se ajo e kishte përfituar këtë pasuri me anë të kontratës së shitblerjes nr. “****” rep., nr. “****” kol., datë 11.10.2006, nga z. B.Th., në vlerën 500.000 lekë⁶⁶.

119. Referuar të ardhurave dhe lëvizjeve në llogaritë bankare të znj. P. M., dhe të bashkëshortit të saj, ka rezultuar se përgjatë periudhës në fjalë ajo ka pasur disponibilitet financiar të mjaftueshëm për blerjen e kësaj pasurie. Gjithashtu, edhe në lidhje me mënyrën e pagesës *cash* është verifikuar dhe ka rezultuar se znj. M., ka tërhequr vlera monetare, pikërisht *cash*, në shumën 2.700.000 lekë rreth 2 muaj përpara blerjes së kësaj pasurie. Rrjedhimisht, përdorimi i një pjese të vogël të këtyre mjeteve monetare – më pak se 20% – vlerësohet i besueshëm, për më tepër se asokohe nuk është evidentuar asnjë marrëdhënie e subjektit me këtë pasuri apo edhe me vetë blerësen.

120. Megjithatë, nisur nga fakti që kjo pasuri, më pas, është përdorur nga subjekti për rreth 5 vjet në funksion të marrëveshjes së qiradhënies së dyanshme, trupi gjykues çmoi të analizonte dhe vlerësonte këtë marrëdhënie. Në vijim të hetimeve të kryera dhe të shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, Komisioni ka konstatuar dhe mbajtur në konsideratë sa vijon: (i) marrëveshja për përdorimin e kësaj pasurie është dorëzuar pranë organit kompetent, bashkëngjitur deklaratës *Vetting*; (ii) pronarja e këtij apartamenti, znj. M., ka pasur burime të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie; (iii) pasuria në fjalë është blerë nga znj. M., rreth 4 vjet përpara nënshkrimit të marrëveshjes me subjektin.

Nisur nga sa më sipër, trupi gjykues çmon se lidhur me këtë apartament nuk mund të ngrihen dyshime për pasuri të fshehur të subjektit, për sa kohë ai është blerë nga znj. P. M., me burime të ligjshme, shumë vite përpara se të përdorej nga subjekti dhe kjo marrëdhënie është formalizuar në kohë reale dhe më pas është paraqitur pranë organeve verifikuese.

⁶⁵ Me kërkesën nr. “****” prot., datë 16.9.2022.

⁶⁶ Bashkëlidhur kontratës ka rezultuar edhe një kërkesë për lëshimin e certifikatës së pronësisë së datës 12.10.2006, në emër të znj. P.M., mandatarkëtimi për aplikimin, si dhe një hartë treguese të regjistrimit të pasurisë.

b) Lidhur me përdorimin e apartamentit në rrugën “*****”

121. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar përgjatë hetimit administrativ dhe të prapësimeve të paraqitura nga subjekti, pas njoftimit të rezultateve, si dhe pas vlerësimit të shpjegimeve e pretendimeve të përfaqësueses së subjektit në seancën dëgjimore, së bashku me dokumentet e depozituara, çmon se gjendet i bazuar pretendimi i subjektit, për sa i përket gjetjes së Komisionit mbi mosdeklarimin, në vitin 2011 dhe në deklaratën *Vetting*, e kontratës së porosisë së kësaj pasurie në vitin 2011 dhe të huas së marrë nga z. T., dhe të përdorur prej tij si paradhënie, për sa kohë këto marrëdhënie juridike dhe financiare nuk kanë prodhuar asnjë efekt financiaro-pasuror, pasi ato janë shuar/prishur pas pak javësh (dhe brenda të njëjtit vit – 2011). Kësisoj, duke mbajtur në vëmendje faktet se nga këto marrëdhënie kalimtare (i) nuk është krijuar asnjë ndryshim në sferën pasurore të subjektit dhe (ii) të shuarjes së detyrimit financiar ndaj huadhënësit brenda vitit 2011, Komisioni vlerëson se rrjedhimisht nuk ka lindur ndonjë detyrim për subjektin, që do të duhej të deklaronte për vitin 2011 apo në deklaratën për rivlerësimin kalimtar.
122. Në lidhje me kohëzgjatjen e përdorimit të apartamentit të ndodhur në rrugën “*****” Tiranë – ndryshe nga sa kishte konstatuar Komisioni në rezultatet e hetimit, të njoftuara subjektit – trupi gjykues e gjen bindës dhe të bazuar në prova pretendimin e subjektit se ky apartament nuk mund të ishte përdorur prej tij nga viti 2010 e në vijim (pas marrëveshjes së vitit 2010 me znj. P. M.). Komisioni arrin në këtë konkluzion, së pari, për faktin se rezulton e provuar se pallati ku bën pjesë apartamenti *de quo* nuk ishte ndërtuar ende në atë periudhën dhe, për rrjedhojë, nuk kishte se si të banohej një pasuri që nuk ekzistonte fizikisht.
123. Sa më lart është konstatuar nga imazhet satelitore të vitit 2009 të vendndodhjes aktuale të pallatit në fjalë, ku asokohe evidentohet se aty gjenden disa ndërtesa private, disa pemë dhe një pjesë toke e gjelbëruar. Kjo provon faktin e pretenduar se në atë kohë ende nuk ishte nisur as perimetrimi i zonës së kantierit të ndërtimit apo faza e demolimit të banesave ekzistuese për t’i hapur rrugë më pas gjurmimeve dhe nisjes së ndërtimit të pallatit. Ndërkohë që për kryerjen dhe zhvillimin e të gjitha këtyre fazave të punimeve është nevojitur një kohë e caktuar dhe jo e shkurtër, e cila ka nisur të rrjedhë sigurisht pas momentit të imazhit të lartpërmendur. Gjithashtu, në një tjetër imazh të vitit 2012, ndonëse këtë herë evidentohet ndërtesa e pallatit ku gjendet apartamenti në analizë, konstatohet se me këto të dhëna nuk mund të vlerësohet se ai në atë kohë ka qenë ose jo i banueshëm, pasi punimet e brendshme mund të kenë qenë ende në kryerje e sipër. Pamundësia për ta konsideruar të banueshëm këtë pallat në vitin 2012 ekziston edhe duke e parë këtë rrethanë në kontekstin faktiko-logjik dhe duke mbajtur në vëmendje edhe aspektin konkret të kohës së shkurtër që ndërkohë kishte kaluar nga momenti i imazhit të parë, fakt ky që e bën jobindëse hipotezën e nisjes dhe kryerjes së demolimit, të ndërtimit të pallatit *de quo*, si dhe të kompletimit të punimeve të brendshme e të jashtme në një hark kohor kaq të shkurtër, për ta bërë të banueshëm atë. Në këto kushte, versioni i fakteve të paraqitura nga subjekti lidhur me këtë pikë, duket bindës dhe, për pasojë, bie arsytimi se subjekti mund ta ketë përdorur apartamentin në këtë pallat prej vitit 2010 e në vijim.

124. Së dyti, vlen të përmendet fakti se marrëveshja e vitit 2010, për qiradhënien/përdorimin e ndërsjellë të pasurive/apartamenteve respektive, kishte për objekt një tjetër apartament në pronësi të znj. P. M., të ndodhur në rrugën “****” (siç është vërtetuar nga dokumentacioni i administruar nga ASHK-ja), dhe jo atë në rrugën “****”.
125. Kësisoj, nisur nga sa më sipër dhe nga vlerësimi i ndërthurur midis: (i) inekzistencës fizike të pallatit *de quo* në vitet e para pas transferimit të subjektit në Tiranë dhe paqartësia se kur kanë përfunduar punimet dhe kur ky pallat është bërë i banueshëm (ku minimalisht duket se kanë kaluar 2 vite pas transferimit të subjektit në Tiranë); dhe (ii) disponibilitetit të subjektit, *de jure* dhe *de facto* për përdorimin e një tjetër apartamenti banimi në Tiranë – pikërisht atë në rrugën “****”, sipas marrëveshjes së vitit 2010 të lidhur mes subjektit dhe znj. M., – çmohet se është provuar e kundërta e konkluzionit të Komisionit lidhur me përdorimin nga subjekti të apartamentit në rrugën “****” prej vitit 2010 e në vijim, pa ndërprerje dhe, për rrjedhojë, duket bindës pretendimi e subjektit, si më lart.
126. Ndërkohë, në gamën e vlerësimit të burimeve të përdorura për porosinë e kësaj pasurie, sikurse është përshkruar edhe më sipër, Komisioni ka rikryer analizën financiare të z. T., duke përfshirë të ardhurat nga qiradhënia – pasi është zbritur masa e tatimit të mbajtur në burim nga shoqëritë qiramarrëse apo e paguar prej tij – si dhe të ardhurat nga shitja e një pasurie të paluajtshme, sipas pretendimit dhe dokumentacionit ligjor të paraqitur nga subjekti në prapësimet e tij.
127. Për sa i përket shumës prej 25.000 euro nga kredia bankare e marrë nga z. T., shumë kjo që është transferuar në favor të palëve të treta për punime ndërtimi, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale të përfituesit, i cili ka deklaruar se këtë shumë ia ka kthyer pas, duke qenë se nuk u kryen punimet. Gjithashtu, pretendimi i subjektit se kjo kredi ishte marrë me qëllim zhvillimin e një aktiviteti duket se nuk bind mjaftueshëm, pasi kredia është marrë nga z. T., si individ për ndërtim godine dhe jo nga shoqëria.
128. Gjithsesi, trupi gjykues vlerëson se ndonëse ky pretendim nuk është provuar me dokumente të kohës, duke pasur parasysh se z. T., nuk ka qenë subjekt deklarues, e konsideron këtë rrethanë jo të mjaftueshme për të pasjellë pasoja për subjektin e rivlerësimit për shkak që do të saktësohen në vijim. Përpos këtij vlerësimi, vërehet se nëse nuk do të konsiderohej disponimi i shumës 25.000 euro (pas rikthimit të saj), atëherë huadhënësi do të rezultonte me një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, prej -4.977.603 lekësh. Ndërkohë, nëse do të konsiderohej si i pranueshëm kthimi pas tek huadhënësi i kësaj shume, z. T., do të rezultonte me një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, prej -1.507.353 lekësh.
129. Megjithatë, sikurse u citua edhe më sipër, trupi gjykues vlerëson se këto pamundësi financiare të huadhënësit, përpos masës së tyre, nuk mund të sjellin pasoja për subjektin e rivlerësimit, për sa kohë ato janë përdorur përkohësisht, duke u kthyer pas tek huadhënësi, pas pak javësh – nëpërmjet zëvendësimit të pozicionit të porositësit. Kjo dinamikë faktesh çon në konkluzionin se marrëdhënia e huas në fjalë nuk ka gjeneruar/krijuar asnjë përfitim pasuror apo financiar në sferën e interesave të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë porosia e tij është prishur pak më vonë, pa prodhuar asnjë efekt juridiko-financiar. Në këto kushte vlerësohet se nuk mund të penalizohet një subjekt, thjesht për shkak të paqartësisë apo paprovueshmërisë së pjesshme të shumave

monetare (të të tretëve), të cilat ndonëse provizorisht janë qarkulluar apo përdorur prej subjektit, për sa kohë nga ky veprim nuk është konkretizuar asnjë pasuri apo benefit i këtij të fundit. Komisioni arrin në këtë konkluzion duke u bazuar në parimin e objektivitetit dhe duke mbajtur në vëmendje objektin dhe qëllimin e procesit të rivlerësimit për kriterin e pasurisë – ku në fokus duhet të jenë pasuritë e krijuara dhe/ose të gëzuara/përdorura nga subjektet dhe jo çdolloj lëvizje monetare pa asnjë efekt konkret në sferën juridiko-financiare të subjektit.

130. Gjithashtu, sikurse është përmendur më sipër, vlen të ritheksohet se fakti që marrëdhënia e huas, si dhe kontrata e porosisë e vitit 2011, janë prishur/shuar brenda të njëjtit vit, këto veprime juridiko-financiare nuk kanë qenë objekt i detyrimit për t'u deklaruar, as ndër vite dhe as në deklaratën për rivlerësimin kalimtar *Vetting*.
131. Në vijim të sa është përshkruar dhe arsyetuar më sipër, duke u rikthyer në shqyrtimin dhe arsyetimin e pretendimit të subjektit për pabazueshmërinë e dyshimeve të Komisionit se apartamenti në rrugën “*****”, Tiranë, mund të ishte një pasuri e fshehur e subjektit, Komisioni, duke mbajtur në vëmendje edhe jurisprudencën dhe qëndrimet/orientimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit⁶⁷ lidhur me nevojën për cilësimin e saktë ligjor të situatave faktike, në funksion të të provuarit të shkaqeve të përdorura për shkarkimin e subjekteve apo të marrëdhënies së subjekteve me pasuri të caktuara, vlerëson se në këtë rast, për shkaqet e mëposhtme nuk mund të konsiderohet e provuar fshehja e kësaj pasurie nga ana e subjektit.
132. Së pari, trupi gjykues çmon se në rastin konkret nuk plotësohen dy kushtet faktiko-juridike për ta cilësuar apartamentin në rrugën “*****” si një pasuri të fshehur të subjektit, për sa kohë mungon: (i) konstatimi i elementit të pamundësisë financiare për krijimin/blerjen e pasurisë në fjalë nga ana e pronarit legjitim/*de jure*; dhe (ii) kushti i përdorimit të pasurisë në fjalë nga ana e subjektit pa kundërshpërblim.
133. Lidhur me mungesën e pamundësisë financiare – sikurse është analizuar, shqyrtuar dhe konkluduar edhe në rezultatet e hetimit administrativ, të njoftuara subjektit – Komisioni, pas verifikimeve dhe përllogaritjeve të kryera, ka konkluduar se lidhur me blerjen e apartamentit në rrugën “*****”, Tiranë, në momentet respektive, blerësit – fillimisht shtetasja P.M., (në vitin 2013) dhe më pas shoqëria “*****” sh.p.k. (në vitin 2018), kanë disponuar burime të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie. Megjithatë, Komisioni, nisur nga një dinamikë disi e komplikuar dhe pjesërisht e paqartë lidhur me përfitimin, tjetërsimin, kalimin e të drejtave reale dhe gëzimin e sendit në periudha të ndryshme – përfshi këtu edhe konstatimin se prej vitit 2010 e në vijim ky apartament ishte banuar vetëm nga subjekti i rivlerësimit – me të drejtë ka ngritur dyshime mbi fshehje të mundshme të kësaj pasurie, duke i dhënë atij mundësinë e mbrojtjes. Por, pas prapësimeve dhe dokumenteve të paraqitur nga subjekti, nuk rezultoi i provuar dyshimi se ky apartament ishte banuar nga subjekti nga viti 2010 e në vijim, pa ndërprerje, përkundrazi.
134. Lidhur me kushtin e dytë të munguar, Komisioni vlerëson se në rastin konkret nuk ka të bëjë me një përdorim pa kundërshpërblim, për sa kohë bazuar në dokumentet e kohës –

⁶⁷ Vendimi nr. “*****”, datë 10.9.20220.

të depozituara nga subjekti në organet kompetente përpara se të niste procesi i rivlerësimit – gjendet përballë një marrëdhënieje me objekt dhënien me qira reciprokisht të dy pasurive respektive, me një masë kundërshtëpërblimi ekuivalent, që neutralizonin njëri-tjetrin. Thënë ndryshe, nisur nga përmbajtja e marrëveshjes së vitit 2016, palët (subjekti i rivlerësimit dhe shtetasja P.M.) kanë dakordësuar një shkëmbim me afat 5-vjeçar të të drejtës së përdorimit të pasurive të tyre respektive, duke i përshtatur dhe kënaqur kësajvoj nevojat e tyre dhe zgjedhjet (apo zgjidhjet) reciproke, në raport me vendbanimet e mëpasshme, *de facto* duke kryer një shkëmbim të ndërsjellë dhe të përkohshëm të përdorimit të tyre. Në këto kushte, nuk mund të flitet për një përdorim të sendit nga subjekti pa kundërshtëpërblim. I njëjti arsyetim vlen edhe për sa i përket marrëdhënies së qirasë për të njëjtin apartament, të lidhur nga subjekti i rivlerësimit (pas dorëzimit të deklaratës *Vetting*) me shoqërinë “*****” sh.p.k., të vitit 2018 – kjo e fundit në cilësinë e pronares së re. Në këtë rast gjendet përballë një kontrate të mirëfilltë qiraje dhe përpos dyshimeve që mund të ngrihen mbi marrëdhënien në fjalë, trupi gjykues çmon se përballë një akti noterial që i përmbush të gjitha kriteret ligjore – rregullisht të regjistruar dhe të deklaruar – që ka prodhuar edhe *de facto* efektet e tij, Komisioni nuk mund të mos e konsiderojë ekzistencën e tij dhe efektet juridike që ai ka prodhuar, thjesht duke u bazuar në dyshime rrethanore të paprovuara. Kësajvoj, në të dyja marrëdhëniet e lartpërshkruara vlerësohet se në përfundim ka mjaftueshëm elemente të provuara për të konkluduar se subjekti nuk është gjendur në kushtet e përdoruesit të një pasurie pa kundërshtëpërblim.

135. Në vijim të përshkrimit të fakteve si më lart dhe analizimit të tyre, konkludohet se për sa kohë: (i) është konfirmuar burimi i ligjshëm i krijimit të kësaj pasurie nga pronarët *de jure*, – znj. P.M., (në vitin 2013) dhe më pas nga shoqëria “*****” sh.p.k. (në vitin 2018); dhe (ii) ka rezultuar se për përdorimin e kësaj pasurie nga ana e subjektit ka qenë qartësisht i përshkruar në parashikimet kontraktore një kundërshtëpërblim, në favor të palëve të lartpërmendura, në këtë rast, përpos dyshimeve, duke mbajtur në vëmendje edhe jurisprudencën e sipërcituar, nuk përmbushen kushtet faktiko-ligjore që kjo pasuri të konsiderohet se është krijuar me mjete monetare të subjektit dhe, për rrjedhojë, të jetë fshehur prej tij.
136. Në konkluzion të sa është konstatuar më sipër në rrafshin faktik, vlerësohet e dobishme edhe një analizë e shkurtër, ngushtësisht në aspektin ligjor, për sa u përket dispozitave që parashikojnë dhe rregullojnë konfigurimin e ekzistencës së mundshme të një “fsheheje pasurie”, nga ku vërehet se, që të ekzistojë si i tillë dhe rrjedhimisht që të mjaftojë si shkak për të shkarkuar një subjekt nga detyra, duhet që përpos kushteve objektive të sipëranalizuara, njëkohësisht të provohet edhe mosdeklarimi i pasurisë apo i interesave specifike, të cilët disponohen ose gëzohen prej subjektit apo nga personat e lidhur me të dhe lidhur me të cilat subjekti është “përpjekur të fshehtë” këto pasuri, duke mos i deklaruar ato, në përputhje me dispozitat përkatëse. Kësajvoj, parë edhe nën këtë aspekt, në çështjen në analizë mungon qëllimi për të mos deklaruar apo për të fshehur një pasuri (pra mungon edhe elementi subjektiv), për sa kohë disponimi/përdorimi i pasurisë në fjalë është deklaruar nga subjekti, madje paraprakisht janë hartuar marrëveshja dhe kontrata e qirasë përkatëse, të cituara më sipër, respektivisht me pronarët *de jure*, që e kishin blerë apartamentin me burime të ligjshme.

137. Gjithashtu, nisur nga vlerësimi faktiko-ligjor se nuk ka të bëjë me një pasuri të fshehur, rrjedhimisht, trupi gjykues vlerëson se përpos mospërputhjeve të disa deklaramëve apo përgjigjeve të subjektit apo të përfaqësuesve të tij ligjorë, me fakte apo sqarime të tjera - nuk gjendet as përballë elementeve të mjaftueshme që do të përbënin shkak për cenimin e besimit të publikut nga subjekti i rivlerësimit në sistemin e drejtësisë, pasi mospërputhjet, konfuzioni, paplotësia apo lapsuset e mundshme përgjatë procesit të rivlerësimit, për sa kohë kanë gjetur një qartësim apo kristalizim final, në prag të konkludimit të këtij rivlerësimi, porë në frymën e proporcionalitetit, nuk mund të përbëjnë në vetvete shkak të mjaftueshëm për të aplikuar masën e shkarkimit për një subjekt.

3. Llogari rrjedhëse e pagës në “Credins Bank”, në emër të subjektit të rivlerësimit

138. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* llogarinë rrjedhëse të pagës së tij pranë “Credins Bank” me gjendje në datën 31.12.2016, në vlerën 2.323 lekë. Në mbështetje të deklaramit të tij ai ka paraqitur lëvizjet e llogarisë nga “Credins Bank”, nga e cila ka rezultuar sa më sipër deklaruar nga subjekti.

139. Po ashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit⁶⁸ të administruar nga Komisioni ka rezultuar se llogaria në fjalë është furnizuar nëpërmjet të ardhurave nga paga.

140. Në përfundim, nuk janë konstatuar problematika lidhur me deklaramin apo burimin e ligjshëm për krijimin e gjendjes në llogarinë bankare në analizë.

4. Llogari rrjedhëse e pagës në “Raiffeisen Bank” në emër të bashkëshortes së subjektit

141. Në deklaratën e personit të lidhur, në deklaratën *Vetting*, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar llogarinë e pagës së saj në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 577.743 lekë, si dhe ka paraqitur bashkëngjitur kësaj deklaramë, lëvizjet e llogarisë, nga ku ka rezultuar vlera e sipërdeklaruar.

142. Po ashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit⁶⁹ të administruar nga Komisioni ka rezultuar se llogaria në fjalë është furnizuar nëpërmjet të ardhurave nga paga.

143. Në përfundim, nuk janë konstatuar problematika lidhur me deklaramin apo burimin e ligjshëm për krijimin e gjendjes në llogarinë bankare në analizë.

5. Lidhur me disa automjete që kanë rezultuar në përdorim nga ana e subjektit të rivlerësimit

144. Përgjatë procesit të rivlerësimit, nga DPSHTRR-ja⁷⁰ është bërë me dije se nuk kanë rezultuar mjete të regjistruara në pronësi të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur.

145. Nga të dhënat e nxjerra nga sistemi TIMS, të përcjella nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit⁷¹, si dhe nga verifikimi i kryer nga Komisioni *online*, në sistemin informatik të AMF-së ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur (familja e tij) kanë

⁶⁸ “Credins Bank”, nëpërmjet shkresës nr. “*****” prot., datë 16.12.2020, dërguar Komisionit.

⁶⁹ “Raiffeisen Bank”, nëpërmjet shkresave nr. “*****” prot., datë 8.9.2020 dhe nr. “*****” prot., datë 19.11.2021.

⁷⁰ Me shkresën nr. “*****” prot., datë 28.8.2020.

⁷¹ Me shkresën nr. “*****” prot., datë 31.8.2020.

rezultuar përdorues të këtyre automjeteve: (i) tip “Porsche” me targë “*****”, me të cilin ka kryer një udhëtim në datën 5.9.2011; (ii) tip “Jaguar” me targë “*****”, në pronësi të shtetasit E.Q., e në përdorim nga subjekti, bashkëshortja dhe djali i tij, përgjatë periudhës 2013 – 2015, ku në vitin 2013 ka dalë jashtë kufijve të Shqipërisë 1 herë; (iii) tip “Mercedes-Benz”, prodhim i vitit 2010, me targë “*****”, në pronësi të shtetasit L. A., në përdorim nga subjekti përgjatë periudhës 2014 – 2018. Me këtë automjet subjekti dhe personat e lidhur kanë udhëtuar 1 herë jashtë vendit në vitin 2016.

146. Komisioni ka administruar edhe një denoncim⁷², në të cilin, ndër të tjera, përmendej edhe se subjekti ka përdorur një automjet të tipit “Cadillac”. Gjithashtu, në median *online*⁷³ ka rezultuar i publikuar një artikull, në të cilin citohej se gjyqtari është parë me një mjet të tipit “Porsche” me targa amerikane, si dhe një mjet të tipit “Cadillac”.
147. Bazuar në informacionet e administruara, si më sipër, në raport edhe me përdorimin e mjeteve në pronësi të personave të tretë dhe të përdorura nga subjekti, dhe personat e lidhur (përfshirë edhe ato automjete me të cilat kanë udhëtuar jashtë shtetit dhe që janë drejtuar nga të tjerë shtetas⁷⁴), Komisioni ka kërkuar informacion nga: (i) SPAK-u⁷⁵, i cili ka bërë me dije se nuk disponoheshin të dhëna që shtetasit, për të cilët ishte kërkuar informacion lidhur me rekorde kriminale të mundshme apo të jenë përfshirë në krimin e organizuar⁷⁶; (ii) Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Tiranë, të cilat kanë bërë me dije se nuk kanë rezultuar çështje të gjykuara nga subjekti me palë shtetasit L. A., dhe E.Q., ndërsa për disa nga personat me të cilët ka udhëtuar janë përcjellë vendimet e dhëna nga subjekti. Analiza mbi konfliktin e mundshëm të interesit, për këta shtetas, do të bëhet në kreun “Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni”; (iii) Prokuroria e Përgjithshme në përgjigje të kërkesës së Komisionit ka bërë me dije se shtetasi E. Q., ka paraqitur një kallëzim penal ndaj një shtetasi tjetër, i cili në përfundim të hetimit është proceduar penalisht.
148. Në përgjigje të pyetësorëve 4 dhe 5, subjekti ka deklaruar se me pronarët e mjeteve të përdorura prej tij, ka marrëdhënie shoqërore dhe familjare, pa konflikt interesi, si dhe ka sqaruar se automjeti në pronësi të shtetasit E. Q., tip “Jaguar”, me targë “*****”, është përdorur prej tij jo më shumë se 2-3 herë. Në mbështetje të deklaratimit të tij ka paraqitur deklaratën noteriale nr. “*****”, datë 14.9.2022, të bërë nga shtetasi E. Q., në të cilën ai ka deklaruar se duke qenë se z. Hoxha nuk kishte automjet, i ka dhënë mjetin e tij për ta përdorur 2-3 herë, për shkak të marrëdhënies shoqërore që ata kishin. Në lidhje me automjetin tip “Cadillac” me targë “*****”, në përgjigje të pyetësorëve nr. 3 dhe 4, subjekti ka deklaruar se automjeti në fjalë ka qenë në pronësi të shtetasve G., dhe E. Q. Nga verifikimi i kryer nga Komisioni në sistemin e AMF-së, ka rezultuar se në vitin 2007, kur është kryer udhëtimi nga subjekti, automjeti në fjalë ka qenë në pronësi të z. A. E. Ç.

⁷² Denoncimi me nr. “*****” prot., datë 15.2.2022, nga një shtetas anonim.

⁷³ <https://www.cna.al/2020/10/19/deklaron-pagat-dhe-huane-ku-e-fshehu-makinen-luksoze-gjyqtari-i-21-janarit/#galera>

⁷⁴ Mjetet me targa: “*****”, me pronar znj. G. Q., dhe përdorues z. E. Q.; “*****”, “*****”, me pronar z. A.Ç.; “*****”, me pronar z. E. H.; “*****”, me pronar z. L.A., dhe përdorues E., dhe B. H.; “*****” në pronësi të subjektit, përfituar pas dorëzimit të deklaratës *Vetting*; “*****”, në pronësi të z. B.P; “*****”, në pronësi të z. E. Q., dhe në përdorim nga subjekti dhe bashkëshortja e tij; “*****”, “*****”, në pronësi të z. F. B.; “*****”, në pronësi të z. E.I; “*****”, në pronësi të z. S. M.; “*****”, “*****”, “*****”, “*****”, “*****”, me pronar z. A. Ç.; “*****”, me pronar z. E.H.; “*****”, me pronar z. B. G.; “*****”, në pronësi të z. Dh. Sh.; “*****” me pronar z. E.H.

⁷⁵ Kërkesë për informacion nr. “*****” prot., datë 16.11.2021.

⁷⁶ Me shkresën nr. “*****” prot., datë 26.11.2021.

149. Lidhur me ekzistencën e konfliktit të mundshëm me shtetasin në fjalë, Komisioni ka administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër⁷⁷ vendimet e dhëna nga subjekti dhe të cituara në vijim, në të cilat shtetasi A. Ç. ka qenë palë:
- a. Vendimi nr. “****”, datë 15.5.2001, i dhënë nga subjekti i rivlerësimit dhe ku shtetasi A. Ç., ka rezultuar paditës, në çështjen me objekt “Pavlefshmëri e pjeshme e aktit dhe ripërtëritje e tij”, me të paditur Këshillin e Bashkisë Shkodër. Në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështjeje, subjekti ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë sipas objektit të saj. Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 30.5.2001.
 - b. Vendimi nr. “****”, datë 25.4.2001, i dhënë nga subjekti i rivlerësimit dhe ku shtetasi A. Ç., ka rezultuar paditës, në çështjen me objekt “Pavlefshmëri e pjeshme e kontratave për shkak të formës”, me të paditur Bashkia Shkodër. Në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështjeje, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë sipas objektit të saj. Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 25.4.2001.
150. Nga sa më sipër, ka rezultuar se çështjet e shqyrtuara nga subjekti i përkasin vitit 2001, ndërkohë përdorimi i automjetit ka ndodhur rreth 6 vite më pas. Ndërsa, në lidhje me automjetin tip “Mercedes-Benz”, prodhim i vitit 2010, me targë “****”, në pronësi të shtetasit L. A., subjekti ka deklaruar se përgjatë periudhës 2015 – 2016, nuk ka pasur asnjë kontakt me shtetasin në fjalë, ndonëse më herët ka pasur një frekuentim për pak kohë.
151. Lidhur me përdorimin e automjetit me targë “****”, në pronësi të shtetasit L. A., për të cilin kanë rezultuar polica sigurimi në emër të subjektit përgjatë periudhës 2014 – 2018, Komisioni, referuar qëndrimin të mbajtur nga Kolegji⁷⁸, si dhe nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ka vlerësuar se subjekti kishte detyrimin ta deklaronte këtë marrëdhënie në deklaratën *Vetting*, në zbatim të përcaktimeve të nenit 3, pika 11 dhe neni 30 i ligjit nr. 84/2016, duke i kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e këtij konstatimi.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

152. Subjekti ka deklaruar se automjetin me targë “****”, në pronësi të shtetasit L.A., e kishte përdorur për të udhëtuar vetëm një herë jashtë vendit. Ai ka pranuar se ndonëse ky automjet është përdorur disa herë nga ana e tij, nuk kanë qenë ndonjëherë në përdorimin e tij të mirëfilltë për ta shfrytëzuar në përditshmërinë e tij. Sipas subjektit, përdorimi në një rast sporadik i këtij automjeti, nuk i përkon ndonjë rubrike deklarimi në deklaratën *Vetting* apo DPV-ve periodike. Në vlerësimin të tij, detyrimi për të deklaruar përdorimin lidhet me rastet kur mjetin e ke në përdorim dhe jo kur e ke përdorur ndonjëherë atë. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se, pavarësisht se sipas policave të sigurimit ai ka rezultuar përdorues potencial (person që mund të përdorte automjetin), në fakt ai nuk e ka pasur në përdorim atë në kohën e dorëzimit të deklaratës *Vetting*.

⁷⁷ Me shkresën nr. “****” prot., datë 23.2.2023.

⁷⁸ Vendimi nr. “****”, datë 12.5.2021, A. M.

Vlerësimi i Komisionit

153. Trupi gjykues, pasi analizoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti, pas njoftimit të rezultateve, shpjegimeve të përfaqësueses së tij në seancën dëgjimore, si dhe duke mbajtur në vëmendje edhe jurisprudencën dhe qëndrimet e mbajtur nga Kolegji⁷⁹, çmon se duke marrë në konsideratë faktin se përdorimi i këtij automjeti nga subjekti është i provuar për vetëm një udhëtim, ndonëse nga polica e sigurimit përkatëse i njeh subjektit të rivlerësimit tagrin e përdorimit të këtij automjeti, për një hark kohor rreth 2 vite (për periudhën 2016 – 2018), ky fakt nuk e provon përdorimin real të automjetit, por mundësinë teorike për përdorimin e tij.
154. Në këto kushte, duke qenë se pretendimi i subjektit të rivlerësimit që automjetin në analizë ai e ka përdorur vetëm një herë, mbështetet dhe konfirmohet nga të dhënat e rezultuara nga sistemi TIMS – nga ku rezulton se ky automjet është përdorur vetëm në datën 9.7.2016, dalje nga pika kufitare Hani i Hotit, ora 10:35, nga subjekti dhe personat e lidhur, dhe më pas ata janë kthyer me mjete/mënyra të tjera udhëtimi – Komisioni, edhe pse nuk mund të përjashtohet mundësia e përdorimeve të tjera të mundshme (në mungesë të një provë konkrete në këtë drejtim), nuk e konsideron penalizues për subjektin rastin specifik në kontekstin dhe rrethanën *de qua*. Ky vlerësim bazohet veçse në jurisprudencën e deritanishme, për sa kohë gjendet përballë një përdorimi sporadik/unik edhe në rrethanat e mbi të dhënat konkrete të disponuara, nga të cilat çmohet se nuk plotësohen kriteret faktiko-ligjore, për t'u konsideruar subjekti i rivlerësimit në cilësinë e përdoruesit të automjetit, nga ku mund të lindte edhe detyrimi për deklarimin e kësaj marrëdhënieje.

REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE

155. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike ndër vite të subjektit, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, lidhur me të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara, me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Në këtë analizë, janë paraqitur:
156. Pasuritë e realizuara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, të pasqyruara në vitin përkatës të kryerjes së investimit.
157. Të gjitha të ardhurat e deklaruara ndër vite dhe të ardhurat e dokumentuara për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, bazuar në përgjigjet e institucioneve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit bashkëngjitur deklaratës *Vetting*.
158. Shpenzimet jetike janë përlllogaritur në bazë të frymëve sipas të dhënave zyrtare nga INSTAT-i.
159. Shpenzimet e udhëtimit janë përlllogaritur duke u bazuar në raportin e hyrje-daljeve sipas sistemit TIMS të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, bazuar në vendimin nr. “*****”, datë 22.5.2019, të Kolegjit.

⁷⁹ Vendim nr. “*****”, datë 8.11.2022.

160. Shpenzimet e shkollimit për periudhat 2002 – 2013 (për djalin e subjektit) dhe 2005 – 2016 janë konsideruar sipas deklaramit të subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 5, në të cilin ka deklaruar se fëmijët e tij kanë ndjekur fondacionin “*****” Shkodër, i cili ka bërë me dije se nuk disponon informacion⁸⁰, por sipas subjektit shuma vjetore e paguar ka qenë rreth 100.000 lekë – për sa kohë ndonëse Komisioni i është drejtuar: (i) Ministrisë së Arsimit dhe Drejtorisë për Zhvillimin, Arsimin dhe Sportin⁸¹, e cila ka bërë me dije se janë në pamundësi për të siguruar informacionin e kërkuar, për shkak të mungesës së të dhënave; (ii) fondacionit “*****”⁸², i cili ka bërë me dije se nuk disponon informacionin e ruajtur; si dhe (iii) kolegjit turk “*****” në Shkodër⁸³, për të cilin nuk ka një përgjigje. Më tej, nga Ministria e Arsimit⁸⁴, si dhe nga Zyra Vendore Arsimore Tiranë⁸⁵ është bërë me dije se djali i subjektit E.H., gjatë viteve 2002 – 2010 ka studiuar pranë kolegjit turk “*****” në Shkodër. Në vitet 2010 – 2014 ka studiuar në shkollën jopublike “*****” në Tiranë. Ndërsa, studimet e larta i ka kryer në universitetin “*****” në Tiranë, në degën “Financë bankë”. Në lidhje me vajzën e subjektit Xh. H., institucionet e sipërcituara kanë bërë me dije se gjatë viteve 2005 – 2010 ka studiuar pranë kolegjit turk “*****”, në Shkodër. Në vitet 2010 – 2017 ka studiuar në shkollën jopublike “*****” në Tiranë⁸⁶. Ndërsa, studimet e larta i ka kryer në universitetin “*****” në Tiranë, në degën “Financë bankë”. Universiteti “*****”⁸⁷ ka përcjellë informacionin për tarifat e paguara për secilin prej fëmijëve të subjektit.
161. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se djali i tij ka marrë hua vlerën 53.100 GBP nga shtetasja D.B., sipas aktmarrëveshjes nr. “*****”, datë 15.8.2017, për financimin e studimeve të tij në Mbretërinë e Bashkuar. Referuar aktmarrëveshjes, shuma është tërhequr në NBG në datën 8.8.2017 dhe afati i huas ka qenë 6 muaj, marrëdhënie kjo e deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2017. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se huaja në fjalë nuk është likuiduar ende, si dhe ka paraqitur deklaratën noteriale nr. “*****”, datë 4.3.2022, të lëshuar nga znj. B., ku është cituar se kjo hua do të likuidohet me shitjen e banesës së ndodhur në Shkodër. Subjekti ka bërë me dije se me znj. B., ka pasur marrëdhënie familjare dhe shoqërore të hershme dhe se nuk ka asnjë konflikt interesi me të. Mungesa e konfliktit të interesit me shtetasen në fjalë është konfirmuar edhe nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Shkodër dhe Tiranë në përgjigjen e dërguar për Komisionin⁸⁸.
162. Nga SPAK-u është bërë me dije nuk ka pasur të regjistruar procedim penal, mosfillim ose pushim në ngarkim të znj. B. Nisur nga jurisprudenca e Kolegjit, për sa kohë kjo marrëdhënie huaje ka lindur pas periudhës së rivlerësimit, Komisioni nuk ka vlerësuar hetimin e mëtejshëm mbi burimet e ligjshme financiare të huadhënësës.

⁸⁰ Në shkresën e paraqitur nga subjekti.

⁸¹ Me shkresën nr. “*****” prot., datë 21.7.2022.

⁸² Me shkresën nr. “*****” prot., datë 24.10.2022.

⁸³ Dërguar shkresë nr. “*****” prot., datë 12.10.2022.

⁸⁴ Me shkresën nr. “*****” prot., datë 6.12.2022.

⁸⁵ Me shkresën nr. “*****” prot., datë 30.11.2022.

⁸⁶ Ka kryer shkollën 9-vjeçare dhe gjimnazin.

⁸⁷ Me shkresën nr. “*****” prot., datë 30.1.2023. Në vijim, me shkresën nr. “*****” prot., datë 9.2.2023, ka përcjellë një informacion shtesë për tarifat për periudhën 2017 – 2020.

⁸⁸ Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. “*****” prot., datë 17.8.2022 dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me shkresën nr. “*****” prot., datë 10.6.2022.

163. Në lidhje me shpenzimet e kryera për mobilimin e banesës, subjekti ka deklaruar se nuk ka kushtuar më shumë se 300.000 lekë dhe se mobilimi ka filluar në vitin 2007 e është kryer gradualisht ndër vite. Nga Komisioni janë konsideruar në masën 150.000 lekë/vit për vitet 2008 dhe 2009.
164. Gjendja e likuiditeteve nënkupton gjendjen në fund të çdo viti të ndodhur në të gjitha llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.
165. Kursi i këmbimit i përdorur për të gjitha investimet/shpenzimet/gjendjet bankare në valutë është konsideruar sipas kursit mesatar të fundit të vitit, botuar në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë⁸⁹.
166. Në këtë analizë janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2003, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga ana e subjektit të rivlerësimit, pranë ILDKPKI-së, nga ku ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm negativ në vlerën -6.293.084 lekë, për të cilën i ka kaluar subjektit barra e provës.

Qëndrimi i subjekti të rivlerësimit

167. Përpos pretendimeve të sipërtrajtuara në pasuritë specifike, subjekti ka kërkuar të rillogariten shpenzimet e udhëtimit, bazuar në vendimin nr. “****”, datë 22.5.2019, të Kolegjit, duke marrë në vlerësim të dhënat që pasqyrohen në deklaratat noteriale të paraqitura prej tij në cilësinë e provës, lidhur me mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit, nga miq dhe të afërm të tij dhe familjes, në raport me disa nga udhëtimet e kryera prej tyre jashtë vendit, sipas përlllogaritjeve dhe pretendimeve të subjektit, pasi të kryheshin të gjitha korrektimet përkatëse, balanca negative për periudhën 2013 – 2016 do të rezultonte në shumën 682.970 lekë, e cila, bazuar në parimet e proporcionalitetit, nuk mund të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore dhe nuk mund të konsiderohet si pamundësi financiare.
168. Gjithashtu, sipas subjektit, ndryshimi i theksuar i balancës së paraqitur nga subjekti, siç është përshkruar më sipër, rrjedh dhe është thelbësisht rezultat i tri shkaqeve domethënëse: *së pari*, nga Komisioni nuk janë paraqitur, përlllogaritur dhe dokumentuar të plota të gjitha të ardhurat e tij, përpara vitit 2003 – kryesisht për periudhën 1992 – 1997, për sa kohë as nuk janë marrë fare në konsideratë nga Komisioni fitimet e gjeneruara nga puna e subjektit si OPGJ; *së dyti*, Komisioni i ka përlllogaritur kostot e ndërtimit përgjatë viteve 2003 dhe 2004 në mënyrë mekanike, pa mbajtur në vëmendje deklaratimet e kryera nga subjekti në ato vite dhe kryesisht për vitin 2004, pikërisht në raport me deklarin e bërë për shpenzimet e ndërtimit; së treti, për shkak të faktit se shpenzimet e udhëtimit janë hipotetike dhe nuk është mbajtur në vëmendje se në shumë raste, vëllai i subjektit apo miq të tij kanë mbuluar të gjitha kostot e udhëtimit, në ndonjë rast duke përfshirë edhe shpenzimet e udhëtimit (biletat e avionit), për sa kohë gjenden në gjendje shumë të mirë ekonomike dhe të shtyrë nga dëshira për të mundësuar vizitat pranë tyre, pa shkaktuar rëndesë financiare për familjen e subjektit – siç ndodh shpesh në marrëdhënie të shëndosha familjare e shoqërore, kur pritësve nuk u mungojnë mjetet financiare.

⁸⁹ www.bankofalbania.org

Vlerësimi i Komisionit

169. Trupi gjykues ka analizuar dhe shqyrtuar prapësimet e subjektit dhe dokumentacionin provues të paraqitur prej tij, pas njoftimit të rezultateve të hetimit, si dhe shpjegimet e përfaqësueses së tij në seancë dëgjimore, duke mbajtur në vëmendje dhe në harmoni me qëndrimin e mbartur nga Kolegji⁹⁰, në raste të ngjashme ku, ndër të tjera, ka arsyetuar se: “[... “27.12.1 Dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të justifikimit të shpenzimeve të kryera për një pjesë të udhëtimeve jashtë Republikës së Shqipërisë në formën e deklaratës noteriale, u trajtua nga trupi gjykues në kuadër të dokumentit shkresor, në kuptim të nenit 49, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, si shkresë e thjeshtë dhe jo si provë me dëshmitarë, në kuptim të pikës 1, shkronja “b” e të njëjtit nen. Vlera provuese e këtyre deklaratave u vlerësua nga trupi gjykues rast pas rasti, në drejtim të pajtueshmërisë së përmbajtjes së deklaratimeve të dhëna në to me provat e tjera dhe çdo të dhënë apo informacion të administruar në fashikull gjatë hetimit administrativ në Komision”].
170. Në këtë kontekst, dhe për sa kohë pritësit – të afërm, familjarë dhe miq të subjektit – kanë konfirmuar mbulimin e shpenzimeve përkatëse, duke provuar gjithashtu rezidencën/shtetësinë e tyre, në vendet përkatëse/pritëse, trupi gjykues çmon që t’i konsiderojë mjaftueshëm të provuara se shpenzimet janë kryer prej pritësve dhe jo nga subjekti e, për rrjedhojë, ka rishikuar analizën financiare, duke përfshirë në të shpenzimet e kryera për udhëtime, sipas standardit të vendosur nga jurisprudenca e deritanishme, në përputhje me pretendimet e subjektit, për sa kohë ato kanë rezultuar të mbështetura në prova. Konkretisht, janë përjashtuar nga kjo përllogaritje shpenzimet e kryera nga subjekti në lidhje me udhëtimet e kryera prej tij dhe personat të lidhur me destinacion Hungarinë, Austrinë dhe Slloveninë, për të cilat trupi gjykues e vlerësoi jo të mjaftueshëm dokumentacionin e paraqitur nga subjekti. Me këtë mënyrë ripërllogaritjeje, duke konsideruar edhe vlerësimet dhe konkludimet në raport me pasuritë e lartpërmendura dhe specifikisht me ndërtime të banesës së subjektit, Komisioni ka konstatuar se subjekti, për periudhën 2003 – 2016, rezulton me balancë negative prej - 2.052.543 lekësh, siç është detajuar në tabelën e mëposhtme.

Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016

⁹⁰ Vendimi nr. “*****”, datë 22.5.2019.

Viti	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	391,655	499,665	436,142	320,333	304,372	295,141	173,852	205,123	276,904	256,525	267,869	44,919	-32,747	565,771
Shitëpi banimi 3 katëshe në Shkodër - Ndërtimi	1,975,063	500,000	329,521	347,977	339,229	239,944	240,373	251,627	259,230	259,230	265,355			
Shitëpi banimi 1 katëshe në Shkodër - Blerja	900,000													
Ndryshim likuiditeti	-2,483,408	-335	106,621	-27,644	-34,857	55,197	-66,521	-46,504	17,674	-2,705	2,514	44,919	-32,747	565,771
TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR	7,331	6,997	113,618	85,974	51,117	106,314	39,793	-6,711	10,963	8,258	10,772	55,691	22,944	588,714
DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
PASURI NETO	391,655	499,665	436,142	320,333	304,372	295,141	173,852	205,123	276,904	256,525	267,869	44,919	-32,747	565,771
Të ARDHURA dokumentuar	819,718	1,037,688	1,101,049	1,146,151	1,259,630	1,319,971	1,574,453	1,535,277	1,164,274	1,077,190	1,682,982	1,923,194	1,903,475	1,900,852
Te ardhura SR vertetuar	609,356	798,501	833,303	830,328	881,291	854,161	1,063,767	1,015,062	1,001,066	990,318	955,155	1,181,730	1,161,575	1,158,144
Te ardhura BSH vertetuar	210,362	239,187	267,746	315,823	378,339	465,810	510,686	520,215	163,208	86,872	727,827	741,464	741,900	742,708
SHPENZIME	475,456	592,057	692,146	702,898	873,790	1,417,234	1,482,399	1,249,532	1,133,599	972,053	1,556,453	2,087,356	2,006,696	1,966,247
Shpenzime jetese	375,456	375,456	438,228	438,228	492,354	546,480	546,480	546,480	546,480	564,096	564,096	879,992	897,104	940,368
Shpenzim për blerjen e parcelës ndërtimore													93,448	
Shpenzim për legalizimin e banesës											34,062			
Shpenzime arsimimi	100,000	100,000	200,000	200,000	200,000	200,000	200,000	200,000	200,000	200,000	200,000	275,138	272,063	269,088
Shpenzime mobilimi/arredimi						150,000	150,000							
Shpenzime udhëtimi		116,601	53,918	64,670	181,436	520,754	585,919	503,052	387,119	207,957	758,295	932,227	744,081	756,791
Analiza dokumentuar	-47,393	-54,034	-27,238	122,920	81,468	-392,403	-81,798	80,622	-246,228	-151,388	-141,339	-209,081	-70,473	-631,165
DIFERENCA E PA MBULUAR			-2,052,543											

171. Ndërkohë, në rrugë alternative, trupi gjykues vlerëson të përllogarisë si të zbritshme edhe shpenzimet e udhëtimeve të përjashtuara (si më lart), për sa i përket qëndrimit jashtë vendit dhe kostove të udhëtimit, sikurse është pretenduar nga subjekti – përpos konsiderimit jo plotësisht bindës të dinamikës dhe narrativës lidhur me këto pretendime. Kjo vlerësohet qartësuese për sa kohë moskonsiderimi (si më lart) mbetet gjithsesi një vlerësim mohues/hipotetik për faktin se në një farë mënyre mospranimi kapërcen prezencën e provave/deklaratave përkatëse. Rrjedhimisht, shtimi i vlerës negative të bilancit të përgjithshëm, për këtë shkak/zë, nuk do të mund të passillte një efekt penalizues.
172. Vlerësimi i mësipërm alternativ bazohet mbi këto arsytetime: (i) parë si në aspektin e nivelit të vlerave përkatëse dhe momenteve, të cilave ato i referohen (shpenzime në mënyrë të shpërndarë në kohë); por kryesisht edhe (ii) duke iu referuar përmbajtjes së deklaratave noteriale të personave pritës nuk vlerësohen se mbartin elemente të mjaftueshme për penalizimin e subjektit. Për më tepër që, devijimi nga standardi i zakonshëm vlerësues kërkon një motivim dhe argumentim specifik – (thënë ndryshe: moskonsiderimi i deklaratave noteriale të paraqitura nga dikush, ndërkohë që deklarata të tjera me përmbajtje të ngjashme pranohen) – si dhe duhet të mbështetet mbi arsye dhe elemente konkrete, të mjaftueshme për të provuar të kundërtën e pretendimit të subjektit apo të deklaramit të personit të tretë (elemente që në këtë rast mungojnë). Në këto kushte, qoftë edhe në rrugë alternative, Komisioni, pasi i ka përllogaritur si të pranueshme efektet financiare të pretendimeve të shoqëruara me deklaratat e pritësve dhe dokumentet përkatëse, kësisoj, duke e vlerësuar edhe në këtë variant/mënyrë analizën e përgjithshme financiare, nga ku është konstatuar se për periudhën 2003 – 2016, subjekti rezulton me

një balancë negative prej -1.252.435 lekësh.

Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016

Viti	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	391,655	499,665	436,142	320,333	304,372	295,141	173,852	205,123	276,904	256,525	267,869	44,919	-32,747	565,771
Shtëpi banimi 3 katëshe në Shkodër - Ndërtimi	1,975,063	500,000	329,521	347,977	339,229	239,944	240,373	251,627	259,230	259,230	265,355			
Shtëpi banimi 1 katëshe në Shkodër - Blerja	900,000													
Ndryshim likuiditeti	-2,483,408	-335	106,621	-27,644	-34,857	55,197	-66,521	-46,504	17,674	-2,705	2,514	44,919	-32,747	565,771
TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR	7,331	6,997	113,618	85,974	51,117	106,314	39,793	-6,711	10,963	8,258	10,772	55,691	22,944	588,714
DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
PASURI NETO	391,655	499,665	436,142	320,333	304,372	295,141	173,852	205,123	276,904	256,525	267,869	44,919	-32,747	565,771
Të ARDHURA dokumentuar	819,718	1,037,688	1,101,049	1,146,151	1,259,630	1,319,971	1,574,453	1,535,277	1,164,274	1,077,190	1,682,982	1,923,194	1,903,475	1,900,852
Te ardhura SR vertetuar	609,356	798,501	833,303	830,328	881,291	854,161	1,063,767	1,015,062	1,001,066	990,318	955,155	1,181,730	1,161,575	1,158,144
Te ardhura BSH vertetuar	210,362	239,187	267,746	315,823	378,339	465,810	510,686	520,215	163,208	86,872	727,827	741,464	741,900	742,708
SHPENZIME	475,456	592,057	692,146	669,498	873,790	1,383,975	1,443,991	1,214,829	917,851	844,908	1,518,596	1,913,620	1,910,341	1,862,765
Shpenzime jetese	375,456	375,456	438,228	438,228	492,354	546,480	546,480	546,480	546,480	564,096	564,096	879,992	897,104	940,368
Shpenzim për blerjen e parcelës ndërtimore													93,448	
Shpenzim për legalizimin e banesës											34,062			
Shpenzime arsimimi	100,000	100,000	200,000	200,000	200,000	200,000	200,000	200,000	200,000	200,000	200,000	275,138	272,063	269,088
Shpenzime mobilimi/arredimi						150,000	150,000							
Shpenzime udhëtimi		116,601	53,918	31,270	181,436	487,495	547,511	468,349	171,371	80,812	720,438	758,491	647,726	653,310
Analiza dokumentuar	-47,393	-54,034	-27,238	156,320	81,468	-359,144	-43,390	115,324	-30,480	-24,243	-103,483	-35,345	25,882	-527,684
DIFERENCA E PA MBULUAR			-1,252,435											

173. Në përfundim, duke mbajtur në konsideratë: (i) nivelin e pamundësisë financiare të konstatuar dhe arsyetuar më sipër; (ii) faktin që nga kjo masë pamundësie përkon vetëm pjesërisht me pamjaftueshmërinë e mjeteve financiare të përdorura për krijim të së vetmes pasuri të paluajtshme të disponuar nga subjekti i rivlerësimit; (iii) ndërkohë që mangësitë e tjera financiare rezultojnë të shpërndara ndër vite dhe në vlera të vogla (të cilat gjithsesi nuk janë përdorur për krijimin e ndonjë tjetër pasurie nga subjekti); (iv) faktin që Komisioni nuk i ka përllogaritur në analizë financiare të ardhurat e realizuara nga subjekti përgjatë viteve 1992 – 1997 (të cilat minimalisht do të pakësonin nivelin e pamundësisë të konstatuar – sikurse është cituar dhe përshkruar më sipër, në analizën e bërë lidhur me këtë pretendim të subjektit) – trupi gjykues, nën dritën e primeve të objektivitetit dhe të proporcionalitetit, si dhe të jurisprudencës së Kolegjit të posaçëm të Apelit⁹¹ – çmon se pamundësia e burimeve financiare e konstatuar në këtë rast, nuk është e mjaftueshme që të justifikojë aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe, rrjedhimisht, dhënien e masës së shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit në lidhje me kriterin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

⁹¹ Vendimet: nr. “*****”, nr. “*****”, nr. “*****”, nr. “*****”, nr. “*****”, nr. “*****”, nr. “*****”, nr. “*****” dhe (JR) nr. “*****”).

174. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë pranë Komisionit raporti me nr. “*****” prot., datë 2.11.2017, i Grupit të Punës, i përpiluar pa përgjigjen e njërit prej autoriteteve verifikuese, me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit për vazhdimin e detyrës.
175. Më pas, me shkresat e datave 23.1.2018 dhe 1.2.2022, DSIK-ja ka përcjellë të tjera informacione të organeve ligjzbatuese, nëpërmjet të cilave ngriheshin dyshime për përfshirje të subjektit të rivlerësimit në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës dhe ndërveprimit korruptiv, duke lehtësuar/favorizuar pozitën e të pandehurve.
176. Në vijim të këtyre komunikimeve, Komisioni i ka kërkuar DSIK-së rishikimin e mundshëm të raportit fillestar të përcjellë për këtë subjekt rivlerësimi. Në përgjigje të kësaj kërkesë, DSIK-ja, me shkresën nr. “*****” prot., datë 7.3.2022, nëpërmjet së cilës është përcjellë raporti me nr. “*****” prot. dhe, gjithashtu, është bërë me dije se ky raport është deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. “*****”, datë 3.3.2022, të KDZH-së.
177. Gjithashtu, ka rezultuar se në konkludim të raportit me nr. “*****” prot., Grupi i Punës, nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës.
178. Nga analiza e informacioneve të përcjella nga organet ligjzbatuese, veç të tjerash, është referuar sa vijon:
- a. *Subjekti i rivlerësimit, z. Besnik N., Hoxha, ka pasur mbiemrin Hoxhaj dhe e ka ndryshuar në Hoxha. Për subjektin e rivlerësimit administrohen informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, kryesisht atë të korrupsionit aktiv ose pasiv për shkak të funksionit.*
 - b. *Pas verifikimeve të kryera nga autoritetet verifikuese është bërë me dije se disponohen të dhëna ku për subjektin e rivlerësimit, z. Besnik Hoxha, gjatë procesit të hetimit/gjyqimit të disa çështjeve gjyqësore ka favorizuar palët në gjykim kundrejt përfitimeve financiare.*
 - c. *Informacionet në fjalë citojnë se z. Besnik Hoxha [...] ka pasur kontakte të papërshtatshme/jorastësore.*
179. Në vijim dhe vlerësim të të dhënave që disponoheshin lidhur me këtë subjekt rivlerësimi, nisur nga informacionet e përcjella nga organet ligjzbatuese dhe pasi janë aksesuar informacionet e klasifikuara pranë organit kompetent, në përputhje me nenin 41, paragrafi 4 i ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një hetim administrativ gjithëpërfshirës, duke kërkuar informacione dhe dokumentacione shtesë. Gjithashtu, janë administruar dhe analizuar disa akte, vendime e dosje, që lidheshin me çështjet gjyqësore, me qëllim verifikimin e të dhënave të raportuara të bëra me dije edhe nëpërmjet aksesimit të dokumenteve e informacioneve të klasifikuara, që lidheshin me kriterin e figurës.
180. Nisur nga sa më sipër, nëpërmjet shkresës nr. “*****” prot., datë 27.5.2022, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Kjo e fundit, me shkresën nr. “*****”

prot., datë 10.6.2022, ka përcjellë dokumentacionin, nga i cili, pasi është analizuar, ka rezultuar sa vijon:

1. Në lidhje me çështjen me palë shtetasin M.L., me objekt “Njohje e një sipërfaqeje të caktuar toke”, në Velipojë (Rana e Hedhun), çështjen me palë shtetasin L.H., i mbrojtur nga av. I.K., si dhe në lidhje me çështjen me kërkues shtetasin U./Gj. P., me objekt “Njohje e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme (tokë)”

181. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër është bërë me dije se këto çështje nuk kanë rezultuar të shqyrtuara nga subjekti i rivlerësimit. Rrjedhimisht, Komisioni nuk mund të kryente hetime dhe vlerësime të mëtejshme lidhur me informacionin e klasifikuar, për sa kohë nga dokumentacioni i administruar nuk rezultoi ndonjë përfshirje apo lidhje e subjektit me faktet e përshkruara, të cilat i atribuoheshin pikërisht subjektit, duke u ngritur dyshime për favorizim të palëve nga ana e tij, nëpërmjet një shqyrtimi gjyqësor dhe vendimmarrjeje, që rezultoi të mos jetë kryer/dhënë nga z. Hoxha.

2. Në lidhje me çështjen nr. “***”, datë 28.12.2004, me palë shtetasin P. L., me objekt “Vërtetim fakti lidhur me pronësinë tokë arë dhe kullotë”, për të cilën është dhënë vendimi nr. “*****”, datë 28.12.2004⁹²**

182. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar ka rezultuar se shtetasi G.P.L., ka kërkuar vërtetimin e faktit juridik të vendndodhjes dhe kufitarëve të tokës, pasi, sipas tij, sipërfaqja *de facto* ishte më e madhe sesa ajo e paraqitur në vërtetimin lëshuar nga Këshilli i Qarkut Shkodër. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje, me vendimin nr. “*****”, datë 28.12.2004, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë në fjalë. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 13.1.2005.

183. Nisur edhe nga fakti që në lidhje me këtë çështje në analizë janë paraqitur pranë Komisionit edhe 2 denoncime nga publiku⁹³, subjekti është ftuar që të japë shpjegime lidhur me veprimet dhe qëndrimet e tij, në raport me çështjen dhe vendimmarrjen në fjalë.

184. Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka sqaruar se: *“Çështja në fjalë ka qenë e natyrës deklarative dhe certifikuese, pa palë kundërshtarë dhe nuk bëhej fjalë për një vendim të ekzekutueshëm/të detyrueshëm për të tretët. Vërtetimi gjyqësor i faktit nuk synon të zgjidhë një konflikt apo mosmarrëveshje, të njohë apo jo një të drejtë, por thjesht synon të formësojë apo të ribëjë gjyqësisht provën, shkresën, dokumentin apo aktin e munguar që pasqyron faktin juridik, i cili passjell lindjen, ndryshimin apo shuarjen e një të drejte pasurore apo personale jopasurore të kërkuesit. Gjykata thjesht deklaroi se ajo e konsideron një fakt të dhënë juridik si të vërtetuar, duke lehtësuar në këtë mënyrë realizimin eventual të të drejtave të ligjshme të kërkuesit. Të drejtat dhe detyrimet që lindin nga ai fakt juridik i vërtetuar nuk çmohen e vendosen nga gjykata në atë gjykim. Ato zgjidhen nëpërmjet rrugëve të tjera, përfshirë atë të ngritjes së padive në gjykatë me palë kundërshtarë⁹⁴”.*

185. Nisur nga fakti se kriteri i figurës analizohet dhe vlerësohet në një këndvështrim të ndryshëm nga ai profesional, pretendimet e parashtruara në denoncime lidhur me shkelje

⁹² Përgjatë procesit të hetimit, lidhur me vendimin në analizë, Komisioni ka administruar denoncimin nr. “*****”, datë 20.12.2018, nga shtetasi P.T. M., i cili do të trajtohet edhe në rubrikën “Denoncime nga publiku”.

⁹³ Denoncimi nr. “*****”, në rubrikën “Denoncime nga publiku”.

⁹⁴ Shihni vendimin nr. “*****”, datë 18.12.2009, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

të mundshme, si dhe me aspektin profesional të subjektit në çështjen gjyqësore të analizuar më sipër, do të trajtohen në rubrikën “Denoncime nga publiku”.

3. Në lidhje me çështjen e përfunduar me vendimin nr. “**”, datë 7.1.1999⁹⁵**

186. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar⁹⁶ ka rezultuar se objekt gjykimi në këtë çështje ka qenë anulimi i pjesëshëm i vendimit nr. “****”, datë 6.10.1993, të KKP-së, Shkodër. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. “****”, datë 7.1.1999⁹⁷, bazuar në nenet 306-309 të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, anulimin e pjesëshëm të vendimit nr. “****”, datë 6.10.1993, të KKP-së Shkodër dhe njohjen e pronës në pronësi të tyre për efekt të nenit 21 të ligjit nr. 7698⁹⁸, datë 15.4.1993, “Për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve”. Vendimi në fjalë ka marrë formë të prerë në datën 21.1.1999. Ndonëse është paraqitur rekurs, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. “****”, datë 20.12.2000, nuk e ka pranuar atë, duke e cilësuar si të pabazuar në ligj.
187. Nga analiza e vendimit të sipërcituar, Komisioni ka konstatuar se përgjatë procesit nuk ka pasur pretendime apo kundërshtime nga kufitarët e pronës, përkundrazi ata kanë konfirmuar të drejtën e pronësisë së pretenduar nga pala paditëse.
188. Nisur nga sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se, lidhur me dinamikën procedurale dhe veprimtarinë profesionale të subjektit në këtë çështje, nuk janë konstatuar problematika/shkelje procedurale apo arsyetim i dobët që mund të konfirmojë dyshimet mbi favorizim të palëve në këtë proces.

4. Lidhur me çështjen penale me të pandehur shtetasin V.C.

189. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar, lidhur me këtë çështje, ka rezultuar se organi i akuzës i kishte kërkuar gjykatës: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit V. C., për veprën penale “vrasje me paramendim të kryer në bashkëpunim” dhe dënimin e tij me 20 vjet burg. Deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale “armëmbajtje pa leje” dhe dënimin e tij me 4 vjet burg. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal që bën fjalë për bashkimin e dënimeve, dënimin e të pandehurit V. C., me 20 vjet burg”*.
190. Çështja gjyqësore është regjistruar në datën 13.9.2004, me trup gjykues me kryesues A. Y., anëtar A. Z., dhe B. Hoxha. Pas shqyrtimit të akteve procedurale, marrjes së dëshmive nga personat që kanë dijeni për veprën penale, kryerja e akteve të ekspertimit mjekoligjor dhe balistik, bazuar në nenin 375 të Kodit Penal, ka vendosur ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale “vrasje me paramendim” e parashikuar nga neni 78/2 i Kodit Penal në veprën penale “vrasje në kapërcim të mbrojtjes së nevojshme” të parashikuar nga neni 83 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet burg; deklarimin e pafajshëm të tij për veprën penale “armëmbajtje pa leje”, të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.

⁹⁵Duke qenë se vlerësimi i aftësive profesionale sipas nenit 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale, Komisioni ka vlerësuar të marrë në analizë vendimin e sipërcituar edhe pse është jashtë periudhës së vlerësimit profesional, duke mbajtur në konsideratë informacionet e administruara nga organet ligjzbatuese në kuadër të vlerësimit të kriterit të figurës.

⁹⁶ Vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit, vendimet e dhëna nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë.

⁹⁷ Përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me shkresën nr. “****” prot., datë 10.6.2022.

⁹⁸ Sipas të cilit: *“Në trojet e zëna me ndërtime shtetërore, si dyqane, magazina, punishte etj., ish-pronarët kanë të drejtën e parablerjes së këtyre objekteve, kur privatizohen me çmimet e përcaktuara sipas dispozitave në fuqi”*.

191. Vendimi i mësipërm është ankimuar nga Prokuroria e Apelit Shkodër dhe ka rezultuar i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. “*****”, datë 11.7.2005. Më pas, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. “*****”, datë 22.9.2006, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga Prokuroria.
192. Komisioni, pasi analizoi fashikullin gjyqësor, si dhe vendimin e gjykatës, arriti në përfundimin se:
- a. Gjykata është shprehur në mënyrë kontradiktore në argumentimin e saj, pasi fillimisht deklaroi se i pandehuri ka përdorur armën e brezit (duke mos marrë në konsideratë aktin e ekspertimit, sipas të cilit gëzhojat e gjetura në vendngjarje nuk i përkisnin armës së brezit të të pandehurit) dhe më pas deklaroi se nga provat e marra nuk provohet se i pandehuri të ketë pasur armë.
 - b. Nga dinamika e ngjarjes, duket se nuk gjendet në kushtet e kapërcimit të mbrojtjes së nevojshme. Në pjesën arsyetuese të vendimit mungon argumentimi i konkluzionit që veprimet e të pandehurit plotësojnë elementet e veprës penale “kapërcim të mbrojtjes së nevojshme”, si dhe analizimi i këtyre elementeve qoftë edhe në formë të shkurtuar.
 - c. Gjykata nuk analizoi faktin se nga ana e të pandehurit, pa qenë në kushtet e një sulmi të drejtpërdrejt të çastit, është përdorur armë zjarri duke qëlluar mbi viktimën.
 - d. Gjithashtu, mungon argumentimi i konkluzionit që veprimet e të pandehurit nuk plotësojnë elementet e veprës penale “armëmbajtje pa leje”, si dhe analizimi i këtyre elementeve qoftë edhe në formë të shkurtuar.
193. Për sa më sipër, Komisioni vendosi t’i kalojë subjektit barrën e provës për sa vijon:
- Vendimi nr. “*****”, datë 24.1.2005, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër – ku pjesë e trupit gjykues ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit – rezulton me mungesë argumentimi apo me arsyetim të dobët dhe të paplotë lidhur me disa elemente esenciale, mbi të cilat është bazuar ndryshimi i cilësimit të veprës penale, duke çuar në një dënim tejet më të lehtë, në krahasim me dënimin e kërkuar nga prokuroria.
 - Për rrjedhojë, bazuar në sa më lart dhe në ndërthurje edhe me informacionet e klasifikuara të njohura nga Komisioni, ngrihen dyshime për favorizimin e të pandehurit V.C., nëpërmjet ndryshimit të cilësimit të veprës penale nga njëra anë (nga “vrasje me paramendim” në veprën penale “kapërcim të mbrojtjes së nevojshme”) dhe, nga ana tjetër, duke konsideruar se mungonin elementet e veprës penale “armëmbajtje pa leje”.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

194. Subjekti është shprehur, ndër të tjera, se nga analiza e të dhënave të këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe provave të tjera të administruara në gjykim, trupi gjykues i gjykatës kishte konkluduar se gëzhojat e gjetura në vendngjarje duhet t’i përkisnin armës së viktimit. Në vendngjarje kishte gjuajtur dhe viktimën, kështu që nga provat e administruara nuk u vërtetua se i pandehuri kishte edhe një armë tjetër, të ndryshme nga ajo që dispononte me leje. Për rrjedhojë, rezultoi se mungonin elementet e veprës penale “armëmbajtje pa leje”. Sipas subjektit, nga dinamika e ngjarjes, ishin provuar plotësisht kushtet e

kapërcimit të mbrojtjes së nevojshme, pasi viktima kishte gjuajtur pesë herë dhe i pandehuri ndihej ende nën kërcënimin e një sulmi të drejtpërdrejt dhe të rrezikshëm.

195. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se në pjesën arsyetuese të vendimit ishin analizuar elementet e “kapërcimit të mbrojtjes së nevojshme”.

Vlerësimi i Komisionit

196. Pas analizimit të prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe referencave ligjore mbi të cilat ai ka mbështetur argumentet e tij, Komisioni çmon se trupi gjykues, ku ka qenë anëtar edhe subjekti i rivlerësimit, ka vlerësuar provat bazuar në nenin 152 të Kodit të Procedurës Penale, duke dhënë një vendim të bazuar në prova e në bindjen e brendshme, tagër ky që i takon vetëm gjykatave dhe shkon përtej veprimtarisë së organeve të rivlerësimit⁹⁹.
197. Për më tepër, në rastin konkret, rrethanat faktiko-ligjore të çështjes objekt vlerësimi nuk lënë hapësirë për të evidentuar shkelje apo favorizime të mundshme. Kjo përforcohet edhe nga fakti që vendimi në analizë është lënë në fuqi nga të dyja shkallët më të larta të gjyqësorit.
198. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se: (i) për sa kohë është provuar se vendimi në fjalë është lënë në fuqi nga shkallët më të larta të gjyqësorit, të cilat nuk kanë konstatuar mangësi profesionale/shkelje që lidhen me çështjen në fjalë; (ii) analiza e kryer më sipër në raport me dinamikën vlerësuese të kësaj çështjeje penale nuk ka çuar në konkludimin mbi prezencën e ndonjë shkeljeje, favorizimi apo përgjegjësie eventuale të subjektit. Për rrjedhojë, rasti në fjalë nuk mund të përbëjë shkak penalizues apo konfirmues të dyshimeve të ngritura lidhur me veprimtarinë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

5. Çështja penale me të pandehur shtetasin L.K.

199. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. “*****”, datë 9.2.2007, ka caktuar masën e sigurimit “arrest në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, ndaj shtetasit L.K., i cili ishte arrestuar në flagrancë, në cilësinë e të dyshuarit për kryerjen e veprës penale “mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.
200. Me vendimin nr. “*****”, datë 7.5.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër (nga një tjetër gjyqtar) është vendosur deklarimi fajtor i të pandehurit dhe dënimi i tij me 7 muaj burgim. Për shkak të gjykimit të shkurtuar i pandehuri është dënuar me 4 muaj e 20 ditë burgim.
201. Në vijim, i pandehuri L. K., ka paraqitur në gjykatë kërkesën e datës 9.5.2007, me objekt “Shuarja e masës së sigurimit “arrest burg”. Kërkesa në fjalë është marrë në shqyrtim nga subjekti i rivlerësimit, i cili me vendimin nr. “*****”, datë 10.5.2007, bazuar në pikën 1, shkronja “c” e nenit 261 të Kodit të Procedurës Penale, sipas së cilës *masa e sigurimit*

⁹⁹ Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 11, datë 2.4.2008, ka ritheksuar se: “Gjykata është shprehur se pushteti gjyqësor ushtrohet i shkallëzuar sipas parimit të kontrollit të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulëta nga gjykatat më të larta”. Gjithashtu, edhe KPA-ja⁹⁹ në qëndrimet e veta, tashmë të konsoliduara, vazhdimisht ka theksuar se vlerësimi lidhur me themelin e çështjeve gjyqësore dhe bindjes së brendshme të gjyqtarit, del jashtë misionit të organeve të rivlerësimit [Vendimi nr. “*****”, datë 23.10.2020 dhe vendimi nr. “*****”, datë 3.11.2021].

shuhet: ...c) kur kohëzgjatja e paraburgimit të vuajtur është më e madhe se masa e dënimit të caktuar – ka vendosur se masa e sigurimit “arrest burg” që i ishte dhënë të pandehurit L. K., ishte shuar, pasi i pandehuri e kishte përmbushur dënimin e dhënë, bazuar në pikën 2 të nenit 262 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet se: “Në rastet e humbjes së fuqisë së masave të tjera të sigurimit, gjykata vendos heqjen e menjëhershme të tyre”.

202. Nga dokumentacioni i shqyrtuar nga Komisioni ka rezultuar se vendimi në analizë ka marrë formë të prerë në datën 21.5.2007. Referuar bazës ligjore mbi të cilën është arsyetuar vendimi, duket se masa e dënimit për veprën penale për të cilën është marrë si i pandehur shtetasi L.K., është përmbushur përgjatë kohëzgjatjes së masës së sigurisë. Në këndvështrim të kësaj përlllogaritjeje, është konstatuar se masa e sigurisë ishte shuar dhe, për rrjedhojë, nuk evidentohen shkelje, veprime apo mosveprime të subjektit që të mund të ketë favorizuar personin e dënuar nga një tjetër trup gjykues.
203. Nisur nga sa më sipër është përshkruar, bazuar në dokumentet e administruara dhe nga të dhënat e disponuara nga Komisioni, nuk janë evidentuar shkelje procedurale, arsyetime të dobëta, veprime apo mosveprime të subjektit të rivlerësimit, që mund të konfirmojnë faktet e dyshuara lidhur me favorizimin e mundshëm të palëve në çështjet e analizuara.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të figurës

204. Në përfundim, nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka rezultuar që subjekti të ketë qenë i përfshirë në veprimtari të kundërligjshme apo të ketë pasur ndonjë kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kësisoj, në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit Besnik Hoxha arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nga verifikimet e kryera: (i) nuk rezultoi se ai ka pasur apo të ketë aktualisht kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (ii) ka dorëzuar në kohë deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk ka bërë deklarime të pasakta, të paplota dhe nuk ka fshehur të dhëna apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

C/1. Lidhur me analizën e aftësive profesionale nga KLGJ-ja

205. KLGJ-ja, me shkresën nr. “****” prot., datë 12.7.2021, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të subjektit të rivlerësimit Besnik Hoxha.
206. Në raportin e KLGJ-së janë analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar: (i) aftësive profesionale; (ii) aftësive organizative; (iii) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; si dhe (iv) aftësive personale dhe angazhimit profesional. Raporti në fjalë është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit; (ii) 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; (iii) 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe (iv) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

207. Sipas këtij raporti ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë eficient dhe efektiv në çështjet që ka shqyrtuar dhe ka shfaqur aftësi shumë të mira për të kryer procedurat gjyqësore në 5 dosjet e vëzhguara, ku rezultoi se gjykimet kanë përfunduar brenda afatit ligjor apo në respektim të afatit standard.
208. Subjekti ka shfaqur të njëjtat aftësi për të kryer si duhet procedurat gjyqësore edhe në 3 dokumentet ligjore të prezantuara prej tij, ku gjykimet kanë përfunduar në respektim të afatit standard. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje pa vonesa prej tij, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore.
209. Gjithashtu, nga raporti është evidentuar se subjekti ka filluar detyrën si gjyqtar me vendimin nr. “*****”, datë 23.8.1996, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me anë të të cilit është emëruar në detyrë gjyqtar ushtarak në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Me vendimin nr. “*****”, datë 1.4.2010, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është transferuar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku dhe aktualisht vazhdon të ushtrojë detyrën.
210. Sipas të dhënave nga databaza e ankesave, ka rezultuar se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Besnik Hoxha janë paraqitur gjithsej 3 ankesa (2 të vitit 2014 dhe 1 e vitit 2015) në Inspektoratin e ish-KLD-së. Lidhur me këto ankesa ka rezultuar sa vijon:
- 1 ankesë pas shqyrtimit paraprak është arkivuar me arsyetimin se zgjidhet përmes apelimit gjyqësor në gjykatat më të larta (viti 2014);
 - 1 ankesë (viti 2014) nga kontrolli fizik i së cilës ka rezultuar se i adresohet një tjetër gjyqtareje;
 - 1 ankesë (viti 2015) është verifikuar në lidhje me zvarritje të mundshme gjykimi dhe për këtë ankesë është sugjeruar tërheqje vëmendjeje me shkrim për zvarritje të procesit dhe të evidentohet për efekt vlerësimi profesional.
211. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Besnik Hoxha, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk ka rezultuar ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe as të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-KLD-ja.

C/2. Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni

212. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLGJ-së, si dhe dokumentacionin përkatës bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet nga publiku dhe nga organet e tjera ligjzbatuese, si dhe ka analizuar dosjet profesionale të administruara për këtë qëllim.
213. Duke qenë se KLGJ-ja është shprehur se nuk dispononte informacion në lidhje me ankimimin ose jo të 3 vendimeve të përzgjedhura, Komisioni ka hetuar dhe është vënë në dijeni se 2 nga vendimet e dhëna në lidhje me 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, janë ankimuar. Nga shqyrtimi i materialit përkatës të administruar gjatë hetimit është konstatuar sa vijon:
- a. Lidhur me vendimin nr. “*****”, datë 27.7.2015, i dhënë nga subjekti i rivlerësimit, në çështjen me palë shtetasen A. G., të akuzuar për veprën penale “mashtrim me

pasoja të rënda”, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal. Ka rezultuar se ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë nga organi i Prokurorisë, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit në fjalë, pasi është marrë në vlerësim të gabuar të provave. Gjykata e Apelit, me vendimin nr. “*****”, datë 28.9.2016, ka çmuar se vendimi ka qenë i drejtë dhe i mbështetur në prova e në ligj dhe ka vendosur lënien në fuqi të tij.

- b. Lidhur me vendimin nr. “*****”, datë 24.11.2016, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, në çështjen me palë shtetasin G. D., i akuzuar për veprat penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake”, “kanosje” dhe “falsifikim të letërnjoftimit ose vizave”, parashikuar nga nenet 79/dh, 278/5, 189/1 dhe 84 të Kodit Penal, si dhe të pandehurin Xh. D., i akuzuar për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal. Vendimi në fjalë është ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë nga të pandehurit. I pandehuri G. D., i cili ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe caktimin e një dënimi të vetëm. Gjithashtu, i pandehuri Xh. D. ka kërkuar ndryshimin e vendimit për sa i përket masës së dënimit, duke kërkuar dënimin me minimumin e parashikuar në ligj. Gjykata e Apelit, me vendimin nr. “*****”, datë 22.9.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. “*****”, datë 24.11.2016, me këtë ndryshim: *prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit G. D., për sa i përket veprës penale të kanosjes, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal, për shkak se procedimi penal ndaj tij nuk mund të vazhdojë. Gjykata e Apelit ka arsyetuar se bazuar në nenin 6 të ligjit nr. 141, datë 22.12.2016, “Për amnistinë”, vepra penale e kanosjes është një vepër që dënohet me burgim ose me gjobë deri në 2 vjet dhe përfshihet në kategorinë e veprave që amnistohen sipas ligjit të sipërcituar.*
214. Gjithashtu, përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, nga Prokuroria e Përgjithshme¹⁰⁰ është bërë me dije se ndaj subjektit të rivlerësimit është depozituar një ankesë me nr. “*****”, në vitin 2019, nga shtetasi I.B¹⁰¹. Ankuesi ka ngritur pretendime ndaj disa personave, ndërmjet tyre edhe ndaj subjektit të rivlerësimit me objekt “Akuzoj gjyqtarin Besnik Hoxha, i cili mbron pa asnjë argument vjedhësit, shpërdoruesit dhe mashtruesit. Akuza ju drejtohet për vëzhgim dhe për hetim”.
215. Prokuroria e Përgjithshme ka konstatuar se kallëzimi nuk përmbante elementet thelbësore të faktit penal të pretenduar nga ankuesi, burimet e provës dhe çdo gjë tjetër në interes të hetimit, sipas parashikimeve të nenit 283 të Kodit të Procedurës Penale dhe me shkresën nr. “*****”prot., datë 23.1.2020, e ka njoftuar ankuesin për sa ka konstatuar.
216. Në vijim të kërkesës së Komisionit, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës¹⁰² është bërë me dije se ndaj subjektit të rivlerësimit kanë rezultuar materialet hetimore nr. “*****” dhe nr. “*****”, si dhe materiali hetimor nr. “*****”, i cili gjendej ende në proces verifikimi¹⁰³.

¹⁰⁰ Me shkresën nr. “*****” prot., datë 6.10.2020.

¹⁰¹ Shtetasi I.B., ka paraqitur pranë Komisionit një denoncim ndaj subjektit të rivlerësimit, i cili do të trajtohet në rubrikën “Denoncime nga publiku”.

¹⁰² Me shkresën nr. “*****” prot., datë 18.9.2020 .

¹⁰³ Me shkresën nr. “*****” prot., datë 29.8.2022, Komisioni ka kërkuar informacion nga kjo prokurori lidhur me ecurinë e kallëzimit penal.

- 1. Në lidhje me materialin hetimor nr. “*****”, në datën 16.7.2020** nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është marrë vendimi i mosfillimit të procedimit penal. Nga shqyrtimi i këtij vendimi ka rezultuar se kallëzuesja, shtetasja A.Ç., në datën 28.5.2020, ka depozituar një kallëzim penal në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e cila e ka deleguar për kompetencë pranë Prokurorisë së Rrethit Durrës. Kallëzuesja ka ngritur pretendime ndaj një oficeri të policisë gjyqësore, një prokurori, një gjyqtareje dhe ndaj subjektit të rivlerësimit për veprën penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
217. Pretendimet e kallëzueses lidheshin me çështjen nr. “*****”, në ngarkim të bashkëshortit të saj, shtetasit V.Ç., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “mashttrim” të kryer më shumë se një herë, të parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal.
218. Në lidhje me subjektin e rivlerësimit, kallëzuesja ka pretenduar se ai nuk ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, nuk ka verifikuar veprimet hetimore të kryera nga prokurori i çështjes. Ajo ka pretenduar se vendimi nr. “*****”, datë 25.10.2018, i dhënë nga subjekti i rivlerësimit është absolutisht i paligjshëm.
219. Në lidhje me çështjen në fjalë, prokuroria ka arsyetuar se *mungojnë elementet e veprës penale “shpërdorim detyre”* të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, sepse në kallëzim nuk citohet asnjë dispozitë ligjore e shkelur nga të kallëzuarit dhe as të jenë kryer apo moskryer me dashje veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin, që të përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës apo të jenë kryer veprime që t’i kenë sjellë përfitime personale ndonjërit prej tyre apo personave të tretë. Sipas arsyetimit të prokurorit, vendimi i dhënë nga gjyqtari Besnik Hoxha kanë qenë i bazuar në ligj, kompetencë që ia ka dhënë Kodi i Procedurës Penale dhe ligji nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Me qëllim verifikimin e paanshmërisë, prokurori, në përputhje edhe me qëndrimin e mbajtur në vendimet unifikuese nr. 7, datë 11.3.2008 dhe nr. 11, datë 4.11.2008, të Gjykatës Kushtetuese, ka aplikuar testin objektiv (verifikimi i garancive procedurale të ofruara nga gjyqtari) dhe testin subjektiv (verifikimi i bindjes apo interesit personal të gjyqtarit). Nëpërmjet kësaj analize, Prokuroria ka konstatuar se ai ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim për njëanshmëri në trajtimin e çështjes, pasi ka marrë një vendim mbi bazën e një arsyetimi dhe duke e njohur të pandehurin me të drejtat e tij procedurale.
220. Në përfundim të shqyrtimit të materialit kallëzues, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, nëpërmjet vendimit nr. “*****”, datë 16.7.2020, bazuar në nenet 78, 277, 290/1/ç dhe 291/1/2/3 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. “*****”, për shkak se fakti nuk parashikohej nga ligji si vepër penale¹⁰⁴.
221. Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni ka administruar vendimin nr. “*****”, datë 25.10.2018, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit ndaj shtetasit V. Ç., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “mashttrim” të kryer më shumë se një herë, të parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal. Ndaj këtij vendimi i akuzuari ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Kjo e fundit, me vendimin nr. “*****”, datë 5.4.2022, ka arsyetuar se në ankim

¹⁰⁴ Prokuroria ka bërë me dije se vendimi i mosfillimit është ankimuar në gjykatë.

nuk janë paraqitur shkaqet e ankimit dhe çfarë kërkohet me ankimin. Për rrjedhojë, bazuar në nenet 412 dhe 420 të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur mospranimin e ankimit për shkak se nuk përmbante elementet formale të ankimit.

222. Në përfundim të sa më sipër, sikurse është cituar edhe nga prokuroria në vendimin e mosfillimit të procedimit penal, Komisioni ka konstatuar se pretendimet e kallëzueses lidheshin me themelin e çështjes dhe nuk referonin shkelje procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit.

2. Në lidhje me çështjen nr. “***”,** është administruar materiali përkatës dhe vendimi nr. “*****”, datë 16.7.2020, bazuar në nenin 290/ç/e, për mosfillimin e procedimit penal nr. “*****”. Ky vendim bazohej mbi arsyetimin se nuk ekzistonte asnjë e dhënë apo fakt, që subjekti i rivlerësimit të kishte pasur ndonjë interes vetjak në gjykimin e çështjes në fjalë e, për më tepër, vendimi i mosfillimit të procedimit penal në datën 16.7.2020 të konsiderohej si i dhënë në keqbesim.

223. Nga shqyrtimi i këtij vendimi ka rezultuar se pretendimet e kallëzuesit, shtetasit T. Gj., ngriheshin në lidhje me një çështje në të cilën ai vetë kishte qenë palë, në cilësinë e personit nën hetim. Me vendimin nr. “*****”, datë 6.7.2019, subjekti i rivlerësimit kishte pranuar kërkesën e prokurorit për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” në mungesë, e parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale ndaj shtetasit T. Gj.

224. Pasi është analizuar vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit, ka rezultuar se bazuar në pikën 1 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti ka marrë në konsideratë kriteret e përgjithshme që kjo dispozitë parashikon, gjithashtu ai ka marrë në konsideratë dhe ka argumentuar edhe kriteret e veçanta të përcaktuara në pikën 3 të nenit 228.

225. Sipas përmbajtjes së këtij vendimi, në çështjen në fjalë ka ekzistuar dyshimi i arsyeshëm i bazuar në provat e paraqitura nga organi i prokurorisë, si dhe ekzistenca e elementeve e rrethanave të faktit, në gjendjen që ndodheshin aktet, të cilët i kanë krijuar bindjen gjykatës që vepra penale është kryer nga i akuzuari dhe se ndaj tij duhej të vendosej masa e sigurimit personal. Në lidhje me caktimin e llojit të masës, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenet 229 - 230 të Kodit të Procedurës Penale, ka argumentuar se në rastin konkret është arritur të provohej se i akuzuari paraqiste rrezikshmëri aq të madhe shoqërore, sa që çdo masë tjetër sigurie do të ishte e papërshtatshme dhe ndaj tij duhej të vendosej masa e sigurisë “arrest në burg”. Kjo masë është konsideruar si e vetmja masë që përmbushte nevojat e sigurisë në përputhje me rrethanat e faktit të rezultuara nga hetimi gjyqësor dhe me masën e sanksionit të parashikuar nga nenet 144/a “Skema e mashtrimit me tatimin mbi vlerën e shtuar” dhe 190/2 “Falsifikimi i vulave, stampave dhe i formularëve”, të Kodit Penal, për të cilat akuzohej.

226. Gjithashtu, ai ka argumentuar se vepra penale ishte kryer në vazhdimësi dhe se i akuzuari i ishte shmangur hetimit, rrethana rënduese këto të parashikuara nga shkronjat “gj” dhe “h” të nenit 50 të Kodit Penal.

227. Në përfundim, lidhur me vendimin në analizë të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka konstatuar se ky vendim përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 245/2/ç të Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar, sipas të cilit kërkohet që vendimi i gjykatës për vleftësimin e masës së sigurimit “arrest me burg” duhet të jetë i arsyetuar dhe, ndër

të tjera, të përmbajë “parashtrimin e shkaqeve pse nuk merren parasysh pretendimet e parashtruara nga mbrojtja, si dhe arsyetimin e papërshtatshmërisë së masave të tjera të sigurimit”.

228. Nga sa më sipër ka rezultuar se në lidhje me të dyja vendimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, për të cilat janë paraqitur kallëzimet e analizuar më sipër, nuk janë evidentuar shkelje etiko-procedurale apo arsyeime të dobëta nga ana e tij.

LIDHUR ME EKZISTENCËN E MUNDSHME TË KONFLIKTIT TË INTERESIT

229. Në lidhje me ekzistencën e konfliktit të mundshëm të interesit, të subjektit të rivlerësimit me personat e lidhur në një marrëdhënie interesi, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër¹⁰⁵ janë përcjellë disa akte e vendime, të cilat u administruan dhe analizuan, duke konstatuar sa vijon:

1. Në lidhje me vendimin nr. “***”¹⁰⁶, datë 23.6.2003**, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit¹⁰⁷, për çështjen me objekt: “Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë të trashëgimlënësit F.D.¹⁰⁸”, ka rezultuar se ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 8.7.2003. Gjithashtu, është vërejtur se, pasi ishte dhënë ky vendim (rreth një muaj më pas), në datën 7.8.2003, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar si palë blerëse¹⁰⁹ e një pjese të pasurisë objekt trashëgimie.

230. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se me palën shitëse të pasurisë nuk ka pasur asnjë lloj marrëdhënie, ndërsa në lidhje me çështjen gjyqësore të sipërpërkthuar, subjekti ka shpjeguar se ai nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, pasi çështja në fjalë ka pasur natyrë deklarative, ku nuk është trajtuar apo zgjidhur ndonjë konflikt gjyqësor ndërmjet palëve, apo mes tyre dhe palëve të treta.

2. Në lidhje me vendimin e dhënë nga subjekti me nr. “***”, datë 30.3.2010¹¹⁰**, për çështje me objekt “Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë për të ndjerin A. M.”, me palë kërkuese P.M., me të cilën subjekti kishte nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, disa muaj pasi ka shqyrtuar çështjen gjyqësore. Sipas deklarimit të subjektit në deklaratën *Vetting*, marrëveshja e lidhur në datën 10.8.2010 konsistonte në përdorimin nga subjekti të banesës së znj. M., në Tiranë (rruga “*****”), kundrejt lënies në përdorim të saj, të pasurisë së tij në Shkodër. Në vijim, në datën 15.2.2016, ka lidhur me këtë shtetase një tjetër marrëveshje me të njëjtin qëllim, por në këtë rast subjekti ka shkëmbyer përdorimin e banesës së tij të ndodhur në Shkodër dhe të përdorur më parë prej znj. M., kundrejt përdorimit të banesës në pronësi të saj të ndodhur në rrugën “*****”, pallati “*****”.

231. I pyetur në lidhje me znj. M., dhe të ndjerin A. M., (ish-bashkëshorti i znj. P. M.), në përgjigje të pyetësorit nr. 5, subjekti ka deklaruar se me të ndjerin ka pasur një njohje të pakët, pa frekuentime apo takime dhe se nuk e mbante mend kohën kur e kishte njohur.

¹⁰⁵ Me shkresën nr. “*****”prot., datë 6.12.2021.

¹⁰⁶ Kërkesa nr. “*****”, datë 14.11.2021, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe kërkesa nr. “*****” prot., datë 16.11.2021, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁰⁷ Me shkresat nr. “*****”prot., datë 6.12.2021 dhe nr. “*****” prot., datë 25.11.2021.

¹⁰⁸ Shitësi i banesës 3-katëshe në Shkodër, në pronësi të subjektit.

¹⁰⁹ Referuar kontratës së shitblerjes nr. “*****” rep., nr. 1088 kol.

¹¹⁰ Përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me shkresën nr. “*****”prot., datë 6.12.2021.

- 3. Në lidhje me vendimin nr. “****”, datë 3.3.2008¹¹¹, për çështjen me objekt: “Deklarimin pjesërisht të pavlefshëm të aktit të lindjes, për sa i përket vendlindjes së fëmijës E. T.”, në të cilën shtetasi Ç.T., ka rezultuar palë (kërkues) dhe është vendosur pranimi i kërkesës së tij.**
232. Përgjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni ka konstatuar se përveç marrëdhënieve financiare që subjekti ka pasur me këtë shtetas dhe që janë trajtuar në këtë vendim, në kreun “Rivlerësimi i pasurisë”, janë konstatuar edhe disa udhëtime të kryera nga subjekti jashtë vendit, në shoqërinë e tij, konkretisht si vijon:
- a. në datën 6.5.2007, Ç.T., ka qenë drejtues i mjetit me targë “****”, në pronësi të shtetasit R.N.,;
 - b. në datën 11.8.2008, Besnik Hoxha ka qenë drejtues i mjetit me targë “****”;
 - c. në datën 25.3.2008, Besnik Hoxha ka qenë drejtues i mjetit me targë “****”;
 - d. në datën 5.9.2011, Ç.T., ka qenë drejtues i mjetit me targë “****”.
233. Komisioni ka konstatuar se ndonëse çështja gjyqësore në fjalë ka pasur natyrë deklarative, ku nuk është trajtuar apo zgjidhur ndonjë konflikt gjyqësor ndërmjet palëve, edhe pse nuk evidentohet ndonjë favorizim i mundshëm i kërkuesve në këto vendimmarrje, ngrihen dyshime mbi disa rrethana konflikti interesi, të cilat, më së paku, mund të cenojnë etikën e gjyqtarit – kjo nisur nga marrëdhënia e ngushtë miqësore dhe e hershme me shtetasin Ç.T., fakt për të cilin do të duhej të ishte evituar shqyrtimi prej subjektit i një çështjeje me kërkues apo palë pikërisht këtë person.
- 4. Gjithashtu, përgjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit kishte kryer një udhëtim 1-ditor në datën 8.4.2010 – 9.4.2010, jashtë vendit me mjetin me targë “****”, i cili drejtohej dhe ishte në pronësi të shtetasit F.B., lidhur me të cilin nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër janë përcjellë 3 vendime të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, të cilat analizohen në vijim¹¹²:**
- a. Vendimi nr. “****”, datë 22.9.2009, për çështjen me objekt: “*Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë të trashëgimlënësit B.B.*”. Subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e kërkesës së z. F.B., lëshimin e ligjore të të ndjerit B. B., dhe trashëgimtarët do të përfitojnë 1/8 pjesë secili nga nipërit dhe mbesat e tij të pasurisë trashëgimore. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 7.10.2009.
 - b. Vendimi nr. “****”, datë 27.9.2009, për çështjen me objekt: “*1. Saktësimin dhe plotësimin e shënimeve në librin e pronësisë në vitin 1947, në lidhje me përcaktimin e kufitarëve, vendndodhjen e tokës arë me sipërfaqe 8 dynym dhe kullotë 10 dynym në emrin e z. B.I. 2. Vërtetimin e faktit juridik për sa i përket shënimeve të bëra në regjistrin e kadastrës së vitit 1947 me nr. “****”, se bëhet fjalë për të njëjtin person. 3. Rivendosjen në afat të së drejtës për të paraqitur dokumentacionin pranë A. K. K. Pronave Qarku Shkodër*”. Person i tretë në këtë gjykim, ka qenë Komuna Rrethina Shkodër e cila ka qenë në mungesë. Në përfundim të gjykimit, pasi janë pyetur dëshmitarët, është relatuar edhe akti i ekspertimit nga eksperti topograf, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e

¹¹¹ Përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me shkresën nr. “****” prot., datë 8.3.2022.

¹¹² Me shkresën nr. “****” prot., datë 6.12.2021.

kërkesës së z. F.B., sipas objektit. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 14.8.2009.

- c. Vendimi nr. “****”, datë 6.4.2010, për çështjen me objekt “Kundërshtimi i veprimeve përmbarimore”. Person i tretë në këtë gjykim ka qenë Zyra e Përmbarimit Shkodër, e cila ka qenë në mungesë. Në përfundim të gjykimit, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e kërkesës së z. F.B., pavlefshmërinë e veprimeve përmbarimore, për caktimin e ekspertit vlerësues të pasurisë, pavlefshmërinë e shpalljes për shitje në ankand të pasurisë së paluajtshme.
234. I pyetur nëpërmjet pyetësorëve nr. 3 dhe 5, lidhur me marrëdhënien me shtetasin në fjalë, subjekti ka deklaruar se z. B., ka pasur një frekuentim shumë të rrallë, rreth 2- 3 herë së bashku me miq të përbashkët.
235. Nga SPAK-u¹¹³ është bërë me dije se nuk kanë rezultuar procedime penale të regjistruara, mosfillim ose pushim të çështjeve penale në ngarkim të shtetasve P.M., Ç.T., dhe F. B.
236. Në përfundim të analizimit të çështjeve të mësipërme, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimit, si vijon:
- **Ngrihen dyshime se subjekti mund të ketë shqyrtuar dhe vendosur çështjet e lartpërmendura, në kushtet e konfliktit të interesit dhe/ose duke shkelur etikën e magjistratit, për shkak të marrëdhënieve dhe udhëtimeve të kryera (së bashku) me palët në proces, përgjatë apo në afërsi të shqyrtimit të çështjeve gjyqësore përkatëse prej tij.**

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

237. Subjekti i ka qëndruar shpjegimeve të dhëna prej tij edhe gjatë hetimit administrativ, ku është shprehur se çështjet në fjalë kanë pasur natyrë deklarative dhe nuk kanë trajtuar apo zgjidhur ndonjë konflikt mes palëve e, për rrjedhojë, ai nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit.
238. Në lidhje me çështjet ku znj. M., dhe z. T., kanë qenë palë, subjekti ka sqaruar se vendimmarrja e tij nuk ka pasur ndonjë lidhje evidente shkak/pasojë, për sa kohë nuk është evidentuar ndonjë efekt/fakt favorizues, i ndonjërës prej palëve. Sipas subjektit, si çështja e lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë ligjore ashtu edhe çështja e deklarimit pjesërisht të pavlefshëm të aktit të lindjes së fëmijës së z. T., kanë natyrë deklarative. Subjekti ka shpjeguar se në çështjen me objekt deklarimin e pavlefshëm të aktit të lindjes është kërkuar që në aktin e lindjes të ndryshohet vetëm vendlindja e fëmijës nga i lindur në Barbullush në i lindur në Shkodër. Ky vendim, i cili nuk ka zgjidhur ndonjë konflikt të mirëfilltë gjyqësor, është i vitit 2008 dhe në distancë kohore me datën e nënshkrimit të kontratës së huas.
239. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se pasi ka hyrë në marrëdhënie huaje apo huapërdorje me znj. M., apo me z. T., nuk mund të shqyrtonte çështje ku këta shtetas do të kishin një pozitë procedurale. Pra, në çdo rast do të jepte dorëheqjen nga gjykimi i çështjes.

¹¹³ Me shkresën nr. “****” prot., datë 26.11.2021.

240. Lidhur me shtetasin F. B., subjekti është shprehur se nuk ka njohje familjare apo shoqërore dhe se vendimmarrjet e tij në lidhje me proceset gjyqësore janë pa asnjë ndikim favorizues. Ndonëse nuk e kujton udhëtimin e sipërcituar, subjekti ka sqaruar se pasi ka pyetur për shtetasin F.B., ka mësuar se ai punon si taksist dhe udhëtimi me të ka qenë krejt i rastësishëm. Ky fakt provohet edhe nga të dhënat e sistemit TIMS, nga i cili rezulton se shtetasi F.B., si drejtues i mjetit me targë “****”, ka qindra hyrje dhe dalje me shtetas të ndryshëm nga pika e kalimit kufitar.

Vlerësimi i trupit gjykues

241. Pas analizimit të pretendimeve të subjektit, sipas të cilit nuk ka ekzistuar asnjë shkak ligjor për të hequr dorë nga gjykimi i çështjeve të sipërpërshkruara, në referencë edhe të praktikës së Kolegjit¹¹⁴, trupi gjykues vlerëson se duke qenë se situata në vetvete nuk përfaqëson një nga rastet e parashikuara shprehimisht nga ligji, analiza e kësaj situatë duhet të bëhet mbi vlerësimin e fakteve të njohura dhe dinamikës së tyre në kohë.
242. Në këtë këndvështrim, trupi gjykues, në referencë edhe të jurisprudencës së GJEDNJ-së¹¹⁵, çmon se për të vlerësuar praninë ose jo të konfliktit të interesit nuk mjafton vetëm verifikimi i testit subjektiv, që lidhet me marrëdhënien/njohjen *in se* me palët, por edhe me vlerësimin objektiv, duke lidhur kohën kur ka lindur marrëdhënia juridiko-civile e subjektit me palët ndërgjyqëse të sipërpërmendura, në raport me interesat privatë të subjektit.
243. Trupi gjykues çmon me rëndësi të përmendë se ligji nr. 9376/2005 evidenton qartë rastet kur një situatë apo marrëdhënie konsiderohet për nëpunësin publik si një konflikt interesi duke parashikuar ndër to, ekzistencën e një marrëdhënieje juridiko-civile me karakter pasuror, siç është ajo e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, përdorimit dhe huas, në rastin konkret. Gjithashtu, referuar qëndrimin të mbajtur nga Kolegji¹¹⁶ ku, ndër të tjera, arsyetohet se: “..., trupi gjykues arrin në përfundimin se konflikti në dukje i interesit, i parashikuar në nenin 3, pika 4, germa “b” e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, nuk përfshihet në parashikimet e nenit 33, pika 5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet konfliktit faktik të interesit të parashikuar në nenin 3, pika 4, germa “a” e ligjit nr. 9367/2005, ...”.
244. Ndërsa, në nenin 75 të ligjit nr. 96/2016, përcaktohet se: “2. Etika në punë e magjistratit, në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion, matet duke u bazuar në treguesit e dalë nga burimet e vlerësimit, të tilla si rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre, mendimi i kryetarëve dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës përkatëse të vlerësimit. 3. Integriteti i magjistratit, në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm, matet duke u bazuar në tregues të tillë si rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre, mendimi i kryetarëve dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës përkatëse të vlerësimit dhe/ose raportet e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. 4. Paanësia e magjistratit, në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit dhe respektimin e çështjeve të grupeve në nevojë, duke përfshirë edhe çështjet e

¹¹⁴ Vendimi nr. “****”, datë 13.6.2020 dhe vendimi nr. “****”, datë 18.5.2022.

¹¹⁵ Shihni vendimet e GJEDNJ-së: Driza kundër Shqipërisë, paragrafët 71-84; Morice kundër Francës (viti 2015) paragrafi 75; Micallef kundër Maltës.

¹¹⁶ Vendimi nr. “****”, datë 28.12.2020.

barazisë gjinore dhe të pakicave, matet duke u bazuar në tregues të tillë si përdorimi i gjuhës diskriminuese, numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e magjistratit, si dhe tregues të tjerë që dalin nga burime të tjera vlerësimi”. Pra, në rastin konkret nuk ka asnjë indikator të parashikuar nga ligji për t’u marrë në analizë për të konkluduar se në rastin konkret ka shkelje etike. Në këto kushte, pavarësisht se evidentohet se subjekti ka kaluar testin subjektiv, për sa kohë nuk ka ekzistuar një detyrim ligjor për heqjen dorë nga gjykimi, çmohet e rëndësishme analiza e testit objektiv, për të konkluduar në paanshmëri të tij në gjykimet në fjalë.

245. Në vlerësim të rrethanave objektive, trupi gjykues ka konsideruar: (i) faktin e konstatuar gjatë hetimit se çështjet në fjalë (dy vendime për lëshimin e trashëgimisë dhe një vendim për korrigjimin e aktit të gjendjes civile sa i takonte vendlindjes së fëmijës) nuk kanë pasur për objekt apo të kenë zgjidhur një konflikt gjyqësor mes palëve, por kanë pasur natyrë deklarative; (ii) faktin e konstatuar gjatë hetimit se vendimet e dhëna nga subjekti nuk janë ankimuar nga trashëgimtarët apo persona të tretë; (iii) faktin se trashëgimtarët në këto çështje/palët (në rastin e z. T.,) do të ishin po ata dhe do të përfitonin të njëjtat të drejta; (iv) në pikëpamje të zbatimit të ligjit procedural e ligjit të posaçëm, që përcakton rrethin e trashëgimtarëve e të drejtave të tyre, nuk ka diskrecion të gjyqtarit, e po ashtu edhe në rastin e korrigjimit të aktit të gjendjes civile apo rasti i korrigjimit të regjistrit të ZRPPP-së (në rastin e z. B.,); (v) faktin se vendimet e dhëna nga subjekti nuk kanë prodhuar ndonjë dëm për të tretët apo anasjellas ndonjë favorizim për palët kërkuese; (vi) faktin se marrëdhënia mes subjektit dhe palëve në këto procese gjyqësore ka lindur pasi janë gjykuar çështjet gjyqësore, në të cilat ata ishin palë, pra me një distancë kohore që përjashton mbivendosjen e njëkohshme të ekzistencës së marrëdhënies nga një anë dhe shqyrtimit të një çështjeje me palë personat e përfshirë në marrëdhënie. Në këto kushte, vlerësohet se edhe rrethanat objektive në rastet konkrete vijnë në mbështetje të konkluzionit se nuk ka pasur gjendje të konfliktit të interesit për subjektin e rivlerësimit në gjykimet në fjalë, si dhe nuk janë konstatuar elemente të qenësishme që mund të kenë cenuar etikën magjistratit.
246. Gjithashtu, trupi gjykues çmon të marrë në konsideratë edhe një tjetër aspekt të rëndësishëm procedural në këtë rast, konkretisht përcaktimin në nenin 3, pika 12 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit *“periudha e rivlerësimit” është periudha e punës së subjektit të rivlerësimit, gjatë së cilës vlerësohen aftësitë etike dhe profesionale të tij, sipas këtij ligji*”, përcaktimin në nenin 40 të ligjit nr. 84 të vitit 2016, sipas të cilit *“objekti i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i veprimtarisë etike dhe profesionale të subjekteve të rivlerësimit, në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve*”, si dhe në nenin 41 të po këtij ligji, ku parashikohet se: *“Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, do të jetë 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës nga hyrja në fuqi e këtij ligji ... Vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale”.*
247. Për sa në sipër, trupi gjykues vlerëson se periudha e gjykimet të çështjes së trashëgimisë së familjes D., është jashtë harkut kohor të përcaktuar nga dispozita e mësipërme e, për rrjedhojë, në çdo rast nuk mund të mbahet në konsideratë në funksion të vlerësimit të etikës së subjektit Besnik Hoxha.

248. Në përfundim të sa është parashtruar dhe analizuar më sipër, trupi gjykues vlerëson se – nisur nga dinamika e fakteve të analizuara, por edhe për shkak të tipologjisë së çështjeve objekt vlerësimi – edhe nëse shqyrtimi i këtyre të fundit (tri çështjeve) do të ishte kryer nga një gjyqtar tjetër, objektivisht nuk do të mund të kishte konkluduar me vendimmarrje të ndryshme nga ato që janë marrë nga subjekti në rastet konkrete.
249. Për pasojë, duke mbajtur në vëmendje bazën ligjore, jurisprudencën e Kolegjit¹¹⁷, si dhe faktet e rrethanat me dinamikën e tyre në kohë, siç janë analizuar më sipër, tipologjinë e objekteve të kërkesave të çështjeve gjyqësore në fjalë dhe mungesën e ndërthurjes apo të mbivendosjes kohore midis vendimmarrjeve të subjektit dhe marrëdhënieve financiare ose shoqërore me personat në fjalë – të cilat kanë lindur pasi ishte mbyllur shqyrtimi dhe ish-in dhënë vendimet përkatëse për çështjet e sipërpërshkruara – krijohet bindja e mungesës së elementeve që do të përbënin gjendjen e një konflikti të interesit ose të shkeljes së etikës. Në këto kushte, trupi gjykues, përpos dyshimeve, nuk konstaton fakte të mjaftueshme në këto çështje që mund të çojnë në cenimin e besimit të publikut nga veprimet e subjektit të rivlerësimit apo në pasoja dhe/ose përgjegjësi të tjera nga ana e tij, në lidhje me dyshimet e ngritura nga Komisioni dhe të njoftuara nëpërmjet rezultateve të hetimit administrativ.

DENONCIME NGA PUBLIKU

250. Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit Besnik Hoxha, janë paraqitur 24 denoncime nga publiku. Komisioni, me qëllim vlerësimin e aspektit etik dhe profesional, analizoi të gjitha denoncimet e depozituara, së bashku me materialet përkatëse, duke konstatuar se: (i) disa prej tyre nuk përmbanin elemente/referenca konkrete lidhur me rrethana specifike, që do të mundësonin analizimin e akteve përkatëse; (ii) disa denoncime prej tyre nuk kishin lidhje me aktivitetin profesional të subjektit; (iii) ndërkohë që janë shqyrtuar të gjitha denoncimet e tjera, lidhur me të cilat është konstatuar sa vijon:
- 1. Denoncimet nr. “****” prot., datë 12.12.2017; nr. “****” prot., datë 10.12.2019; nr. “****” prot., datë 24.12.2017 janë paraqitur nga shtetasi V. Ç.,**
251. Denoncuesi V.Ç., ka ngritur pretendime ndaj disa gjyqtarëve dhe prokurorëve, ndërmjet tyre ka përmendur edhe gjyqtarin Besnik Hoxha.
252. Komisioni ka konstatuar se në këto denoncime pretendoheshin fakte në lidhje me themelin e çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, rrethana të cilat nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se këto denoncime nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

¹¹⁷ Vendimet nr. “****” dhe nr. “****”.

2. Denoncimet nr. “***” prot., dhe nr. “*****” prot., datë 12.10.2018, nga shtetasi Xh.H.,¹¹⁸**

253. Në të dyja denoncimet, të cilat kanë rezultuar me të njëjtën përmbajtje, pretendohet për shkelje të ligjit nga ana e gjyqtarit B. Hoxha, për shkak se është bazuar në kërkesat dhe provat e paraqitura nga organi i akuzës dhe ka rrëzuar ato të paraqitura nga mbrojtësi i denoncuesit. Denoncuesi ka parashtruar gjithashtu se vendimi është zbardhur me vonesë.
254. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar ka rezultuar se pretendimet e tij i referoheshin çështjes penale me nr. “*****” regj., datë 20.4.2015 regjistrimi, me të pandehur Xh.H., i akuzuar për veprën penale “shpërdorim detyre” – të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Kjo çështje është përfunduar me vendimin nr. “*****”, datë 10.11.2015.
255. Ndaj vendimit të sipërcituar, të dhënë nga subjekti, është paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Kjo e fundit, me vendimin nr. “*****”, datë 1.3.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. “*****”, datë 10.11.2015, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit. Në vijim, është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, në të cilën çështja është ende në pritje për t’u gjykuar.
256. Nga sa më sipër, duket se nuk janë konstatuar indicie apo prova për ta ngarkuar subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore për kriterin e aftësive profesionale. Ky konstatim i Komisionit gjen mbështetje edhe në faktin se vendimi i dhënë nga subjekti është ligjëruar nga gjykata e apelit, si dhe në faktin se nga analiza e dosjes që i përket çështjes objekt denoncimi, e kryer nga KLGJ-ja në raportin e saj¹¹⁹, nuk janë evidentuar shkelje procedurale.
257. Për sa i përket pretendimit të denoncuesit për shpallje të vendimit në tejkallim të afatit ligjor, vonesa prej 3 ditësh (dhe jo mbi 1 muaj siç ka pretenduar denoncuesi), duket se ka ardhur për shkak të ngarkesës së gjyqtarit. Referuar të dhënave statistikore të KLGJ-së mbi ngarkesën sasiore të tij, është konstatuar se ai ka pasur një ngarkesë dukshëm mbi standardin minimal të përcaktuar për gjyqtarët, nga ky organ.

3. Denoncimi nr. “***” prot., datë 15.10.2019, nga shtetasi T.Gj.**

258. Denoncuesi në fjalë ka ngritur pretendime ndaj dy prokurorëve, si dhe ndaj gjyqtarit Besnik Hoxha, duke u shprehur ndër të tjera se gjyqtari ka zhvilluar seancën gjyqësore të caktimit të masës së sigurimit personal “arrest në burg”, pa u caktuar me short për këtë çështje. Gjithashtu, denoncuesi ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka marrë në shqyrtim provat e paraqitura nga mbrojtja.
259. Me kërkesë të Komisionit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹²⁰ ka vënë në dispozicion vendimin nr. “*****” akti, datë 6.7.2019, si dhe urdhrin nr. “*****”, datë 1.7.2019, “Mbi zhvillimin e gjykimeve të kërkesave gjatë hetimeve dhe seancës paraprake për muajin korrik 2019”.

¹¹⁸ Ky denoncim përkon me dosjen nr. “*****”, të shqyrtuar nga KLGJ-ja dhe të pasqyruar në relacion, në rubrikën përshkrimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short.

¹¹⁹ Shihni raportin e KLGJ-së, dosja nr. “*****”.

¹²⁰ Në përgjigje të kërkesës së Komisionit me nr. “*****” prot., datë 28.7.2022, me shkresën nr. “*****” prot., datë 17.8.2022, gjykata ka përcjellë dokumentacionin.

260. Nga shqyrtimi i vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit ka rezultuar se ai ka administruar në seancë gjyqësore provat e paraqitura nga organi i prokurorisë, si dhe i ka shqyrtuar ato. Në vendim ai ka arsyetuar se në fazën e caktimit të masës së sigurimit nuk mund të pretendohet për prova të plota që mund të vërtetojnë akuzën, por duhet të ketë aq prova sa të krijojnë bazën e nevojshme për caktimin e masës së sigurimit. Subjekti ka vlerësuar se në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 144/a “skema e mashtrimit në lidhje me tatimin mbi vlerën e shtuar” dhe neni 190/2 i Kodit Penal “falsifikim i vulave, i stampave dhe i formularëve”, ekzistonin kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të parashikuara nga neni 228/3 i Kodit të Procedurës Penale, si dhe kriteret e përcaktuara nga nenet 229-230 të po këtij Kodi, për caktimin e masës së sigurisë “arrest në burg”.
261. Kundër vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim personi nën hetim. Gjykata e Apelit, me vendimin nr. “*****”, datë 5.8.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit në analizë për sa i përket masës së sigurimit, duke caktuar si masë sigurimi për personin nën hetim T. Gj., “arrest në shtëpi”, sipas nenit 237 të Kodit të Procedurës Penale. Gjykata e Apelit, bazuar në pikën 3 të nenit 244, ka arsyetuar se gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë nga ajo e kërkuar nga prokurori dhe se masa e kërkuar prej tij ka qenë e përshtatshme.
262. Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se gjyqtari nuk kishte qenë i caktuar me short për shqyrtimin e kërkesës për caktimin e masës së sigurimit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë i caktuar me urdhrin nr. “*****”, datë 1.7.2019, për gjykimin e kërkesave paraprake (masat e sigurimit dhe kërkesat e tjera) gjatë muajit korrik nga data 1.7.2019 – 7.7.2019. Sikurse evidentohet edhe nga data e vendimit, seanca gjyqësore e caktimit të masës ka qenë brenda afatit të përcaktuar në urdhrin e sipërpërkthuar.

4. Denoncimi nr. “***” prot., datë 9.7.2018, i shtetasit D.T.**

263. Denoncuesi ka ngritur pretendime ndaj disa gjyqtarëve dhe prokurorëve për një çështje të kallëzuar prej tij dhe njëkohësisht një kallëzim që është bërë ndaj tij. Ai ka parashtruar se të dyja këto çështje i kanë rënë për shqyrtim/gjykim gjyqtarit Besnik Hoxha, por nuk ka rezultuar të ketë ngritur pretendime apo të ketë bashkëlidhur ndonjë dokument, apo indicie ose provë lidhur me ndonjë shkelje të mundshme procedurale nga ana e subjektit të rivlerësimit.
264. Për sa më sipër, nuk janë evidentuar indicie për thellimin e hetimit, pasi nuk plotësohen kushtet e parashikuara nga neni 53 i ligjit nr. 84/2016.

5. Denoncimi nr. “***” prot., datë 20.3.2018, nga shtetasi M.Ll.**

265. Denoncuesi ka ngritur pretendime ndaj disa gjyqtarëve, ndërmjet tyre edhe ndaj gjyqtarit Besnik Hoxha, duke parashtruar se gjyqtarët që kanë gjykuar çështjen e vrasjes së djalit të tij janë të korruptuar, kanë dhënë vendim të padrejtë dhe kanë favorizuar vrasësin.
266. Nga shqyrtimi i dokumentacioni të administruar, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues në çështjen me të pandehur shtetasin P. D., i akuzuar për veprat penale “vrasje me dashje dhe armëmbajtje pa leje”, parashikuar nga nenet 76 dhe 278/2 të Kodit Penal. Kjo çështje është finalizuar me vendimin nr. “*****”, datë 20.6.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Nëpërmjet këtij vendimi gjykata ka vendosur: “*Deklarimin fajtor të të pandehurit P.D., për kryerjen e veprës*

penale “vrasje me dashje”, e parashikuar nga neni 76 dhe dënimin e tij me 12 vite burgim; deklarimin fajtor të tij për kryerjen e veprës penale “armëmbajtje pa leje” e parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 vite burgim; në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal dënimin e tij me 12 vite burg. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin e të pandehurit P. D., me 8 vite burgim”.

267. Në vijim të apelimit të këtij vendimi, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. “****”, datë 20.1.2006, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. “****”, datë 20.6.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për sa i përket fajësisë e cilësimit ligjor për akuzën e vrasjes me dashje, të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal dhe ndryshimin për sa i përket masës së dënimit ndaj të pandehurit P. D. dhe në bazë të nenit 76 të Kodit Penal dënimin e tij me 15 vite burgim. Lënien në fuqi të vendimit nr. “****”, datë 20.6.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për sa i përket deklarimit fajtor të tij për kryerjen e veprës penale “armëmbajtje pa leje” e parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 vite burgim; në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal dënimin e tij me 15 vite burg; në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin e të pandehurit P. D., me 10 vite burgim”.
268. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër ka paraqitur rekurs i gjykuari nëpërmjet avokatëve të tij, i cili më pas ka hequr dorë prej ankimit dhe për këtë arsye Gjykata e Lartë, me vendimin nr. “****”, datë 6.10.2006, bazuar në nenin 433/1, ka vendosur mospranimin e rekursit për shqyrtim.
269. Për sa më sipër, sikurse ka rezultuar edhe nga vendimet e gjykatave më të larta në hierarkinë e gjyqësorit, duket se vendimi në analizë nuk ka rezultuar me shkelje procedurale apo mosrespektim të të drejtave të palëve në proces. Gjithashtu, nuk janë evidentuar rrethana favorizuese që të ishin konkretizuar në një vendim të padrejtë, sikurse është pretenduar nga denoncuesi.
270. Për sa i përket faktit të ndryshimit të masës së dënimit të dhënë për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal, Komisioni ka konstatuar se dënimi i dhënë nga trupi gjyqësor, pjesë e të cilit ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit në raport me përcaktimin ligjor, ka qenë brenda marzhit të dënimit që kjo dispozitë përcakton. Ndërsa, në raport me masën e dënimit të kërkuar nga prokurori (i cili ka kërkuar dënimin përfundimtar me 20 vite burgim), masa e dënimit të dhënë ka qenë me e ulët nga ajo e kërkuar nga prokurori i çështjes. Nisur nga fakti që përcaktimi i masës së dënimit mbetet në vlerësim të gjyqtarëve sipas bindjes së brendshme të tyre pas vlerësimit të provave dhe fakteve të rezultuara nga hetimi gjyqësor. Për rrjedhojë, ndonëse ky aspekt nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga Komisioni, vërehet gjithsesi se nuk janë gjetur elemente që të mbështesin pretendimet e denoncuesit, për sa kohë masa e dënimit përkon me parashikimet ligjore.

6. Denoncim nr. “**” prot., datë 1.8.2018, nga shtetasja F.V.**

271. Denoncuesja në fjalë ka ngritur pretendime në lidhje me një çështje gjyqësore të gjykuar nga gjyqtari Besnik Hoxha, në të cilën ajo ka qenë palë e paditur, duke e akuzuar subjektin për korrupsion dhe njëanshmëri.

272. Në funksion të analizimit sa më të plotë të këtij denoncimi, Komisioni ka kërkuar dhe ka administruar¹²¹ aktet e çështjes në fjalë, vendimin me nr. “****”, datë 16.3.2006, me objekt “Ndryshimi i vendimit nr. “****”, datë 12.5.1996, të KKKPronave të prefekturës së Qarkut Shkodër”.
273. Nga shqyrtimi i vendimit ka rezultuar se gjyqtari Besnik Hoxha ka arsyetuar se me miratimin e ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, vendimet e KKKP-së nuk mund të ankimohen në gjykatë, pa përfunduar rruga administrative.
274. Subjekti i rivlerësimit ka vlerësuar të nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor (pezullojë) çështjen deri sa të ezaurohej rruga administrative, nën arsyetimin se vendimi nr. “****”, datë 16.3.2006, objekt gjykimi duhej të kundërshtohej në Komitetin Shtetëror të Pronave dhe jo në gjykatë.
275. Për sa më sipër, duke qenë se çështja nuk është shqyrtuar nga subjekti, pretendimet e denoncueses kanë rezultuar të pabazuara, ndonëse ato gjithsesi lidheshin me themelin e çështjes, gjë e cila nuk hyn në juridiksionin e organeve të *Vettingut*. Për rrjedhojë, duket se nuk kanë rezultuar shkelje nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë denoncim.

7. Denoncimi nr. “**” prot., datë 12.10.2018, nga shtetasja V.O.**

276. Denoncuesja ka ngritur pretendime ndaj një prokuroreje dhe ndaj dy gjyqtareve, midis tyre edhe ndaj gjyqtarit Besnik Hoxha. Ajo është shprehur se në çështjen gjyqësore, ku ka qenë e pandehur, gjyqtari Besnik Hoxha nuk ka marrë vendimin e duhur ndaj saj.
277. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur denoncimit ka rezultuar se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. “****” për veprën penale “vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasës V. O.
278. Me vendimin nr. “****”, datë 24.11.2014, subjekti i rivlerësimit ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurës V. O., për kryerjen e veprës penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 4 muaj burgim. Në bazë të neneve 59-60 të Kodit Penal, Gjykata ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të dënimit duke e vënë në provë të pandehurën për një afat prej 18 muaj, me kusht që të mos kryejë veprë tjetër penale, si dhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës.
279. Kundër vendimit të sipërcituar ka paraqitur ankim si organi i akuzës ashtu edhe e pandehura në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. “****”, datë 16.6.2015, ka vlerësuar se vendimi nr. “****”, datë 24.11.2014, duhet lënë në fuqi.
280. Në përfundim të shqyrtimit të këtij denoncimi, ndonëse ai nuk prezantonte fakte apo prova në lidhje me shkelje procedurale nga ana e subjektit të rivlerësimit, Komisioni, në përfundim të analizimit të dokumentacionit të administruar, ka konkluduar se duket se nuk janë evidentuar shkelje të të drejtave procedurale të palëve apo që të jetë zhvilluar një proces jo i rregullt ligjor. Gjithashtu nuk është evidentuar mangësi apo arsyetim i dobët i vendimit nga ana e subjektit të rivlerësimit.

¹²¹ Nëpërmjet shkresës nr. “****” prot., datë 8.3.2022.

8. Denoncimi nr. “***” prot. dhe nr. “*****” prot., datë 20.12.2018, nga shtetasit Gj.Z., dhe P.M.**

281. Sikurse është përmendur edhe në rubrikën “Kontrolli i figurës”, në këtë vendim, Komisioni, përgjatë procesit të hetimit ka administruar denoncimet e sipërcituara, në të cilat ngrihen pretendime në lidhje me vendimin nr. “*****”, datë 28.12.2004, të dhënë nga gjyqtari Besnik Hoxha. Sipas denoncuesve, vendimi i sipërcituar është dhënë bazuar në vërtetimin kadastral datë 8.10.2004, i cili (sipas denoncuesit) ka qenë një akt i falsifikuar.
282. Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni ka administruar vendimin dhe nga shqyrtimi i tij është konstatuar se në këtë çështje shtetasi G. L., kishte kërkuar vërtetimin e faktit juridik të vendndodhjes dhe kufitarëve të tokës arë kullotë verore, kullotë dimërore në emër të shtetasit P.L., (babait të tij). Palë e tretë në këtë gjykim ka qenë Komuna Velipojë, e cila ka qenë në mungesë.
283. Në vitin 2007, denoncuesit kanë paraqitur kallëzim penal në prokurori. Pas kalimit të çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, kjo e fundit, bazuar në aktin e ekspertimit grafik nr. “*****”, datë 21.11.2007, nëpërmjet vendimit nr. “*****”, datë 27.1.2010, ka konstatuar pavlefshmërinë e aktit kadastral.
284. Për sa më sipër, siç ka rezultuar edhe nga dokumentacioni i përshkruar më sipër, përgjatë gjyqimit nuk ka pasur pretendime në lidhje me vlefshmërinë e aktit kadastral datë 8.10.2004 dhe, rrjedhimisht, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në dijeni të këtij fakti.
285. Nisur nga sa më sipër, vlerësohet se pretendimet e denoncuesve, për sa kohë lidhen me themelin e çështjes, nuk mund të jenë objekt vlerësimi nga Komisioni, por ato mund të adresohen përmes kërkesës për rishikim të vendimit në shkallët e gjyqësorit, nëse është rasti dhe plotësohen kushtet, sipas përcaktimeve të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile.
286. Në përfundim, duket se nuk janë konstatuar shkelje procedurale në çështjen gjyqësore të analizuar më sipër.

9. Denoncimi nr. “***” prot., datë 27.3.2019, nga shtetasi E.A.**

287. Denoncuesi në këtë rast ka pretenduar se, nëpërmjet vendimit nr. “*****”, datë 17.5.2018, të dhënë nga gjyqtari Besnik Hoxha, i është rrëzuar padrejtësisht kërkesa e tij për rehabilitim dhe se vendimi në fjalë ka qenë i pabazuar në prova dhe në ligj.
288. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar dhe nga analiza e vendimit në fjalë ka rezultuar se kërkuesi kishte humbur mundësinë e ofruar nga ligji për t’u rehabilituar, pasi brenda limiteve kohore, me të cilat ligji e lidh mundësinë e rehabilitimit, ai është dënuar sërish me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit ka disponuar me rrëzimin e kërkesës penale me nr. “*****” akti, që i përket kërkuesit E. A.
289. Në përfundim, lidhur me sa më sipër, Komisioni ka konkluduar se ndonëse denoncuesi nuk ka përshkruar ndonjë fakt apo shkelje procedurale të kryer nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka konstatuar se kërkesa e denoncuesit e shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit është bërë në përputhje me përcaktimet ligjore dhe se nuk janë evidentuar shkelje

procedurale nga ana e tij. Për rrjedhojë, pretendimet e denoncuesit kanë rezultuar të pabazuara.

10. Denoncimi nr. “**” prot., datë 8.7.2019, nga shtetasi D.Sh.**

290. Denoncuesi në fjalë ka pretenduar dhënie vendimi të padrejtë nga gjyqtari Besnik Hoxha, për shkak të vlerësimit si të ligjshëm të masës së arrestit, duke mos u bazuar në ndonjë provë.
291. Komisioni ka administruar dhe analizuar vendimin objekt denoncimi me nr. “****” akti, datë 3.2.2019, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, nga ku ka rezultuar se ai ka marrë në shqyrtim kërkesën e prokurorit, i cili kishte kërkuar vlerësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “detyrim paraqitjeje”, të parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, për personin nën hetim, shtetasin D. Sh. Në vendim është cituar se avokati dhe personi nën hetim kanë qenë dakord me kërkesën e prokurorit.
292. Gjyqtari ka vlerësuar se masa e kërkuar nga prokurori ndaj personit nën hetim, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “mosbindje ndaj urdhrin të punonjësit të policisë së rendit publik” dhe “kallëzim i rremë”, të parashikuara nga nenet 242 dhe 305 të Kodit Penal, ka qenë në përshtatje me rëndësinë e faktit, me rrezikshmërinë shoqërore të personit nën hetim dhe me sanksionin e parashikuar nga nenet 228, 229 dhe 234 të Kodit të Procedurës Penale. Në vendim është cituar se personi nën hetim dhe mbrojtësi i tij kanë deklaruar se kanë qenë dakord me kërkesën e prokurorit.
293. Në përfundim të shqyrtimit, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se bazuar në nenet 251 dhe 252 të Kodit të Procedurës Penale janë përmbushur të gjitha kriteret ligjore për ta cilësuar si të ligjshëm arrestin në flagrancë të shtetasit të sipërpërmendur.
294. Komisioni ka analizuar vendimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit, në raport me pretendimet e ngritura nga denoncuesi, nën optikën e ligjit penal dhe konkretisht të dispozitave që përcaktojnë kriteret ligjore lidhur me rrethanat dhe faktet për vlerësimin e masës së arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë.
295. Nisur nga sa më sipër, duket se nuk janë evidentuar shkelje procedurale nga ana e subjektit të rivlerësimit, lidhur me këtë çështje.

11. Denoncimi nr. “*” prot., datë 20.12.2019, nga shtetasi A.M.**

296. Denoncuesi, i cili ka qenë në cilësinë e viktimës së veprës penale, ka ngritur pretendime në lidhje me vendimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit, duke pretenduar njëanshmëri në proces nga ana e tij dhe duke e cilësuar vendimin e dhënë prej tij të padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin.
297. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar ka rezultuar se shtetasi A.M., ka paraqitur ankim në gjykatë ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. “****” të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila kishte vendosur pushimin e procedimit për veprën penale “shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal.
298. Shtetasi A. M. ka paraqitur ankim më pas edhe në Gjykatën e Apelit, e cila pas shqyrtimit të ankimit ka urdhëruar vazhdimin e hetimeve. Në përfundim të kryerjes së hetimeve dhe

plotësimin të detyrave të lëna nga Gjykata, prokurori ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. “****”.

299. Çështja në fjalë është shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit, i cili nëpërmjet vendimit nr. “****” akti, datë 1.8.2019, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e procedimit penal nr. “****”. Pushimin e çështjes penale me nr. “****” akti, datë 1.8.2019, që i përket procedimit penal nr. “****”, për veprën penale “shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal, ndaj personit nën hetim A.H., pasi fakti nuk parashikohej nga ligji si vepër penale.
300. Nga sa më sipër duket se nuk janë evidentuar shkelje procedurale apo favorizim i palës në procesin gjyqësor, ndërsa lidhur me pretendimin për vendimmarrje të padrejtë vlerësohet se ky pretendim është në tejkalim të kompetencës kushtetuese të organeve të rivlerësimit dhe, si i tillë, nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga Komisioni. Pretendimet e kësaj natyre adresohen në gjykatat më të larta.

12. Denoncimi nr. “**” prot., datë 8.11.2029, nga shtetasi I.B.¹²²**

301. Denoncuesi B., ka ngritur pretendime ndaj një prokurori, si dhe ndaj gjyqtarit Besnik Hoxha, në lidhje me të cilin ka pretenduar se ai ka vendosur pushimin e çështjes për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, ndaj punonjësve të OSHEE-së Tiranë, të cilët, sipas denoncuesit, i kanë faturuar detyrime fiktive.
302. Në vijim, denoncuesi ka paraqitur një kallëzim edhe ndaj prokurorit të çështjes dhe oficerit të policisë gjyqësore.
303. Komisioni ka administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹²³ dokumentacionin lidhur me çështjen në fjalë. Nga shqyrtimi i vendimit me nr. “****”, datë 5.11.2019, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, ka rezultuar se kërkuesi, shtetasi I. B., ka kërkuar prishjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal me nr. “****”, datë 2.8.2019, dhe vazhdimin e hetimeve.
304. Subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar në vendim se faktet e kallëzuar nuk përbënin vepër penale dhe se kallëzuesi, duke mos qenë dakord me vendimin, pretendimet e tij duhet t’i adresonte në gjykatat më të larta përmes ankimit, sipas nenit 326/3 të Kodit të Procedurës Penale. Gjyqtari ka vlerësuar se përfundimet e arritura nga prokuroria janë atribut kushtetues i saj dhe jo i gjykatës dhe në përfundim ka vendosur rrëzimin e kërkesës së shtetasit I. B.
305. Për sa më sipër, duket se nuk është konstatuar shkelje procedurale apo arsyetim i dobët i vendimit. Gjithashtu, Komisioni vlerëson se themeli i çështjeve gjyqësore nuk është objekt i procesit të rivlerësimit dhe se ligjvënësi i ka njohur të drejtën çdo shtetasi që pretendimet lidhur me vendimmarrjen e organeve të drejtësisë (si dhe lidhur me themelin e çështjes) t’i drejtojnë përmes mjeteve të ankimit, në gjykatat përkatëse, sipas hierarkisë së gjyqësorit.

13. Denoncimi nr. “**” prot., datë 28.10.2020, nga shtetasi A.B.**

¹²² Ky denoncim është përcjellë nga Kolegji nëpërmjet shkresës nr. “****” prot., datë 8.11.2019.

¹²³ Me shkresën nr. “****” prot., datë 17.8.2022.

306. Denoncuesi akuzon disa subjekte rivlerësimi, ndër të tjerë, edhe gjyqtarin Besnik Hoxha, në lidhje me çështjen nr. “****” akti, datë 29.7.2020. Ai ka qenë në cilësinë e kallëzuesit për veprën penale “falsifikim dokumentesh”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.
307. Denoncuesi ka pretenduar pavlefshmërinë e testamentit, hartuar pranë noteres D. K., në datën 25.10.2010, për shkak se ai nuk ishte hartuar në formën e kërkuar nga ligji, si dhe ka pretenduar se akti nuk ka qenë i nënshkruar nga i ndjeri, babai i tij/testamentlënësi. Gjithashtu, denoncuesi ka pretenduar se nuk është njoftuar në lidhje me datën e zhvillimit të procesit gjyqësor.
308. Nga shqyrtimi i dokumenteve të administruara është konstatuar se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. “*****”, datë 20.7.2020, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. “*****”. Në lidhje me pretendimin për pavlefshmërinë e aktit, Prokuroria ka arsyetuar se ky fakt nuk është në juridiksionin penal, por është i karakterit juridiko-civil dhe pretendimi duhet të ngrihet pranë gjykatës kompetente.
309. Pas ankimit të paraqitur ndaj vendimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. “*****” akti, datë 29.7.2020¹²⁴, bazuar në aktin e ekspertimit grafik dhe provat e tjera të administruara gjatë gjykimit dhe ato të vëna në dispozicion nga organi i akuzës, ka vlerësuar se nënshkrimet e evidentuara në testament kanë qenë të vetë shtetasit J.B.
310. Ndërsa lidhur me pretendimet e tjera, ai ka vlerësuar se janë marrëdhënie juridiko-civile dhe zgjidhen me padi në gjykatën civile. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e çështjes për veprën penale të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, për shkak se fakti nuk ekziston. Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 19.10.2020, pasi nuk është ankimuar.
311. Nga analizimi i akteve përkatëse ka rezultuar gjithashtu se në datën 5.10.2020, shtetasi A. B. ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit Besnik Hoxha, me pretendimin se gjykimi ishte zhvilluar pa praninë e palëve, pretendim të cilin e ka parashtruar edhe në denoncim.
312. Në lidhje me pretendimin e denoncuesit për mosnjoftim në lidhje me datën dhe orën e seancës gjyqësore, përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, së bashku me vendimin e sipërcituar nga gjykata është përcjellë edhe kopja e fletëthirrjes për t’u dëgjuar në seancë, e cila ka rezultuar e nënshkruar nga vetë denoncuesi. Gjithashtu, nga këqyrja e procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 2.10.2020, ora 12:30, ka rezultuar se ndryshe nga sa ka pretenduar shtetasi A. B., Komisioni ka konstatuar se ai ka qenë prezent gjatë gjykimit.
313. Nga sa më sipër, duket se pretendimet e denoncuesit kanë rezultuar të pabazuara dhe nuk janë konstatuar shkelje procedurale nga subjekti i rivlerësimit. Për rrjedhojë, nuk ka indicie për hetime të mëtejshme lidhur me veprimet apo mosveprimet profesionale të subjektit të rivlerësimit.

¹²⁴ Administruar nga Komisioni me shkresën nr. “*****” prot., datë 17.8.2022.

14. Denoncimet nr. “**” prot., datë 8.11.2019 dhe nr. “****” prot., datë 23.5.2019 nga shtetasit P., e M.M.**

314. Denoncuesit e lartpërmendur kanë pretenduar se trupi gjykues që ka shqyrtuar çështjen, në të cilën djali i tyre ka qenë në cilësinë e viktimës, ka dhënë një vendim të padrejtë duke favorizuar të pandehurit.
315. Komisioni, pasi ka administruar disa akte dhe ka analizuar vendimin nr. “****”, datë 11.4.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të dhënë nga gjyqtarët S. T., Besnik Hoxha (anëtar) dhe A. Gj., ka konstatuar sa vijon:
316. Në datën 31.7.2017 ka ndodhur një konflikt fizik midis disa personave, ku si pasojë ka gjetur vdekjen shtetasi M.M. Në datën 1.8.2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal ndaj shtetasve D.B., E.B., K.A., dhe M.A., për kryerjen e veprave penale “vrasje”, kryer në bashkëpunim, si dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve”, parashikuar respektivisht nga nenet 76 dhe 25 dhe 278/1 të Kodit Penal.
317. Prokuroria ka kërkuar: *Të shpallet fajtor i pandehuri D.B., për kryerjen e veprës penale “vrasje me paramendim”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 78/1 dhe 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 24 vjet burgim. Të shpallen fajtorë të pandehurit K. A., dhe M.A., për kryerjen e veprës penale “vrasje me paramendim”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 78/1 dhe 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tyre me 20 vjet burgim. Të shpallet fajtor i pandehuri E.B., për kryerjen e veprës penale “vrasje me paramendim”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 78/1 dhe 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 18 vjet burgim. Në bazë të nenit 43 të Kodit Penal të bëhet publikimi i vendimit gjyqësor me shpenzimet e të pandehurve.*
318. Gjyqtari i seancës paraprake, me vendimin nr. “****”, datë 28.5.2018, ka vendosur dërgimin për gjykim të çështjes penale nr. “****”, në ngarkim të të pandehurve D. B., E.B., K.A., dhe M.A., të akuzuar për veprën penale “vrasje me paramendim”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 78/1 dhe 25 te Kodit Penal.
319. Gjykata, duke vlerësuar mekanizmin e ngjarjes, këqyrjen e pamjeve filmike, provat shkresore e shkencore, si dhe deklarimet e një numri dëshmitarësh, të pyetur në seancë gjyqësore, duke evidentuar autorët dhe pasojën, ka arritur në konkluzionin se ngjarja është zhvilluar siç pretendohet nga organi i akuzës.
320. Sa i përket kualifikimit juridik të veprës penale të kryer nga Prokuroria, Gjykata ka çmuar se ai nuk është rezultat i një interpretimi të drejtë të provave dhe i harmonizimit midis tyre në lidhje me elementin “paramendim” në veprimet e të pandehurve. Gjykata nuk ka identifikuar asnjë element interesi, hakmarrjeje, gjakmarrjeje apo qoftë edhe njohje të mëparshme me viktimën, që mund të nxiste fajtorin të kryente vrasjen. Madje, sipas deklarimit të datës 24.12.2019, të dëshmitares që ndodhej me të ndjerin përpara se të ndodhte ngjarja, fillimisht i ndjeri nuk ka pranuar të shkojë në vendin e ngjarjes.
321. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se mënyra, vendi dhe koha e kryerjes së saj, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, lidhja shkakore midis veprimit dhe pasojës së ardhur janë evidente për mungesën e elementit “paramendim”, si edhe dëshira e paramenduar prej tij për të ardhur pasoja – vrasja e shtetasit M. M.

322. Në këto kushte, Gjykata, bazuar në nenin 375 të Kodit të Procedurës Penale ka vlerësuar se në rastin në gjykim në vendimin përfundimtar, faktit juridik të sipërcituar duhet t'i jepet një përcaktim i ndryshëm nga ai i bërë nga organi i akuzës, duke u ndryshuar cilësimi juridik i veprës penale nga nenet 78/1 dhe 25 në nenet 76 dhe 25 të Kodit Penal dhe, konkretisht, të pandehurit duhet të përgjigjen për kryerjen e veprës penale “vrasje”, kryer në bashkëpunim.
323. Në lidhje me caktimin e llojit dhe të masës së dënimit, gjykata ka mbajtur parasysh rrezikshmërinë e theksuar shoqërore të veprës penale, shprehur kjo jo vetëm me faktin e kryerjes prej tyre të veprës penale me dashje të drejtpërdrejtë, por edhe në bashkëpunim, si edhe në pasojën fatale të ardhur prej saj.
324. Në përfundim, gjykata ka deklaruar fajtor të pandehurin D.B., për veprën penale “vrasje me dashje”, e kryer në bashkëpunim dhe dënimin e tij me 19 vjet burgim; deklarimin fajtor të të pandehurve E.B., K., dhe M.A., për veprën penale “vrasje me dashje”, kryer në bashkëpunim dhe dënimin e tyre me 12 vjet burgim/secili.
325. Nga analizimi i vendimit Komisioni ka konstatuar se trupa gjyqese ka arsyetuar mbi ndryshimin e cilësimit të veprës penale, duke analizuar provat, rrethanat dhe faktet mbi të cilat është mbështetur në marrjen e vendimit. Ky konstatim gjen mbështetje edhe në faktin se Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. “*****”, datë 18.6.2020, e ka gjetur të bazuar dhe ka vendosur lënien në fuqi të vendimit në analizë. Pretendimet e tjera në denoncim ngrihen mbi themelin e çështjes, çka nuk është objekt shqyrtimi nga ana e Komisionit.
326. Për sa më sipër, duket se nuk janë evidentuar shkelje procedurale apo të të drejtave të palëve në procesin gjyqësor. Masa dhe lloji i dënimit të aplikuar duket se kanë qenë të arsyetuara njaftueshëm dhe të bazuara në kriteret e përcaktuara në dispozitat përkatëse.

15. Denoncimi nr. “***” prot., datë 15.7.2020, nga shtetasi P. S.**

327. Ky denoncues ka ngritur pretendime për shkelje nga gjyqtari Besnik Hoxha të nenit 332/b, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, për mosnjohimin për seancën paraprake të datës 28.2.2020 dhe atë të datës 10.3.2020, të caktuara nga subjekti, në lidhje me çështjen në fjalë, ku denoncuesi ka qenë i paditur, me akuzën për kryerjen e veprës penale “pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”, e parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal.
328. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar lidhur me denoncimin në fjalë, ka rezultuar se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë¹²⁵ ka kërkuar dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. “*****”, viti 2018, që i përket të pandehurit P.S., për veprën penale të parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal.
329. Në vijim, me vendimin nr. “*****”, datë 31.12.2019, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të seancës paraprake, ka vendosur pranimin e kërkesës së organit të Prokurorisë dhe dërgimin e fashikullit të gjykimit, së bashku me aktet e Prokurorisë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo e fundit, me vendimin nr. “*****”, datë 15.10.2020, pas shqyrtimit të çështjes në themel, ka vendosur deklarimin e pafajshëm të të pandehurit për

¹²⁵ Me shkresën nr. “*****” prot., datë 26.9.2022.

veprën penale “pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”, e parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal.

330. Përgjatë hetimit administrativ, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është bërë me dije se vendimi i mësipërm është ankimuar dhe dosja ndodhet në Gjykatën e Apelit dhe se ishte në pamundësi për të përcjellë njoftimet e palëve (fletëthirrjet e dërguara nga gjyqtari Besnik Hoxha, për njoftimin e të pandehurit për datën në të cilat ishte caktuar zhvillimi i seancës).
331. Për sa më sipër, në veprimet procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit paraprak, duket se nuk janë evidentuar shkelje procedurale.

16. Denoncimi nr. “**” prot., datë 12.1.2021, nga shtetasja E.J.**

332. Denoncuesja E. J., ka pretenduar se gjyqtari Besnik Hoxha ka kryer shkelje procedurale, si dhe ka shqyrtuar faktet dhe provat në mënyrë të njëanshme në lidhje me kallëzimin nr. “****”, e bërë nga babai i saj, për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/1 i Kodit Penal.
333. Në datën 8.12.2018, Prokuroria i ka komunikuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesën për pushimin e çështjes nr. “****”, datë 4.12.2018, me arsyetimin se ndërtimi nuk ekzistonte. Në vijim, me vendimin nr. “****”, datë 12.2.2019, Gjykata ka vendosur kthimin e akteve Prokurorisë, duke i kërkuar të vazhdojë hetimin, si dhe duke i lënë detyrë kryerjen e aktit të ekspertimit.
334. Pas kryerjes së detyrave të lëna nga Gjykata, përfshirë edhe aktin e ekspertimit të ndërtimit, Prokuroria ka konkluduar se bëhej fjalë për ndërtime për të cilat nuk kërkohej leje ndërtimi, por vetëm një deklaratë paraprake punimesh, referuar nenit 7 të VKM-së Nr. 408, datë 13.5.2015.
335. Në vijim, me vendimin nr. “****”, datë 1.7.2020¹²⁶, pas shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga Prokuroria për pushimin e çështjes, në vlerësim të provave të paraqitura, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se mosrespektimi i kërkesave të përcaktuara në nenin 7 të VKM-së Nr. 408, datë 13.5.2015, përbën kundërvajtje penale, por nuk përmbush elementet e anës objektive të nenit 199/a të Kodit Penal, për t’u dënuar penalisht, por mund të ndëshkohet administrativisht, nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit ka vendosur se kërkesa e Prokurorisë për pushimin e procedimit penal ishte e bazuar në ligj dhe duhej pranuar. Vendimi në fjalë nuk është ankimuar dhe ka marrë formë të prerë në datën 12.8.2020.
336. Nisur nga sa më sipër, duket se pretendimet e denoncueses për njëanshmëri të gjyqtarit dhe shkelje procedurale nga ana e tij kanë rezultuar të pabazuara.

17. Lidhur me kallëzimet nr. “**” prot., datë 15.12.2021 dhe nr. “****” prot., datë 18.1.2021 nga shtetasi F.B.**

337. Shtetasi F. B. ka depozituar pranë Prokurorisë Speciale kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) kallëzimin penal të datës 14.12.2021, ndaj disa gjyqtarëve dhe

¹²⁶ Administruar nga Komisioni me shkresën nr. “****” prot., datë 17.8.2022.

- prokurorëve, ndërmjet tyre edhe ndaj gjyqtarit Besnik Hoxha, lidhur me të cilin ka njoftuar për dijeni edhe Komisionin.
338. Kallëzuesi ka parashtruar ndër të tjera se disa gjyqtarë dhe prokurorë, përfshirë këtu edhe gjyqtarin Besnik Hoxha, kanë kryer veprën penale “moskallëzimit të krimit”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal. Sipas denoncuesit, ata duhet të kallëzonin kryerjen e veprave penale “falsifikim dokumentesh”, e parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, “ekspertim i rremë”, e parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal, në lidhje me aktet të cilat ishin pjesë e dosjes së shqyrtuar prej tyre.
339. Përgjatë hetimit administrativ, SPAK-u¹²⁷ është bërë me dije se kallëzimi në fjalë, nëpërmjet shkresës nr. “****” prot., datë 16.12.2021, i është dërguar për kompetencë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
340. Përgjatë hetimit¹²⁸, Komisioni ka administruar¹²⁹ nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës¹³⁰ materialin hetimor nr. “****”, datë 13.1.2022, për kallëzimin e bërë ndaj gjyqtarit Besnik Hoxha, për të cilin ka rezultuar se është marrë vendimi i mosfillimit të procedimit me datë 27.1.2022. Nga shqyrtimi i vendimit të mosfillimit ka rezultuar se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, është regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, materiali kallëzues me nr. “****”, datë 25.1.2022. Në këtë kallëzim, mes disa gjyqtarëve dhe prokurorëve është kallëzuar edhe gjyqtari Besnik Hoxha për veprat penale “shpërdorim detyre” dhe “moskallëzim të krimit”, parashikuar nga nenet 248 dhe 300 të Kodit Penal.
341. Në lidhje me kallëzimin në fjalë, prokurori i çështjes ka vendosur mosfillimin e procedimit, duke arsyetuar ndër të tjera se kanë rezultuar shkaqe që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal për këto arsye: (i) faktet e kallëzuara kanë të bëjnë me kërkesa procedurale të paraqitura nga i pandehuri në fazën e hetimit paraprak në prokurori dhe gjykatë; (ii) çmuarja e vlefshmërisë së provave dhe akteve procedurale dhe nevoja e kryerjes së veprimeve procedurale gjatë hetimit paraprak, me kërkesë të palëve, bazuar në nenet 354-355 të Kodit të Procedurës Penale, këto mjete procedurale janë përdorur nga të pandehurit si në hetimin paraprak ashtu edhe në gjykim; (iii) çmuarja e falsitetit të provave, objekt debati gjyqësor, nuk mund të kryhet pa përfunduar gjykimi. Këto prova janë kërkuar e administruar për të provuar akuzën dhe nuk mund të ketë dyshime për falsitetin e tyre. Pavlefshmëria e tyre mund të kërkohet në shkallët e tjera të gjyqësorit. Prokuroria ka konkluduar se për të kallëzuarit nuk ka rezultuar të kenë kryer ndonjë veprim në mospërbushje të rregullt të detyrës dhe ka vendosur të mosfillojë procedimin penal.
342. Për sa më sipër, sikurse është konkluduar edhe nga organi kompetent për vlerësimin e pretendimeve të denoncuesit, ka rezultuar se subjekti nuk gjendej përpara detyrimit ligjor që vjen nga parashikimi i nenit 281, paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Penale dhe neneve

¹²⁷ Me shkresën nr. “****” prot., datë 5.8.2022.

¹²⁸ Komisioni i është drejtuar edhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe asaj të Apelit me qëllim administrimin e vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit. Gjykata e Shkallës së Parë, me shkresën nr. “****” prot., datë 26.9.2022, ka bërë me dije se vendimi në fjalë është objekt shqyrtimi në Gjykatën e Apelit. Kjo e fundit, me shkresën nr. “****” prot., datë 5.10.2022, ka bërë me dije se me të dhënat e dërguara ishte objektivisht e pamundur të identifikohet se për cilën çështje bëhej fjalë. Në vijim, vendimi në fjalë u administrua bashkëlidhur dosjes së dërguar nga Prokuroria e Rrethit Durrës.

¹²⁹ Me shkresën nr. “****” prot., datë 16.9.2022.

¹³⁰ Me shkresën nr. “****” prot., datë 20.9.2022.

245 e 271 të Kodit të Procedurës Civile, për të depozituar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kallëzimin penal me qëllim ushtrimin e ndjekjes penale ndaj personit përgjegjës, sikurse ka pretenduar denoncuesi. Për rrjedhojë, pretendimet e denoncuesit kanë rezultuar të pabazuara dhe nuk mund të merren në konsideratë në kuadër të vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.

18. Denoncimet nr. “**” prot., datë 15.2.2022 dhe nr. “****” prot., datë 28.4.2023** – i administruar nga Komisioni pas njoftimit të rezultateve të hetimit, në formën e një artikulli të publikuar në median *online* nga një shtetas anonim.

343. Denoncuesit kanë parashtruar thujtë të njëjtat fakte lidhur me disa gjyqtarë, ndërmjet tyre edhe në lidhje me gjyqtarin Besnik Hoxha. Për këtë të fundit, në këto denoncime citohet se ai vijon të ushtrojë detyrën ndërkohë që, sipas tij, subjekti ka liruar dy shtetas të përfshirë në ngjarjen e 21 janarit, si dhe ka ndihmuar ish-gjyqtarin A.Th., në mënyrë që ky i fundit të mos dënohej.
344. Gjithashtu, denoncuesi ka pretenduar se gjyqtari paraqitej në punë me një automjet të tipit “Cadillac”, të cilin e parkonte në oborrin e gjykatës ku ushtronte detyrën. Me fillimin e reformës në drejtësi, ai ka filluar të shkojë në punë me taksì.
345. Nga analiza e dokumentacionit të administruar, Komisioni ka konstatuar se bëhej fjalë për tubimin e 21 janarit të vitit 2011 ku, Prokuroria, në bazë të nenit 79, shkronjat “e” dhe “dh” të Kodit Penal, kërkoi 23 vite burg për shtetasin N.P., dhe 25 për shtetasin A. Ll., për vrasjen e shtetasve F.M., dhe Z.V. Trupi gjykues i kryesuar nga gjyqtari Besnik Hoxha në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, i shpalli ata të pafajshëm, duke rrëzuar akuzat e Prokurorisë me arsyetimin se nuk u vërtetua “dashja direkte” nga ana e të pandehurve, duke arsyetuar, ndër të tjera, se: “... *Nuk provohet akuza e Prokurorisë në drejtim të të pandehurve për këtë veprë. Gjykata nuk mund të shprehet për fakte të pahetuara nga Prokuroria ndaj këtyre dy të pandehurve*”.
346. Në vijim, Gjykata e Apelit Tiranë¹³¹ ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. “****”, datë 7.2.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë si më poshtë: “*Deklarimin fajtor të të pandehurit N. P., për kryerjen e veprës penale “vrasje nga pakujdesia”, me pasojë vdekjen e shtetasit F. M., parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal dhe, bazuar në këtë dispozitë, dënimin e tij me 1 vit burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit A. Ll., për kryerjen e veprës penale “vrasje nga pakujdesia”, me pasojë vdekjen e shtetasit Z. V., parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal dhe, bazuar në këtë dispozitë, dënimin e tij me 3 vjet burgim. Lënien në fuqi të vendimit për pjesën tjetër*”.
347. Ndër të tjera, Gjykata e Apelit ka arsyetuar se qëndrimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për sa i takon mungesës së dashjes, ka qenë i drejtë dhe se të pandehurit kanë vepruar me pakujdesi në formën e neglizhencës dhe duhet të përgjigjen penalisht për veprën penale “vrasje nga pakujdesia”, të parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal. Kjo pasi, referuar nenit 19 të ligjit “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, punonjësit e gardës i nënshtrohen juridiksionit penal të zakonshëm. Gjithashtu, Gjykata e Apelit ka

¹³¹Chromeextension://efaidnbmnnnibpcajpcgiclfindmkaj/http://www.gjykata.gov.al/umbraco/Surface/SearchSurface/GenerateAndDownloadCaseInformationReport?anonCode=&caseId=30-2013-01667&courtId=30

arsyetuar se qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë është i pabazuar në ligj, pasi ajo nuk mund të bënte ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës penale.

348. Lidhur me mundësinë (ose jo) për të bërë ndryshim të cilësimit juridik të faktit objekt akuze, duhet të mbahet në vëmendje se në vendimin me nr. 51/1999, Gjykata Kushtetuese shprehet se: “[...] e drejta që i njihet gjykatës për t’i dhënë faktit një përcaktim juridik të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori, nuk është veprim antikushtetues. Në këtë rast, gjykata nuk merr kompetencat e prokurorit dhe as kthehet në organ akuze, por vetëm zbaton ligjin, gjë që është detyrë funksionale e saj”.
349. Gjithashtu, në nenin 375 të Kodit Penal, përcaktohet se: “Me vendimin përfundimtar gjykata mund t’i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori ose i dëmtuari akuzues, më të lehtë ose më të rëndë, me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj”.
350. Në lidhje me pretendimin e denoncuesit për lirimin e të pandehurve në çështjen e përshkruar më sipër, si dhe me pretendimin se subjekti ka ndihmuar ish-gjyqtarin A. Th., Komisioni ka konstatuar se në këtë denoncim nuk janë përshkruar fakte, rrethana, prova apo indicie që të kenë lidhje me shkelje procedurale konkrete të kryera nga gjyqtari Besnik Hoxha dhe që mund të hetoheshin nga Komisioni. Në këto kushte, është vlerësuar se pretendimet e denoncuesit lidhen me themelin e çështjes. Për rrjedhojë, ky denoncim nuk përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, nuk mund të merren në konsideratë.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

351. Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, denoncimeve të depozituara nga publiku, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar, duke mbajtur në vëmendje edhe jurisprudencën e Kolegjit¹³², Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe/ose serioze në lidhje me shqyrtimet apo vendimmarrjet e tij – shkaqe këto që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se bazuar në sa më lart, subjekti i rivlerësimit Besnik Hoxha ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësoi çështjen në tërësi bazuar në provat e administruara, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Besnik Hoxha:

- a. ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

¹³² Vendimet nr. “****” dhe nr. “****”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Besnik Hoxha, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në datën 18.5.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI
Kryesuese

Lulzim HAMITAJ
Relator

Genta TAFA (BUNGO)
Anëtare
(Kundër)

Sekretare gjyqësore
Ertugena Sokoli